



Rruga Arbërit

www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (65). SHTATOR 2011. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



AKTUALITET

Minatorët ndërpresin grevën

KRONIKË E ZGJERUAR - FAQE 2-3

BOTIME

Faktori shqiptar dhe siguria rajonale

Nga: Prof. Dr. Lisen BASHKURTI - FAQE 20

PORTRET

Njeriu, gjeniu dhe pavdekësia

Kujtime për mjekun Basri Neziri

Nga: XHAHER MARTINI - FAQE 22

VENDLINDJA

VIÇISHTI

Historia e fshatit që ka më shumë dëshmorë se sa shtëpi

Nga: SAKIP CAMI - FAQE 7

STARTON GRUPI I PUNËS PËR RRUGËN EUROPIANE TË ARBËRIT

Bukurinë luginës ia shton Rruga e Arbërit

Reportazh nga Shaqir Skarra

“Punimet kanë nisur tek ish ofiçina e artilerisë dhe zgjaten deri tek Shkalla e Tujan-it, distancë kjo në kilometër është 5.4 km e cila ndërtohet me buxhetin e shtetit me një fond prej 2.332.963.024 lek. Në pamje të parë duket distancë e shkurtër kjo, por është e gjitha trase e re dhe ka shumë volume pune për të kryer. Do të ndërtohen 4 ura të cilat në fakt janë në përfundim vetëm presin trarët të hidhen sipër, do të përdoret 1100 ton hekur. Kemi për të ndërtuar një tunel me gjatësi 70 metra linear. Me të gjithë këtë volum pune ne kemi një afat për ta përfunduar këtë lot, por nga puna që kemi bërë deri tani shpreh bindjen se ne do ta përfundojmë para afatit”

FAQE 5



Lura ka nevojë për infrastrukturë rrugore

Nga: ing. SHKËLQIM LUSHA - FAQE 12

KRIJIMTARI

Në ç'truall lindi ky libër

Në vend të përcjelljes të romanit “Gurkështjella”

Naim Berisha, të mërkurën më 5 tetor 2011, në orën 18:00, në Sallën e Akademisë së Shkencave do të prezantojë krijimtarinë e tij më të re artistike: romanin “Gurkështjella”, vëllimin me poezi e poema “Vjershë e ndaluar” si dhe një album me këngë “Për ty këndo”

Faqe 13



Kompania ka pranuar të rrisë pagat e minatorëve në masën 20%, të përmirësojë kushtet e punës, të bëjë transparenten e investimeve në minerë, të paguaje 22 ditë e grevës si dhe do tu jepë pagën e 13-të. Gjithashtu, minatorët kanë rënë dakord që të mbetet në detyrë drejtori i minierës, një nga kërkesat që prej disa ditësh kishte penguar arritjen e marrëveshjes mes palëve.



Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (65), 1 - 30 Shtator 2011

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet priten në redaksi deri më datë 20 të muajit. Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi. JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN “Ë”. Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Xhafer MARTINI
Kristo ZHARKALLIU
Lisien BASHKURTI
Naim BERISHA
Rexhep TORTE
Shpëtim HYKA
Mentor HOXHA
Mevlud BUCI
Dionis XHAFA
Tefta NUREDINI
Faik XHANI
Selman MËZIU
Shkëlqim LUSHA
Saimir SHATKU
Haki PËRNEZHA
Sakip CAMI
Aqif KARAJ

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. + 355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

KRONIKA E GREVËS SË MINATORËVE GJATË MUAJ SHTATOR

I jepet fund grevës së urisë pas 3 muaj protesta. Kompania ka rënë dakord të plotësojë çdo kusht të minatorëve, përveç atij të largimit të drejtorit të minierës.

E ENJTE, 1 SHTATOR:
- Minatorët kanë nisur protestën e tyre të vazhdueshme para zyrave të ACR-së. Ata shprehen se pa u plotësuar kërkesat që kanë kërkuar, puna do të pezullohet.
- Këshilli Sindikalist ka zhvilluar një mbledhje që ka zgjatur rreth dy orë. Debatet kanë qenë të ashpra dhe vazhdon kërcënimi nga ana e minatorëve se në rast të mosplotësimit të tyre do të bllokohet rruga nacionale Bulqizë – Klos.
- Kol Nikolli, kreu i Konfederatës së Minatorëve, e ka quajtur një fyerje ftesën e znj. Depich, e cila ka ftuar minatorët për një drekë falas me rastin e muajit të Ramazanit. “Minatorët ishin në festë dhe nuk ishte aspak serioze për një zonjë të një vendi të BE-së të abuzojë me qëllim kthyerjen e minatorëve në punë”.

E PREMTE, 2 SHTATOR:
- Dje ACR ka kërkuar që minatorët të kthehen në vendet e tyre të punës si dhe kanë akuzuar Kol Nikollin për organizim të kësaj greve. Në deklaratën e ACR-së të bërë publike për mediat thuhet: “Kompania ACR fton të gjithë minatorët të nënshkruajnë kontratën e re të punës, brenda së cilës përfshihet edhe paga e 13-të, shtim prej 20% të pagës dhe garanci për përmirësimin e kushteve të punës.”
- Ka reaguar menjëherë Presidenti i Konfederatave të Industrisë, Taf Koleci, i cili është shprehur: “Kjo deklaratë është refren i deklaratave edhe të mëparshme. Është tërësisht e habitshme nënshkrimi i kontratave të punës individuale mes punëtorëve dhe kompanisë, e cila nuk kryhet ndonjëherë në raste grevash dhe protestash”.
- Minatorët kërkojnë nga Kuvendi ngritjen e një Komisioni Hetimor për të hetuar koncensionet në minierë. Këshilli ka vendosur vazhdimësinë e grevës derisa të mblidhet Kuvendi, e nëse ky i fundit nuk arrin të plotësojë interesat e tyre, atëherë rruga e vetme ngelet greva e urisë.

E HËNË, 5 SHTATOR:
- Konfederata e minatorëve i kërkon Kuvendit të hedhë në rend të ditës grevën e minatorëve. “Nëse nuk arrihet gjë në Parlament, atëherë ne do nisim një grevë tjetër urie.” – u shpreh Kreu i Konfederatës së Minatorëve, Kol Nikolli.
- Sipas Nikollit, e gjithë kjo që po zhvillohet në Bulqizë është si shkak i neglizhencës së firmës ACR.

E MARTË, 6 SHTATOR:
- Minatorët kanë pritur para zyrave të ACR-së, ku po zhvillohej një mbledhje të të zgjedhurve nga sindikata. Ata kanë pritur deri në darkë për një vendim nga ana e Parlamentit. Për minatorët, dera e Parlamentit është vendi nga ku duhet të plotësohen të drejtat e tyre.
- Gramoz Ruçi, kreu Parlamentar i PS-së, gjatë seancës së mbajtur dje, u shpreh se do mbahet një seancë pikërisht mbi çështjen e Bulqizës.

E MËRKURË, 7 SHTATOR:
- Ka dështuar sërish takimi mes ACR-së dhe minatorëve sindikalist. Kompania ka premtuar përmbushjen e disa kërkesave, si: investime në minierë, rritje page 20%, pagë e 13-të, por nuk është pranuar largimi i drejtorit të minierës, Medat Zogu.
- Sapo ka mbaruar kjo mbledhje, minatorët kanë paralajmëruar protesta masive.

E SHTUNË, 10 SHTATOR:
- “Nëse situata mbetet e tillë, pezull, atëherë protestat tona do përshkallëzohen” – janë shprehur kryesindikalistët. Ata shtojnë se të hënën do përpilohet edhe lista e minatorëve që do hyjnë në grevë urie.
- Minatorët kanë vendosur të padisin firmën ACR, në rast të thyerjes së ligjit për grevat. Disa javë më parë ishte kompania ajo që paditi minatorët për shkak të hyrjes së paligjshme në minierë.



Ne foto: Minatorët duke protestuar para zyrave të administratës

E MËRKURË, 14 SHTATOR:
- Këshilli Sindikalist ka lëshuar alarmin për gjendjen ekonomike të minatorëve, të cilët ka 75 ditë që nuk punojnë e si rrjedhojë nuk marrin para. Gjithashtu, ky këshill ka lëshuar një alarm ku u kërkon të gjithë biznesmenëve të ndihmojnë minatorët. Për këtë gjë është hapur dhe një numër llogarie, ku çdokush që ka dëshirë mund të ndihmojë minatorët.

E ENJTE, 15 SHTATOR:
- Përderisa ende nuk ka asnjë lloj marrëveshje, minatorët priten që të hënën të rifillojnë protestat e tyre. Gjatë një mbledhje, Këshilli Sindikalist dhe Komisioni i Grevës kanë rënë dakord që të rifillohet greva e urisë, pasi nuk po gjendet asnjë marrëveshje me ACR-në.
- Punonjës të policisë qëndrojnë përpara firmës ACR dhe në hyrje të pusit nr.1, me qëllim moslejimin e minatorëve për të zhvilluar greva në këto ambiente.

E SHTUNË, 17 SHTATOR:
- “Do jenë 10 minatorë të tjerë, të cilët do nisin grevën ditën e hënë”. Kështu është shprehur kryetari i Këshillit Sindikalist të Minatorëve, Dilaver Përkoxxha. Ai shtoi se 10 nga 700 minatorët do hyjnë në grevë urie dhe se të gjithë minatorët janë dakord mbi këtë gjë. Greva nuk do të zhvillohet në ambientet e brendshme të galerisë, por para zyrave të ACR-së ose në vendin ku grumbullohet kromi.
- Nuk është përcaktuar saktësisht se ku do zhvillohet greva e urisë dhe kjo ka dy arsye: Së pari, nuk është marrë një vendim përfundimtar mbi këtë gjë dhe së dyti, ekziston frika nga policia, e cila pengon çdo veprim të minatorëve.
- Ende nuk ka asnjë marrëveshje dypalëshe dhe pika ku ka ngërc më të madh është ajo e largimit ose jo të drejtorit të minierës, Medat Zogu.

E HËNË, 19 SHTATOR:
- Ka rinisur greva e urisë e paralajmëruar që të premtën. Greva mbahet në një vend afër kompanisë, ndërsa vazhdon të jetë i bllokuar pusi nr.1, aty ku u zhvillua edhe greva e parë e urisë.
- Sot në mëngjes u regjistrua një përplasje mes policisë dhe minatorëve, shkak i së cilës u bërë rrethimi me gurë i portave të kompanisë nga ana e minatorëve. Minatorët kërkojnë që t’u paguhet ditët e protestave.
- Deputetët socialistë do kërkojnë në Kuvend ngritjen e një Komisioni Hetimor për minierën e Bulqizës. Pjesë e këtij hetimi që do bëhet nga ana e partisë më të madhe opozitare në vend do jenë që nga z. Ruli e deri te administratorët e kompanisë.
- Partia Socialiste ka ngritur akuza ndaj qever-

isë, ku ministri Genc Ruli është vënë në epiqendër të akuzave për korrupsion.
E martë, 20 shtator:
- PS-ja kërkon publikisht nga Prokuroria ndjekjen penale të ministrit Ruli. Edi Rama, mbi këtë gjë, u shpreh se i bëjmë thirrje Prokurorisë së Republikës t marrë të pandehur ish-ministrin e Ekonomisë Genc Ruli për shpërdorim në detyrë dhe për shkatërrim të pasurisë kombëtare.
- Që nga data 4 korrik, datë kur ka filluar edhe greva e parë e urisë, palët janë ulur shpesh në bisedime, kanqë qenë afër marrëveshjeve, mirëpo asnjëherë me rezultat. Vetë presidentja e kompanisë ACR, Znj. Depich premtonte zgjidhjen e të 11-të nga 12-të kërkesave të minatorëve. Pika e vetme që nuk ka patur konsensus dypalësh ka është ajo për largimin e drejtorit të minierës, Medat Zogu.

E MËRKURË, 21 SHTATOR:
- Sot u mbushën tre ditë nga greva e dytë e urisë. Si për çdo ditë, në ora 7:00 minatorët e tjerë protestojnë para zyrave të ACR-së.
- Komisioni i grevës, gjatë ditës së djeshme ka kërkuar ngritjen e një stafi shëndetësor në shërbim të grevistëve. Kryetari i grevës, Luan Nika u shpreh: “ACR-ja nuk ka plotësuar tre kërkesa tonat, hapja e minierës në thellësi, rritje page prej 20% jo bruto por neto, përmirësim i kushteve optimale për punë”.
- Kol Nikolli, kreu i Konfederatës së Minatorëve, ka thënë se të enjten, më datë 22 shtator ne do të dorëzojmë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër një padi ndaj ACR-së, për mosrealizime investimesh në minierë, ashtu siç ka rënë dakord kjo kompani me qeverinë shqiptare. “Problemi thelbësor që kërkon zgjidhje nga minatorët ka qenë dhe mbetet ai i hapjes së pusit, gjë e cila do të zgjaste jetëgjatësinë e minierës. Kjo gjë nuk është realizuar nga ACR, që ka bërë të mundur humbje të mëdha në ekonominë e shtetit shqiptar” – tha Nikolli.

E ENJTE, 22 SHTATOR:
- Sot mbushet dita e katërt e grevës së urisë, ku 10 minatorë janë ngujuar në grevë urie. Kanë filluar problemet e para të minatorëve në shëndet, por që ata vazhdojnë të këmbëngulin në të drejtat e tyre.
- Administrata e kompanisë ACR, ndryshe nga çka bërë dy ditë më parë, ka vijuar punën në normalisht.
- Një grup nga opozita, deputeti i Partisë Socialiste Saimir Tahiri, Petro Koçi dhe kryetari i Partisë Rruga e Lirisë, Kurt Kola kanë vizituar minatorët e Bulqizës rreth orës 12.30 minuta të mesditës. Grupi socialist u ka bërë thirrje minatorëve të kërkojnë të drejtat e tyre dhe të qen-

Inxhinieri Jorgo Kola: Studimet e kryera vite më parë dëshmojnë se miniera e kromit në Bulqizë ka edhe 20 nivele të tjera, por unë mendoj mendon se ajo në të vërtetë ka edhe 40 nivele, çka do të thotë të paktën edhe 3 deri në 4 milionë tonë krom, i cili për nga cilësia është i parë në Europë.

Minatorët ndërpresin grevën



Greva brenda galerisë

drojnë të bashkuar. “ Për këtë situatë të krijuar në minierën e Bulqizës kam akuzuar ish-ministrin e METE-s, Genc Rulin. Opozita e bashkuar është me ju, ndaj mos u përkulni ndaj të drejtave tuaja” – është shprehur në fjalën e tij Tahiri. Mbi çështjen e minierës ka folur edhe Petro Koçi, kryetar i PSV 91, i cili ka vënë theksin në karakterin ekonomik dhe jo politik të kësaj greve. “ Greva juaj është krejtësisht ekonomike e sociale e jo politike, pasi ju iu thahen xhepat dhe të tjerët mbushin xhepat nga puna juaj” – ka folur Koçi. Kurt Kola i bëri thirrje shtetit të mbrojë shtetasit e tij, pasi sipas këtij të fundit kompania ACR ka shkelur të drejtat e tyre.

- Disa përfaqësues të komisionit të grevës udhëtuuan për në Tiranë për t’u takuar me pronaren e ACR-së, Znj. Routrauht Skatch Depich. Marrëveshje nuk është arritur dhe pika ku kanë hasur kundërshti minatorët ka qenë ajo për largimin e drejtorit të minierës. “ Në këto kushte, ne jemi të vendosur të vazhdojmë protestën tonë derisa të plotësohet çdo pikë e kërkesave tona” – ka thënë Dilaver Përkoxha, kryetar i Sindikatës së Minatorëve.

- Përkeqësohet gjendja shëndetësore e minatorëve që kanë hyrë në grevë urie. Ata kanë shfaqur probleme shëndetësore nga më të ndryshmet, si: dhimbje koke të forta, tensioni i ulët, këputje etj. Ndërsa 10 minatorë janë në grevë urie, të gjithë minatorët e tjerë qëndrojnë me ta, në mënyrë që greva mos të ndërpritet nga ana e policisë.

E PREMTE, 23 SHTATOR:

- Ka mbushur 5 ditë sot greva e minatorëve të Bulqizës. Kryesindikalistët dje nuk janë parë më në protesta me minatorët para ACR-së. Kjo për arsye se ata janë nisur për në Gjykatën e Dibrës, pasi janë paditur nga ana e ACR-së, RIHSMI-t dhe nga Avokatura e Shtetit për dëmtim të shëndetit të minatorëve dhe pronës nga greva që është zhvilluar brenda në galeri.

- Përballja e parë gjyqësore mes Sindikatës dhe kompanisë do të zhvillohet me datë 12 tetor. Seanca e parë nuk është zhvilluar si shkak i mungesës së palës që ka paditur. Ndërkohë dy kërkesa që mbeten për t’u plotësuar, pa të cilat ende nuk po arrihet një akord, është ajo e largimit të drejtorit të minierës Medat Zogu dhe së dyti pagesa e rrogës për këtë periudhë greve.

- As Taf Koleci, as Kol Nikolli nuk kanë dhënë asnjë deklaram për padi ndaj firmës ACR në Gjykatën Dibrë. Kol Nikolli kishte paralajmëruar se do të padiste kompaninë në gjykatë, por ai dje nuk ka qenë as në Bulqizë as në Peshkopi. Mu-

ngesa e tij është justifikuar me arsyen e problemeve personale.

E SHTUNË, 24 SHTATOR:

- Greva, që po zhvillohet në një ambient pranë kompanisë ACR, sot ka hyrë në ditën e saj të gjashtë. Të enjten, njëri nga grevistët e ngjuar ka pësuar gjendje të fikëti, për shkak të mosngrënies. Megjithë gjendjen e rëndë shëndetësore, minatorët shprehen se nuk u është dhënë asnjë lloj ndihme nga ana e mjekëve, të cilët nuk kanë dhënë asnjë lloj ndihme shëndetësore.

- Është bërë rutinë tashmë mbledhje e minatorëve së bashku në ora 7:00 pranë kompanisë ACR dhe ikja e tyre nga ora 15:00. Minatorët kanë lëshuar alarmin për të e largimit të policëve nga masa e një minerali, e cila mund të shitet dhe me këto para minatorët mund të sigurojnë diçka për këto ditë që nuk kanë marrë pagat.

E DIËL, 25 SHTATOR:

- Gjendja e minatorëve grevistë është rënduar tashmë. Mjekët kanë kërkuar që dy prej minatorëve të ndërpresin grevën, por minatorët nuk dorëzohen në qëndrimin e tyre. Drejtori i spitalit Bulqizë, Fatos Hoxha ka kërkuar daljen nga greva të Sali Allit, pasi ka shfaqur bronkopneumoni dhe virozë gripale.

- Dje, qindra minatorë kanë protestuar ashpër jashtë zyrave të kompanisë. Ata kanë kërcënuar bllokimin e rrugës kombëtare Tiranë – Peshkopi në fillim të javës së ardhshme.

- Drejtues të grevës I kanë bërë thirrje Ministrisë së Brendshme që të largojnë policinë nga miniera. “ Miniera është e jona, ajo mbrohet dhe ruhet nga ne, pasi jemi ne ata që punojmë aty dhe sigurojmë jetesën me të.” - janë shprehur protestuesit.

E HËNË, 26 SHTATOR:

- Përkeqësohet akoma më tej gjendja e minatorëve, që sot kanë hyrë në ditën e tetë të grevës së urisë. Katër nga 10 minatorë kanë shfaqur probleme serioze për shëndetin, por nuk kanë pranuar kurim në spitalin e qytetit të Bulqizës. Greva po zhvillohet në një lokal të marrë me qera nga ana e minatorëve sindikalist. Ata thonë se sot nuk do t’i dërgojnë fëmijët në shkollë dhe se do bllokojnë rrugën nacionale.

- Greva, siç dihet ka filluar që nga 4 korriku dhe akoma nuk ka një akord mes palëve. ACR ka pranuar rritje pagash prej 20%, përmirësim të kushteve të punës, por ka refuzuar dhe kryerjen e investimeve, por ka kundërshtuar heqjen e drejtorit të minierës, Medat Zogu.

DEKLARATA

KOMPANIA ACR:

Do të rrisim pagat e punëtorëve me 20%, do përmirësojmë kushtet e punës, dhe do të sigurojmë transparencë të plotë për investimet në minierë. Për të ndihmuar minatorët do të paguajmë 22 ditë të lejes së zakonshme dhe do të japim pagën e 13. Minatorët e Bulqizës do të rikthehen në punë ditën e hënë më datë 3 tetor.

ISH-ZËVENDËSMINISTRI I ENERGJETIKËS PAJTIM BELLO:

“Me marrjen edhe të atyre rezervave që u zhvaten, përmes punimeve të tjera jashtë projektit koncesionar, rrezikon të mbyllet miniera dhe të mos hapet me thellesia. Me hapjen e këtij pusi, quhej e hapur miniera e Bulqizes për rreth 5.5 milione tone krom që llogariteshin, pra duhet të kishim sot edhe 30 vite jetegjatesi. Që nga viti 2001 miniera nuk u thellua asnjë metër për shkak se DARFO dhe më vonë ACR nuk kryen investimet. Por sërish të dy kompanitë kanë shfrytëzuar një pjesë të rezervave në thellësi, përmes metodave të jashtëligjshme. Përmes këtyre metodave ato kanë nxjerrë një pjesë të kromit nga thellësitë, por kanë bërë të paleverdisshme thellimin e minieres për të shfrytëzuar rezervat e tjera” (Top Channel)

INXHINIERI JORGO KOLA:

Kromi që ndodhet në nivelin 16 do të zgjasë punën e 700 minatorëve edhe një vit, ndërkaq ACR, duhet të kishte nisur punën për hapjen e nivelit të 17, 18, 19 dhe 20, kohë më parë. Në vitin 2012 apo 2013 nuk do ketë vend ku do ngul kazmën për të marrë materiale. Studimet e kryera vite më parë dëshmojnë se miniera e kromit në Bulqizë ka edhe 20 nivele të tjera, por unë mendoj mendon se ajo në të vërtetë ka edhe 40 nivele, çka do të thotë të paktën edhe 3 deri në 4 milionë tonë krom, i cili për nga cilësia është i parë në Europë. Firmat private mund ta vazhdojnë edhe 50 vjet të tjera dhe nga kjo pikëpamje miniera është shumë e pasur. Është e hapur deri në -540 metra deri në nivelin e detit dhe mund të shfrytëzohet deri në 40 nivele. (Top Channel)

E MARTË, 27 SHTATOR:

- Ndër minatorët është hapur një dritë optimizmi, pasi pritet që ditën e mërkurë të ketë një takim të minatorëve me presidenten e kompanisë. Gjendja ndërkohë paraqitet tepër e rënduar, kjo edhe për shkak të ambientit të pafavorshëm për zhvillimin e një greve urie normale.

- Dy grevistë, Sali Aliu dhe Xhemal Meta kanë probleme të rënda shëndetësore. Pjesa tjetër e minatorëve protestojnë jashtë ambienteve të ACR-së. Minatorët kanë kërkuar nga ana e policisë që të ruaj ruajtë ambientin ku zhvillohet greva, si dhe të japin leje në organizimin e një tubimi, që do fillojë nga Bulqiza për të bllokuar aksin nacional Tiranë – Peshkopi.

- Një ndër kryesindikalistët, Tafë Koleci thotë se greva ka marrë përmasa kolosale, pasi kurrë nuk është zhvilluar një grevë kaq e gjatë në kohë. Dilaver Përkoxha, kreu i Sindikatës së Minatorëve thotë se punëtorët do fillojnë të qëndrojnë stoik përballë të drejtave të tyre.

- Të mërkurën pritet që nëBulqizë të shkojë Presidentja e kompanisë “DecometalAustria”, znj. Depich, e cila njëkohësisht është edhe pronare e kompanisë ACR. Kjo rrit shpresat për një marrëveshje të shumëpritur prej muajsh tashmë.

E MËRKURË, 28 SHTATOR:

- Është rënduar së tepërmi gjendja e njerit prej grevistëve, Sali Allit, 46 vjeç, i cili është detyruar të ndërpresë grevën. Ai është dërguar drejt spitalit të Burrelit, pasi spitali i Bulqizës nuk ka mjekë të specializuar. Ndërkohë, 9-të minatorë vazhdojnë betejën e tyre me urinë.

- Ka shënuar ora 10:00 dhe minatorët kanë nisur tubimin. Ata kanë zbritur në qytet dhe kanë vërshuar drejt rrugës kombëtare Tiranë – Peshkopi. Minatorëve u janë bashkangjitur edhe fëmijët dhe gratë e tyre. Dilaver përkoxha shpjegoi edhe njëherë pengun e minatorëve: “ Nëse nuk realizohen investime nga niveli i 16-të deri në të 21-tin, atëherë jetëgjatësia e minierës nuk do të jetë më tepër sesa 16 muaj”. Kryesindikalisti Taf Koleci tha se të gjitha qeveritë, që nga viti 2001 kur është marrë në koncension miniera e kanë shkatërruar atë. Tubimet kanë vijuar paqesisht nga ora 10:00 deri në orën 12:00.

- Drejtori i minierës, Medat Zogu i ka bërë thir-

rje minatorëve të rikthehen në punë. “Greva është e paligjshme dhe kryhet për interesa të dy kryesindikalistëve, Taf Koleci dhe Kol Nikolli. Mua më vjen keq për situatën e krijuar dhe iu bëj thirrje minatorëve të rikthehen në punë” – ka qenë deklarata e drejtorit të minierës së Bulqizës, Medat Zogu.

E ENJTE, 29 SHTATOR:

- Greva e urisë së minatorëve të Bulqizës ka hyrë sot në ditën e njëmbëdhjetë. Grevistët Kujtim Bushi, 45 vjeç, dhe Xhemal Meta, 50 vjeç, kanë rezultuar dje me një gjendje të rënduar shëndetësore. “Do të qëndroj deri në fund brenda grevës, deri sa të arrihet nënshkrimi i marrëveshjes me kompaninë, edhe pse mjekët kërkojnë që unë të largohem, për shkak të gjendjes shëndetësore”, - ka thënë Xhemal Meta.

- Dje, gjatë protestës ishte i pranishëm edhe kreu i Konfederatës së Sindikatave, Kolë Nikolli, i cili në fjalën e tij ka kërkuar që prefekti i Dibrës, Genci Sharku, të mos vazhdojë të jetë indiferent ndaj protestave të minatorëve që po vazhdojnë prej gati tre muajsh, por të angazhohet seriozisht në zgjidhjen e problemit të krijuar në minierën e Bulqizës.

E PREMTE, 30 SHTATOR:

- Minatorët e Bulqizës, të ngjuar prej mëse 11 ditësh kanë lënë grevën ditën e sotme. Kjo pasi është nënshkruar pakti zyrtar me kompaninë ACR. Minatorët do i rikthehen punës ditën e hënë të javës së ardhshme në orën 09:00. Ky lajm është konfirmuar nga Tafë Koleci, nënkryetari i Sindikatës së Minatorëve të Shqipërisë.

- Mësohet se kompania ka pranuar të rrisë pagat e minatorëve në masën 20%, të përmirësojë kushtet e punës, të bëjë transparencën e investimeve në minierë, të paguaje 22 ditë të grevës si dhe do tu jepë pagën e 13-të. Gjithashtu, minatorët kanë rënë dakord që të mbetet në detyrë drejtori i minierës, një nga kërkesat që prej disa ditësh kishte penguar arrijten e marrëveshjes mes palëve.

- Kështu mbyllet edhe protesta e minatorëve e nisur që prej 3 muajsh, e cila fatmirësisht u mbyll me kaq. Tashmë minatorët do i rikthehen punës së përditshme.

Përgatiti: Dionis XHAFA

Grupi i punës, do të veprojë në mënyrë permanente duke marrë kontakte me institucione shtetërore, rrjete sociale, diasporën Shqiptare, specialist dhe profesionist me qëllim që në fund të punës së saj, të dali me një raport përfundimtar në lidhje me antikapat dhe problematikat teknike që shqetësojnë ndërtimin e kësaj Rruge.

Starton grupi i punës për Rrugën europiane të Arbërit

Ditën e premte dt. 29 Korrik 2011, u mbledh grupi i punës për monitorimin e standartete dhe kriterëve të ndërtimit të Rrugës e Arbërit. Ky komitet i përbër nga inxhinjer profesionist, akademik, studiues dhe artist, pati si qëllim që të shfaqë në vazhdimësi një kujdes më të lart përsa i takon përbushjes së detyrimeve dhe afateve kohore të përfundimit të rrugës së Arbërit, kaq të domosdoshme dhe të mirpritur nga komuniteti dibran. Rruga e Arbërit, përfasëson jo vetëm një vepër transportuese njerëzish dhe udhëtarësh, por ruan në memorjen e secilit qytetar dibran, vuajtje, tortura dhe një botë shpirtërore të ndarë përgjysëm mes shekujsh. Këtë e dëshmon mësimi i kufiri ndarës mes dy dibrave, ku shpresojmë se “Rruga Europiane e Arbërit” që pritet të ndërtohet së shpejti, ta shkrijë këtë barrierë ndarës.

Për këtë qëllim në një takim të hapur publik dhe me praninë e medias, u promovua komiteti i rrugës së Arbërit si dhe struktura drejtuese e tij.

Me votim unanim komiteti zgjodh struktura drejtuese të grupit të punës të përbërë nga një kryetar dhe dy nënkryetar, si më poshtë:

Znj. Yllka ÇAUSHOLLI, Kryetar i Komitetit për Rrugën e Arbërit

Z. Ibrahim KOLARI, N/Kryetar i Komitetit (përfaqësues i Diasporës Shqiptare në SHBA)

Z. Tofik JEGENI, N/Kryetar i Komitetit (përfaqësues i Inxhinjerëve teknik për Rr.Arbërit)

Grupi i punës, do të veprojë në mënyrë permanente duke marrë kontakte me institucione shtetërore, rrjete sociale, diasporën Shqiptare, specialist dhe profesionist me qëllim që në fund të punës së saj, të dali me një raport përfundimtar në lidhje me antikapat dhe problematikat teknike që shqetësojnë ndërtimin e kësaj Rruge. Komiteti do të marri takime dhe me drejtuesit e Bashkive nga ku kalon kjo rrugë, me qëllim paraqitjen dhe prezantimin e problematikës, dhe ndërmarrjen prej tyre të masave konkrete, për zbatimin e saj.

KRIJOHET KOMITETI I POSAÇËM AD-HOC PËR RRUGËN E ARBËRIT

Në kuadrin e Shoqatës Bashkësia Dibrane për mbrojtjen, nxitjen, zhvillimin, si dhe përfundimin sa me parë, qoftë edhe me procedura të përshtetura dhe sipas afateve dhe parametrave tekniko-inxhinjerike të “Rrugës së Arbërit”, një ndër prioritetet më të rëndësishme të SHBD-SH, por edhe si një rrugë e cila lidh më tej kombin Shqiptar me njëritjetrin. Kjo Bashkësi merr inisiativën për ngritjen e një Komitetit të posaçëm ad-hoc për Rrugën e Arbërit. Për të realizuar këtë inisiativë, është menduar krijimi i një grupi pune, për këto qëllime:

1. Të llobojë me të gjitha kapacitetet e tij teknik, profesional, intelektual dhe mediak, që Rruga e Arbërit është një rrugë e cila sjell zhvillim (ekonomik, social, kulturor, turistik etj.) për të gjithë pjesën e Shqipërisë dhe veçanërisht asaj verilindore por dhe rajonit, ku kjo rrugë kalon.

2. Të shfrytëzojë mundësitë për të bërë të mundur që kjo arterie e rëndësishme kombëtare të përfundojë në afatet e caktuara kohore, pra në vitin 2013, e të mos ketë shtyrje pa limit të ndërtimit të saj.

3. Kjo rrugë do të mundësojë ndër të tjera një lidhje shpirtërore por dhe një bashkëpunim më të ngushtë në të gjitha fushat e jetës me popullsinë shqiptare në Republikën e Maqedonisë.

QËLLIME TE POSAÇME:

1. Zbatimin e standarteve sa me të larta bashkohore Europiane për këtë korridor të rëndësishëm: projektues, ndertimore, të sigurisë, të shpejtësive të levizjes, të infrastruktures shqetësuese (sinjalistike, vepra arti, cilesi asfalti dhe punimesh etj.).

2. Përzgjedhje e firmave ndertimore nga me cilësoret dhe munde-sisht tenderimi për kompani të huaja dhe me eksperience. Moslejimi i ndërtimit të veprave të vecanta (tunele, ura) nga kompani të panjohura dhe pa eksperience në këto lloj veprash. Moslejimi i kompanive

ndertimore vendase, në uljen e parametrave të rrugës duke ndryshuar vepra të rëndësishme të saj.

3. Arritja e efikasiteteve dhe efektivitetit maksimal në ndërtimin e Rrugës së Arbërit, sipas parametrave dhe rregullores tekniko-inxhinjerike të miratuar nga BE-ja.

ORGANIZIMI

Ky KOMITET do të veprojë i organizuar në njësi të veçanta në të cilën do të marrin pjesë figura të ndryshme të jetës akademike, artistike, profesionale dhe të diasporës, të cilët e konsiderojnë si shumë të domosdoshme përfundimin me sukses dhe në kohë të kësaj rruge që forcon më shumë shpirtërisht kombin shqiptar, përtej kufijve.

-Komiteti vepron me mbledhje dhe takime pune periodike, dhe me pjesëmarrje nga bota akademike, studiues të ndërtimit të rrugëve ku do të përfaqësohen: Konferenca, ërkshope, takime-shtypi etj.

- çfarë synohet nga puna e këtij Komiteti/Grupi pune:

- Të dale me disa rekomandime dhe të apelojë mangësitë e shfaqura deri tani në implementimin dhe zbatimin e projektit të ndërtimit të saj.

-Të këshillojë autoritetet shtetërore se kush janë antikapat e deritanishme të hasura për Rrugën e Arbërit.

- Te përfshijë në grupin e punës intelektuale shqiptare nga shoqatat simotra në Republikën e Maqedonisë (veçanërisht në Dibrë), të cilët të kërkojnë dhe të nxisin përfshirjen e pjesës së Rrugës së Arbërit në territorin fqinj, në prioritetet e qeverisë Maqedonase. Ata të nxisin përshtetimin e planifikimit dhe të realizimit të kësaj veprë në pjesën e territorit të maqedonisë.

-Të konkludojë qëndrimet e grupit të punës, duke u konsultuar dhe me autoritetet shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe me ato të Republikës së Maqedonisë, si me grupet e interesit, të cilët ndjekin me shqetësim ecurinë e ndërtimit të saj.

-Dalja me një deklaratë për shtyp të grupit të punës (vizive/të shkruara), duke parashtruar të gjitha përfundimet e harritura nga komiteti.

SAIMIR SHATKU



SHOQATA “BASHKËSIA DIBRANE”:

Të dekorohet Abdurahman Dibra

Me motivacionin “për kontribut të rëndësishëm në ngritjen e arsimit shqiptar”

Në mjediset e Shoqatës Bashkësia Dibrane, u zhvillua mbledhja e radhës së kryesisë së SHBD. Duke nisur diskutimin e tij kryetari i SHBD, dr. Faruk Borova, foli në fillim mbi programin e aktiviteteve të Shoqatës të cilat ishin realizuar për periudhën shtator 2010-qershor 2011.

Gjithashtu si një pikë e veçantë e diskutimit ishte dhe çështja e dekorimit të Z. Abdurahman Dibra (ish Ministër në disa kabinete të qeverive të Mbretërisë Shqiptare) me motivacionin për kontribut të rëndësishëm në ngritjen e arsimit shqiptar, ku Shoqata Bashkësia Dibrane ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dokumentacionin përkatës për dekorim. Prof. dr. Arian Kadiu, anëtar i kryesisë së SHBD, tha në këtë mbledhje se kjo figurë zë një rol shumë të rëndësishëm në figurat e jetës politike dhe publike të vendit tonë, dhe ku në të ardhmen shoqata Bashkësia Dibrane, duhet ti rezervojë një aktivitet të posaçëm këtij personaliteti-theksoi Z. Kadiu në fjalën e tij.

Një ndër diskutimet më të rëndësishme të mbledhjes së kryesisë së SHBD ku ju rezervua dhe një vëmendje e veçantë, ishte dhe ecuria dhe zbatueshmëria e projektit të ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Për të njohur se deri ku ka mbërritur kjo rrugë, faza e ndërtimit të saj e cila është me interes të veçantë për të gjithë Shqiptarët por dhe për komunitetin shqiptar në trevat dhe diasporë, ishte i ftuar projektuesi dhe zbatuesi i kësaj veprë, dr. Faruk Kaba.

Ndër të tjera Z. Kaba, informoi kryesinë e SHBD, se zbatueshmëria

e Rrugës së Arbërit, deri tani ka hasur problem shumë serioze dhe me mjaftë kosto menaxheriale si dhe tekniko-inxhinjerike, nga ato që pretendojnë të realizojnë ndërtimi e saj. Në një pyetje që ju bë projektuesit Z. Kaba, “se kur pritet përfundimi zyrtar i saj”, ai theksoi se: Deri tani rritmet e ndërtimit po ndjekin një trend jo shumë të kënaqshëm, duke qënë se ende nuk janë zhvilluar disa faza tenderimi. Kurse N/kryetarja e SHBD Znj. Mira Pirdeni, tha se kjo situatë qënka shumë shqetësuese dhe propozoi krijimin e një lobingu gjithëpërfshirës me ekspert, studiues, e specialist, ku të parandalonjë këtë problematikë.

Duke marrë në konsideratë tërësinë e antikapeve të shfaqura, si dhe mosrespektimi e standarteve të deritanishme të ndërtimit të Rrugës së Arbërit, kryesia e SHBD propozoi krijim e një komiteti apo grupi pune të posaçëm me inxhinjer, akademik, studiues, me qëllim që të japin ndihmesën e tyre që kjo rrugë teper e rëndësishme të përfundoi sipas parimeve, standarteve të rregullores dhe normativave europiane të rrugëve, me arsyetimin që kjo rrugë të mos përfundoi e dhunuar mos më keq.

Për këtë arsye në ditët në vijim, ky komitet do të formësohet, dhe do të marrë mendimin e anëtarëve të tij (specialistëve), duke nxjerr në pah disa vërejtje, si dhe problematika të shfaqura deri tani, në zbatimin e projektit të ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Gjithashtu ky grup pune, do ti bëjë prezente këto shqetësime dhe për komunitetin dibranë të SHBD e veçanërisht për publikun. /S.Shatku

Inxhinieri RAMADAN

BUNÇI: “Punimet kanë nisur tek ish ofiçina e artilerisë dhe zgjaten deri tek Shkalla e Tujanit, distancë kjo në kilometër është 5. 4 km e cila ndërtohet me buxhetin e shtetit me një fond prej 2. 332. 963. 024 lek. Në pamje të parë duket distancë e shkurtër kjo, por është e gjitha trase e re dhe ka shumë volume pune për të kryer”



“Do të ndërtohen 4 ura të cilat në fakt janë në përfundim vetëm presin trarët të hidhen sipër, do të përdoret 1100 ton hekur. Kemi për të ndërtuar një tunel me gjatësi 70 metra linear. Me të gjithë këtë volum pune ne kemi një afat për ta përfunduar këtë lot, por nga puna që kemi bërë deri tani shpreh bindjen se ne do ta përfundojmë para afatit”

Bukurinë luginës ia shton Rruga e Arbërit

Nga: **SHAQIR SKARRA**

Isha ngjitur disa herë në majën e Murrizës, e cila pret nga dita në ditë të shpohet tej e tej me tunel për të bashkuar Dibrën me Tiranën. Isha ngjitur edhe nga fshati Fshat sipër Klosit por edhe nga Zallbastari. E sot këtë mëngjes të freskët shtatori nuk do të ngjiteshim në këtë maje të lartë e të bukur ku duket si në pëllëmbë të dorës Tirana. Bashkë me dy miqtë e mi, Osman Miha dhe Shaqir Jashari, do të kalonim disa orë luginës së bukur të Tujanit, luginë kjo që jo vetëm vendasit, por ka mahnitur shpesh dhe turistët e huaj dhe që prej disa muajsh e ka humbur qetësinë e dikurshme. Mëngjesi na gjeti aty ku fillon dhe ajo që quhet “Rruga e Arbërit”. Një tabelë orienton këdo që shkel për herë të parë në këtë zonë por dhe vetë traseja që sapo ka filluar të gjarpërojë kësaj luginë nuk ka vështirësi të madhe për t’u orientuar. Ura e Brarit nuk ka ndryshuar fare, ashtu është si shekuj më parë kur është ndërtuar, me një hark të vetëm që bashkon dy brigjet e lumit të Tiranës. Ajo nuk “trembet” as nga zhurmat e mëdha të eskavatorëve dhe makinerisë së rëndë që punojnë luginës së Tujanit, as nga lëvizjet e shumta të puntorëve dhe udhëtarëve të ndryshëm, as nga plasjet e eksplozivit që shemb masive të mëdha shkëmbi. Ajo kështu qëndron si gjithmonë duke u treguar njerëzve për hershmërinë që ka e cila bind këdo edhe nga myshqet që kanë mbuluar gurët e saj. Dhe kështu ende qëndron në këmbë edhe pse nuk ka pësuar kurrë ma parë ndonjë rishikim të kësaj ane. E vetmja që është “trembur” dhe ka pësuar ndryshime të mëdha është ish ofiçina e artilerisë dikur objekt i rëndësishëm së veçantë. Sot në hyrje të saj orienton këdo një tabelë ku lexon qartë: “Rruga e Arbërit. Dhe traseja e rrugës më të re që shpejt do të bashkojë Dibrën me Tiranën këndej kalon mes për mes ndërtesave të vjetra të ish ofiçinës së artilerisë dhe zgjaten poshtë rrugës ekzistuese të Zallbastarit. Megjithëse

brenda saj kishte ende ushtar me uniformë, këto ndërtesa tashmë dhe të amortizuara e kishin humbur funksionin e dikurshëm si zonë ushtarake. Traseja zgjatet në krahun e majtë të lumit deri në afërsi të Shkallës së Tujanit. Makinën e lamë diku poshtë e u nisëm të tre më këmbë në trasenë e re të sapo hapur që zgjatej paralel me lumin e Tiranës.

-Qenka bërë një punë vërtet e mirë, një punë goxha e madhe thotë Osmani dhe në një kohë rekord. Vetëm tre muaj ka që kanë filluar punimet në këtë lot dhe ja ndërtimi i trasesë po thuaj qenka mbaruar. Do të jetë pikërisht kjo rrugë që po hapet që do ta zbukurojë edhe më shumë luginën e Tujanit. E vërteta në fakt kështu ishte. Edhe një sy i pavëmendshëm shikonte se tashmë lugina e njohur e Tujanit kishte pësuar shumë ndryshime. Një trase e gjatë rruge që gjarpërontë anës lumit, skarpata të larta që eskavatorët e mëdhenj germonin vazhdimisht dhe e shkëmb, vepra arti si mure, tombino e këmba ure të ngritura që prisnin vetëm trarët sipër.

“Ju lumshin duart bir!”

Sapo kalojmë urën e Brarit diku poshtë rrugës ekzistuese një kantier ndërtimi, një kantier jo do si do por mjaft i madh me ndërtesa dhe makineri të ndryshme. Firma që ndërton këtë lot “Gener 2” SHPK e ka marrë seriozisht ndërtimin në kohë e me cilësi të këtij loti se thua gjithë makinerinë e rëndë që disponon e ka çvendosur në luginën e Tujanit. Me inxhinierin e ndërtimit si dhe drejtorin e këtij sektori zotin Ramadan Bunçi e kishim lënë më parë për ta takuar por në fakt ai ndodhej në objekt.

-Ecni pak ma sipër se e takoni inxhinierin pa vajtur tek Shkalla e Tujanit na thotë Pjetër Lasku, një teknik ndërtimi i cili seç po lidhej me një radio me vetë inxhinierin. U nisëm më këmbë, fundja ishte bukur të shkelje nëpër këtë trase të sapo hapur që gjarpëronte buzë lumit.

-Hera e parë që shkel këndeje – thotë Osmani, por desha të di gjurmën e rrugës këmbësore që kanë shkelur vite ma parë dibranët tanë.

-Ja, sipër atij masivi mali, vështro me kujdes dhe ende duket gjurma, u fut në bisedë Shaqiri. Dhe

vërtet dukej gjurma sado që rrezet e diellit edhe na pengonin pak të vështrojmë me kujdes shpatin matanë lumit. Një furgon me pasagjer ndaloi tek këmbët tona. Një plak që udhëtonte me këtë furgon zbriti poshte dhe u drejtua tek një manovrator i cili po gërmonte në një skarpatë të lartë e pastaj mbushte makinat e mëdha që prisnin poshtë.

-Po vij që ng Zallbastari me këtë furgon pasagjerësh. Ju pashë se çfarë pune keni bërë e ndaj zbrita veç t’ju përgëzoj me gjithë shpirt. Me këtë rrugë që po bëni e zbukuruat dhe këtë luginë, i dhatë jetë e gjallëri. Nuk kam ç’të them më shumë veçse t’ju uroi shqiptarçe Ju lumshin duart! Furgoni u nis përsëri për udhë e ne vazhduam trasenë e re të sapo hapur. Me inxhinier Ramadanin nuk e patëm të vështirë të takoheshim. Siç duket atë e kishte njoftuar Pjetri ma parë për praninë tonë dhe kështu na priste në afërsi të Shkallës së Tujanit pikërisht aty ko do të hapej dhe një tunel me gjatësi 70 metra. Inxhinier Dani siç i thoshin të gjithë njeri tepër i thjeshtë dhe mjaft i komunikuar pasi u la detyrat manovratorëve të cilët po punonin në një gërmim skarpate u drejtua nga ne.

-Më falni se u vonova pak, e dija se do vinim por ja puna ka dhe të papriturat e saj. Tashmë jam në dispozicion tuaj. Kështu u nisëm të tre në këmbë drejt kantierit por përsëri duke vështuar gjithçka që ndodhte gjatë kësaj traseje. Inxhinieri ishte i përqëndruar që tek puntorët, tek manovratorët, tek mjetet që kishin filluar të lëviznin nëpër trasenë e re e deri tek sigurimi teknik në rrugë. Edhe kantieri i zhurmshëm ishte ashtu sikur dhe traseja. Edhe këtu punohej me të njëjtin ritëm. Përveç personelit inxhiniero-teknik kishte këtu poshtë dhe mjaft hekur kthyes, karpantier, manovrator me betoniere të mëdha.

-Kjo pjesë rruge që po punojnë quhet lot -1, nisi bisedën Ramadani sapo u futëm në zyrë dhe po na tregonte mbi hartën që kishte të varur në mur. Punimet kanë nisur tek ish ofiçina e artilerisë dhe zgjaten deri tek Shkalla e Tujanit, distancë kjo në kilometër është 5. 4 km e cila ndërtohet me buxhetin e shtetit me një fond prej 2. 332. 963. 024 lek. Në pamje të parë duket distancë e

shkurtër kjo, vazhdon Dani, por mos harrojmë se është e gjitha trase e re dhe ka shumë volume pune për të kryer:

-Do të gërmohen 470. 000 metra kub shkëmb i fortë, gëmime e mbushje të tjera 70. 000 metra kub, transporte e çvendosje material 520. 000 metra kub, shtresa 50. 000 metra katrorë, vepra arti betone 25. 000 metra kub. Do të ndërtohen 4 ura të cilat në fakt janë në përfundim vetëm presin trarët të hidhen sipër, do të përdoret 1100 ton hekur. Kemi për të ndërtuar një tunel me gjatësi 70 metra linear. Me të gjithë këtë volum pune ne kemi një afat për ta përfunduar këtë lot, dhe afatin e kemi 24 muaj nga dita e fillimit, por nga puna që kemi bërë deri tani shpreh bindjen se ne do ta përfundojmë para afatit. Me datën 20/05/2011 kemi filluar punën në këtë lot. Sot kanë kaluar nga qershori e deri tani në shtator afro dy muaj e pak. Me volumin e punës që kemi kryer, me gadishmërinë e të gjithëve që tek personeli inxhiniero-teknik deri tek puntorët dhe manovratorët jam i bindur se do jemi në Shkallën e Tujanit shumë më përpara objektivit. Deri tani kemi përfunduar gërmimet në masën 25%, kurse të gjitha veprat e artit në masën 45%. Por kur flasim për këto shifra të larta që kemi kryer në këtë periudhë të shkurtër kohe nuk mund të lëmë pa përmendur punën e madhe që kanë bërë që tek personeli inxhiniero-teknik e deri tek manovratorët e puntorët shembullor si inxhinier Ukshin Sokoli e Ervis Prifti, manovratorët Adriatik Hoxha, Myslim Çullhaj, Xhelal Masha, puntorët Flori Tola, Bujar Sula, Safet Allaraj, Gafur Gjura, Demir Borishi e Ndrim Reçi. Ju kërkoj ndjesë të tjerëve që nuk munda ti përmend të gjithë, shprehet gjithë modesti inxhinier Dani por kjo punë vërtet e madhe nuk është bërë por sejcili nga ne ka vlerat, djersën dhe mundin e tij e ndaj jemi optimist se do ta realizojmë objektivin tonë shumë kohë para afatit. U larguam vone nga kantieri dhe premtuam se do të ktheheshim përsëri, do të vinim kur tuneli i vogël prej 70 metrash të kishte mbaruar e bashkë me të dhe kjo distancë e rrugës së Arbërit prej 5. 4 kilometrash, e lot-2 do fillonte shpejt drejt hyrjes së tunelit Murrize.

Në vend të një reportazhi tjetër

Sapo kaluam urën e Brarit dhe makina filloi të rrëshqas me shpejtësi ishte pikërisht Osmani që na ftoi për një kafe pas këtij udhëtimi që bëmë në rrugën më të re.

-Ishim mësuar në qendër të Tiranës ku kryqëzoheshin rrugët e Kavajës, Durrësit, Elbasanit e Dibrës, nis bisedën Osmani, por vetëm rruga e Dibrës nuk arrinte deri në fund. Fundi i saj ishte diku afër ish ndëmarjes Rruga Ura. Sot ja pikërisht këtu ku do të filloj së shpejti dhe unaza e madhe e Tiranës nis rrugëtimin e saj të pandalshëm ma edhe rruga e Dibrës apo që quhet tashmë shpesh Rruga e Arbërit. Kjo rrugë është që kalon nëpër këtë zonë me një gjatësi prej 70 kilometrash jo vetëm shkurtton në mënyrë të ndjeshme distancat e transportit që lidh Tiranën dhe portin e madh të Durrësit me Dibrën, Peshkopinë, Matin, Shkupin, por kalon edhe pranë 37 monumenteve të kulturës që gjenden në luginën e Matit. Pikërisht thjesht për tu njohur ma mirë me këto resurse “Agjensia për mbështetjen e shoqërisë civile” ka organizuar para pak ditësh një udhëtim me gazetarë që kanë përshkruar gjithë këtë rrugë dhe luginën e Matit. Duke filluar nga Bllata, kufiri shtetëror me Maqedoninë, përgjatë brigjeve të lumit Drin dhe Mat, mund të shijohen bukuritë e natyrës, ushqimet e zonës, pse jo dhe plazhin në zallin e lumit, ku dikur laheshin vetëm ambasadorët e huaj. Ndërsa ndër monumentet kulturore që mund të vizitohen përgjatë gjithë gjatësisë së kësaj rruge janë: kalaja ilire në Xibër, kalaja e Petralbës (Guri i Bardhë), kulla e Pjetër Budit në Gur të Bardhë, shtëpia muze në Klos-Katund dhe hani i Allushit në Plan të Bardhë. Këto vetëm për zonën e Matit ku kalon traseja e kësaj rruge. Megjithatë kjo le të mbetet për një reportazh tjetër, atëherë pikërisht kur ky objekt i rëndësishëm jo vetëm për Dibrën por dhe më gjërë do të bëhet si e vetmja arterie e vendit ku dhe turistët e huaj kanë të drejtë të shkelin e të vizitojnë këto monumente kulture që ndodhen në këtë zonë aq të njohur por që infrastruktura rrugore ka patur munguar.

(Vijon nga numri i kaluar)

Nga: **HAKI PËRNEZHA**

Shtrirja e konaqeve në fshatrat tjerë

Rreth viteve 1800, në çdo fshat të Çidhnës kishim nga një bujar feudal vendas i cili ishte diferencuar ekonomikisht edhe falë përfitimit në vjeljen e disa taksave. Këta bujarë-feudalë të vegjël, u vendosën si më poshtë: Spata në Çidhën të Poshtëme; Alia në Mustafë; Noka në Çidhën të Epër; Kaloshi në të dy Sinët; dhe Lusha në Arras. Në vitet e para të shek XIX në Krahinën e Çidhnës edhe për shkak të ardhjes së një numri të madh fisesh, ishte rritur shumë numri i banorëve (frymëve). Në fakt bujarët e vegjël të Çidhnës ishin të interesuar për shtimin e numrit të banorëve në fshatit-konakut pasi në fund të fundit ata do të vilnin më shumë taksa. Përkundër dëshirës për të pranuar njerëz nga “perëndimi” sasia e tokës në përdorim ishte gjithnjë e më e vogël dhe ajo çdo vit e më pak plotësonin nevojat e tyre. Kjo bëri që atëherë krerët e konaqeve të hidhnin vështrimin drejt tokave të lira në anën lindore të Drinit si në Laçes; Blliçe; Fushë Alie; Kandërr; Kuke Kastriot etj. Pikërisht në këtë kohë filloi edhe lëvizja e fiseve “drejt fushës”.

Kaloshët e Sinës u vendosën në Kandërr bashkë me fiset Hasi, Kadriu etj; **Spata** u vendos në Blliçe të Epër, ndërsa fiset që e shoqëronin u ulën: Margjoni në Laçes dhe Manërkolli (Marknikolli) në Rrenx; **Lusha** dhe fiset e konakut të vet doli në Laçes por edhe në Fushë (Lazrejt) dhe Blliçe (Derti); **Noka** meqënëse ishte fis i madh u nda më dysh, njëri zjarr qëndroi në Çidhën te Epër (sot G. Noka) zjarri tjetër u vendos në Blliçe ndërsa grupi i fiseve të këtij konaku Leshet u vendosën pothuaj në të gjithë krahinën e Çidhnës (në Kandërr, në Kastriot, në Fushë, në Zall Leshe dhe Kodër Leshe), Marçet që bëjnë pjesë po në këtë konak, u vendosën në Fushë, Laçes, dhe Skepi u vendos në Zall Leshe dhe Blliçe. Fiset e konakut të **Alie** zënë gati gjysmën e hapsirës së Mustafë pasi gjysmën tjetër e zënë fiset e konakut të Lushës (Lazrejt). Me një vështrim të shpejtë, mund të konstatohet se fiset e Lazreje dhe ato të Mustafë janë sëbashku që nga Livadhi i Ardhësve në Prt. Tek Hurdhat e Kroit të Vjetër ndodhen edhe “Hurdhat e Lazrit”, ndërsa më poshtë në prat kemi “Ara e Alisë” dhe “Ara e Carës”; pastaj në Mustafë: nga Laku i Kroit të Vit për nga Veriu janë ulë fiset që bëjnë konakun e Alisë dhe nga Jugu ato që bëjnë konakun e Lushës (Lazrejt). E njëjta ndarje është ruajtur edhe pas lëvizjes për në Fushë Alie. Pjesën vërtetë e zonës së fiset e konakut të Alie dhe pjesën jugore Lazrejt (konaku i Lushës). Pra këto lëvizje të fiseve nga Çidhna “malore” drejt asaj “fushore” edhe pse të shtrira në kohë, të krijojnë idenë e një lëvizje të organizuar (të kontrolluar). Patjetër së pleqësitë e konaqeve dhe krerët e fshatrave kanë arritur më parë në marrëveshje, në mënyrë që të ruhej “struktura e konakut”. Për një marrëveshje në lëvizjen drejt fushës na bën të mendojmë edhe fakti që në Fushë Alie banorët që kanë rënë të parët janë dy nga grupi i Mustafë (Bibë Alia dhe Skep Përmezha) dhe dy nga Lazrejt (Bibë Martin e Nikollë Cara). Më vonë kanë zbritur dhe janë ven-



ÇIDHNA, vështrim etnokulturor

dosur në Fushë edhe Marçet e Leshet e konakut të Nokës, Totet, Sulet dhe rrethasit të konakut të Alisë. Zbritja e shumë fiseve nga zona malore drejt zonës fushore nuk u bë në mënyrë kaotike por me një rregull perfekt. Dhe këtë rregull e kishin vendosur feudalët, krerët të konaqeve. Themi se kjo lëvizje e “kontrolluar” e fiseve në drejtim të fushës u bë në vitet 1750-1800 pasi i referohemi vitit të vdekjes së Bibë Alisë i cili edhe pse kish zbritur me shtëpi në F. Alie u varros në varret e Mustafë nën emrin e islamizuar Habib. (Kleriku i nderuar i Blliçes, Ramadan Hoxha, rastësisht ka zbuluar epitafin e varrit të Bibë Alisë në varrezat e fshatit Mustafë Aty shënohet data e vdekjes e cila ishte 1225 (kalendari hënor ose hixhri) e cila e kthyer ne kalendarin gregorian i takon vitit 1800. Duke hamendësuar se ai jetoi 60 vjet, mendojme se lindi në vitin 1740. Sipas këtij informacioni Bibë Alia ka jetuar në vitet 1740-1800 kohë e cila përkon me fushatën osmane për islamizimin e popullsisë).

Duke pasur parasysh lëvizjet e sipërshënuara le të bëjmë një pasqyrë të “shtrirjes” së konaqeve të krahinës së Çidhnës sot.

1. Konaku i Nokës: ka fise përfaqësues në këto fshatra: Grykë Nokë; Fushë Alie; Blliçe, Kastriot, Kandërr dhe në Brest të Poshtëm. Vendosija e fiseve: përveç fiseve të *G. Nokës* (Noka, Kariçi, Laçi, Muça, Pula, Hisa, Kollesh; në *Kodër Leshe* janë Leshet; në *Zall Leshe* Panet e Raxhet; në *Fushë Alie* ka Toskun, Kucën, Leshin; në *Blliçe* është vetë Noka por dhe Skura, e Pula; në *Kandërr* Leshi dhe në *Kastriot* Pana e Leshi

2. Konaku i Lushës: Përveç Lushës, në *Arras* janë edhe këto fise: Zhuka, Rasku, Dani, Tavani, Krrashi dhe Bajraktari. Në *Mustafë* janë këto fise: Kukeli, Kurti, Sava, Martini; Duka dhe në Fushë janë të njëjtët fise me ato të Mustafë duke shtuar Carën i cili nuk ka në Mustafë tjerët janë si ato shënuam më lart: Sava, Martini, Kukeli, Kurti më vonë edhe Zhuta. Si në Mustafë edhe në Fushë ky grup fisesh thirren Lazrej. Në *Blliçe*, përfaqësues i këtij konaku është fisi i Dertit. Një grup tjetër që ndodhet në këtë konak janë edhe Xhoçtë. Fiset e këtij grupi mi janë: Coli (në Mustafë), Repa, Pali, Begu në Rrethas dhe Xhoka (Xhokulleshi) në *Sule*

3. Konaku i Kaloshit Fiset që përbëjnë këtë konak sot janë të vendosur si më poshtë: Në *Sinë të Epër*, ndodhen këto fise: Loka, Pashnjari, Drizi, Doka, Shquti si dhe në *Sinë te Pusi* janë: Bardhe, Koltraka, Kadrie, e

Kovaç. Në *Sinë të Poshtme* ndodhen këto fise, në Zhgjerth: Zoku, Lika, Matrisi; në *Rrafshe* ndodhen Kaloshi, Priifti, Tafet, Gjegjet; ndërsa në *Kandërr* ndodhen pjesa tjetër e Kaloshve dhe Haset e Kadriet. Edhe në *Blliçe* ndodhet fisi i Kaloshit.

4. Konaku i Spatës: Ne *Çidhen të Poshtëme* ndodhen: Tola, Cerri, Basha dhe Kuta; Mahet: Kola dhe Koka; si dhe Dujsit: Përgjegji, Sala, Daci, Cani si dhe Mena. Në *Laçes*: ndodhen Bitri, Margjoni, Përgjegji, Basha, Kuta. Në *Blliçe* ndodhen: Spata, Tola, Ferra, Nezha, Bodi, Kuta, Manërkolli (në *Rrenx*), ndërsa në *Fushë* ndodhen Tola dhe Herçeku.

5. Konaku i Alisë: Fiste që përbëjnë këtë konak janë të vendosur si më poshtë: Në *Mustafë* ndodhen: Buci, Gjoni, Përnezha pastaj grupimi Prexhoj ku hyjnë 4 zjarret: Xhika, Brahishehu, Daci (ndryshe quhen Përxhilet) dhe Karoshi. Tjetër grup në konak të Alisë janë Sulet përfaqësues i të cilët është Toca. Në *Fushë Alie* ndodhen: grupi i parë i përbërë nga Alia, Përnezha, Buci, Manjani dhe Xhurxhi (vëlla i mbështetur); pastaj grupi i dytë i fiseve i përbërë nga Tota, Lala Xhaka dhe Hata në Brest; *grupi tjetër Sulet* ku përfshihen: Rrahmçunet, Xhoksulet, Kacanet dhe grupi tjetër i 4 zjarreve përfaqësues të të cilët janë Karoshi, Xhika dhe Brahishehu. Daci nuk ka pjesëtarë në Fushë Alie. Në *Blliçe* konaku i Alisë përfaqësohet nga i vetmi fis që është Tota; në *Rrenx* të konakut Alie janë Bushi dhe Doçi.

Nga një vështrim i kujdesshëm mund të vihet re se i vetmi fshat në Çidhën i cili ka përfaqësues nga të pesë konaqet e krahinës është Blliçja. Pikërisht për këtë fakt në gojën e popullit thuhet “Blliçja e pesë konaqeve”. Ndër pesë konaqet e krahinës ai i Spatës është i shtrirë duke pasë “përfaqësues” nga Lura në Korab. Ky konak ka fise të “tij” që nga Çidhna e Poshtëme në Laçes, në Fushë, në Blliçe e deri në Rrenx, fshatra që ndodhen në një “fashë” ose në vijë të drejtë dhe duke llogaritur edhe sipërfaqet në kullotat malore që ky konak ka në Pllajë dhe në Gramë, mund të themi se është konaku me shtrirje më të madhe në Krahinë. Për këtë arsye ky konak ndryshe thirret edhe “shporja e Çidhnës”. Për këtë konak përdoret edhe idioma “m’Cerrin e m’beterrin” që ka kuptimin ndajfoljes së sasisë “të gjithë” d.m.th gjithë konaku. Këtu përmendet fisi Cerri i cili ndodhet në pikën ekstreme të “shpores” së konakut, në perëndim, dhe në anën tjetër të shpores ndodhet “beterrri”. Kështu është stigmatizuar fisi i

Manërkollit në Rrenz.

Përveç fiseve që u përmendën apo u rreshtuan sipas konaqeve, në Çidhën, në kohë të mëvonshme kanë ardhë edhe shumë fise të tjerë të cilët kryesisht janë vendosur në fshatrat në të djathtë të Drinit. Pranimi dhe përshatja e këtyre fiseve në gjirin e krahinës ka të bëjë me forcën dhe influencën e sistemit të organizimit në Çidhën në bazë të konaqeve. Shumë shpejtë këta të “ardhur” krijojnë kumbari me fiset e afërta dhe me punë e sjellje zinin vend të nderuar në shoqëri e bëheshin pjesë formale e konaqeve. “*Adoptimi i njerëzve të huaj si anëtarë të “fisit” (“me ba vlla në katund”), qoftë si kolektiv, qoftë si individë me anë të vëllazërisë rituale (vëllamëri, kumbari), tregon mbijetesën e institucioneve fisnore të superstrukturës në mendësinë e njerëzve.*” (20) Fise të ardhur e të shndërruar në vëllazëri me fiset çidhnake janë të shumtë, ne mund të përmendim fisin Dauti, Shini, Përseku, Dani, Pajçi, Vlesha, Çakrri, Xhari, Budi, Maleçka, Keça, Kaloçi, Manovi, Xhaka (në Brest), Reka, Mazhi. Xhoçi e ndonjë tjetër. Rreshtimi i këtyre fiseve nëpër konaqet e Çidhnës nuk është i prerë. Ata, varësisht nga fiset me të cilët janë afruar e kanë marrëdhënie kumbarie, përmendin emrin e konakut më të cilin ndjehen më të “afërt”. Kështu Dauti ndjehet më afër me konakun e Nokës, Shini me konakun e Alisë, Përseku, Pajçi, Vlesha, Xhari, Budi, Kaloçi, Manovi etj ndjehen në konakun e Kaloshit; Mazhi e Maleçka në konakun e Spatës. Shehelerët e Rrenxit nuk janë të “parcelizuar” në konaqe, pasi ata e quajnë veten njerëz në shërbim të çdo fshati.

Organizimi në një konak. Pleqtë

Konaqet në Çidhën (fillimisht të formuar nga një për fshat, më vonë u shtrinë edhe në fshatra të tjerë) kishin një organizim të përsosur e të njëjlojtë mes veti edhe pse ishin krejt të pavarur nga njëri tjetri në ushtrimin e së drejtës vetëqeverisëse. Të pesë konaqet njiheshin e respektoheshin si “pesë vëllezër”, dhe kurrë nuk është vërejtur ndarje a diferencim për shkak të përkatësisë së ndryshme të konakut. Nuk njihet asnjë rast ku përkatësia e konakut, të jetë bërë pengesë në marrëveshje të ndryshme. Ndarja në konaqe e fiseve kish karakter krejtësisht formal e figurativ. Ajo, përkatësi, shërbente vetëm në rastet e organizimeve luftarake si p.sh. Nëse agait të konakut i kërko-

hej të sillte në luftë p.sh. 200 pushkë, ai do t’i nxirrte ato vetëm nga fiset e konakut të tij. Nga ana tjetër, përkatësia në një konak të caktuar u jepte banorëve të atij konaku të drejtë në shfrytëzimin e pronave të përbashkëta siç ishte mali, bleshka, meraja etj. Por, kjo ndarje në konaqe nuk sillte pengesë e as përfitim për sa i përket pleqërimeve. Çdo njeri ishte i lirë t’ia besonte zgjidhjen e problemit cilitdo plaku, pavarisht konakut ku bënë pjesë. Kjo “përzgjedhje”, në mënyrë të veçantë për problemet e koklavitura, lidhej në radhë të parë me përvojën e çdo plaku, me zotësinë e tij në zgjidhjen e situatave konfliktuale. Shumë kohë më parë çdo fshat drejtohej nga pleqtë ndërsa krerët ushtarak (të cilët më vonë u quajtën agallaë), mermin rëndësi e vireshin në krye të popullit vetëm në raste lufte. Ndryshimi i peshës a kalimi i qendrës së rëndësës nga pleqtë të agallarët, ndoshta, erdhi për shkak të situatës gjithnjë luftarake nëpër të cilën ka kaluar gjithë Dibra. Me forcimin e këtij roli çdo konak funksiononte si një shtet në miniaturë. Çdo konak kishte Qeverinë, Parlamentin dhe gjykatën e vetë. Le të bëjmë këto krahasime: Agai apo i pari i konakut, ishte si kryetari i qeverisë dhe përbënte “egzekutivin” në konak. Ai kishte detyrë të përcaktuar siç mund të përmendim: organizimi i popullit për luftë; marrja pjesë në kuvendet ku lidhej besa; mbështeste pleqtë apo horën e fshatit në egzekutimin e vendimeve të pleqësisë së konakut etj. Parlamenti i konakut apo “legjislativi” ishin mbledhjet e popullit të cilat, sipas rëndësisë së problemit, mund të zhvillohej me përfaqësues nga fiset ose zjarret. Në këto kuvende merreshin vendime të rëndësishme për konakun të cilët kishin të bënin me rregullat e administrimit të merave, vendoseshin karare për vaditjen, caktoheshin renat e ujit, vendosej për pranimin ose jo të ndonjë banori a fisi të ri, vendosej për pranimin ose jo të ndonjë nipi në hisen e shkretë të dajës së tij etj, etj. Gjykatën e konakut e përbënin **plaku i konakut, stërpleqtë e çekiçtë**. Plaku i konakut ishte personi më me integritet në fis. Ai mbante vulën (mihirin) e cila nuk dilte jashtë fisit. Brenda fisit të plakut vulën e merte kush “ishte për të” sepse thuhej se “zgjuarsia është me të dhanme”. Pra fisi nga i cili do të dilte plaku ka qënë gjithnjë i përcaktuar ndërsa personi që do mban- te vulën ndryshonte në kohë. Çdo konak kishte plakun e vet dhe në Çidhën meqënëse kishim pesë konaqe, numëroheshin dhe pesë pleqë. “*Pleqtë*, shkruan Xhafer Martini, *u përkisnin atyre shtëpive që ndër shekuj nuk kishin bërë asnjë veprim në kundërshtim me moralin*” (28). Plakun e çdo konaku mund ta konsiderojmë si “kryetar i gjykatës” së atij konakut. Përveç “kryetarit të gjykatës” çdo konak kishte edhe “trupën” gjyqësore e cila përbëhej nga “anëtarët e gjykatës” apo “*ndihmës gjyqtarët ose stërpleqtë si dhe “këshilltarët e gjykatës” ose çekiçtë*. Pra në secilin konak të krahinës përveç plakut siç e quajtmë “kryetar i gjykatës” kishim edhe anëtarët e tjerë të gjykatës, “ndihmës gjyqtarët” të cilët ishin stërpleqtë dhe “këshilltarët” që ishin çekiçtë.

(Vijon numrin e ardhshëm)

vendlindja

Historia e fshatit Viçisht të Dibrës, që ka më shumë dëshmorë se sa shtëpi me banorë të martirizuar në luftën kundër pushtuesve turq, serbë, bullgarë, austro-hungarezë, italianë e gjermanë, për liri e pavarësi kombëtare

Nga: **SAKIP CAMI**

Viçishti, sipas ndarjes së re administrative, bën pjesë në Komunën e Gjoricës, në rrethin e Bulqizës, Qarku i Dibrës. Në ndarjen e mëparshme administrative ky fshat ka bërë pjesë në Lokalitetin e Shupenzës i cili për nga rëndësia ka qenë njësi administrative rrethi në vitet e para të pas çlirimit.

Para çlirimit ka bërë pjesë në krahinën e Homeshtit, Nënprefekturën e Zërqanit dhe Prefekturën e Dibrës.

Komuna e Gjoricës ka sot aktualisht pesë fshatra, me 5834 banorë dhe 1369 shtëpi, (regjistrim i vitit 1992) konkretisht Gjoricën e Sipërme, Gjoricën e Poshtme, Çerenecin, Lubaleshin dhe Viçishtin.

Viçishti kufizohet në lindje me fshatin Tërbaç, me të cilin e ndan edhe përroi me të njëjtin emër, në veri lindje me lumin e Drinit të Zi dhe me viset shqiptare të Maqedonisë, konkretisht me fshatin Bofmollë, në veri me Kodrat e Gjoricës së Sipërme, me Çerenecin në veripërendim, me Lubaleshin në përendim, me Radoveshin në jug. Është fshati i fundit që kufizohet me krahinën e Gollobordës, por nuk ka tradita folklorike të përbashkëta me këtë zonë. Traditat dhe miqësitë i ka me Dibrën e Madhe dhe me Grykën e Vogël. I lidhur pazgjidhmërisht me këtë fshat është edhe fshati ose lagjeja e Sepetoves, e cila është e banuar nga banorë të fisit Cami dhe ka qenë lagje e Viçishtit.

Sipas defterit turk të vitit 1467 Viçishti ka patur 4 shtëpi, Golovishti 5 shtëpi dhe Izvira 3 shtëpi. Sepetova ka qenë lagje e Viçishtit dhe ka patur 3 shtëpi

Sipas rregjistrimit të vitit 1926, Viçishti ka patur 222 banorë dhe afërsisht 40-50 shtëpi. Në vitin 1976 Viçishti që përmbleh edhe Golovishtin e Izvirën kishte 90 shtëpi.

Fshati Viçisht ka një prejardhje të herëshme, në një kohë me Gjoricën, dhe Sepetovën.

Nga studimi etimologjik, fjala “Viçisht” ose “Veçisht”, siç i thërrasin shumë banorë të Dibrës, vjen nga fjala “veç”, sepse ky fshat është i veçuar dhe përbëhet nga katër lagje të veçuara, veç e veç. Me kalimin e kohës fjala “Veçisht” është shndërruar në “Viçisht”.

Pas largimit të dyndjeve sllave fshati është banuar nga fshatarë myslimanë të fiseve Cami, Lika, Izvira etj.

Historia e këtij fshati është më e hershme, që nga pushtimet e vjetra bullgare që donin të sllavizonin tokat e kësaj treve dhe të shkombëtarizonin popullsinë e zonës. Mendohet të jetë e njëkohshme me fshatrat e tjerë të luginës së Drinit.

Dhe jo rastësisht kanë mbetur emrat e tokave, pyjeve e përrenjve si p.sh. “Kisha e kaurrve”, “Livadhi i Ristos”, “Përroi i Petros”, “Arra e Blazhos”, “Përroi i Mitros” etj.

Tani kanë mbetur vetëm emrat e tyre dhe kockat tek kisha, pasi ky fshat me tradita i shporri me luftë invaduesit sllavë e bullgarë.

Lumi i Drinit të Zi buron nga Liqeni i Ohrit dhe pas daljes nga Liqeni i Dibrës së Madhe lag tokat e Viçishtit të Poshtëm e të Golovishtit. Pas vitit 1913 ka shërbyer si kufi shtetëror.

Dibra e Madhe, qyteti i preferuar për tregëti e pazar ka mbetur pa drejtësisht nga ndarja e vitit 1913 në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë duke mbajtur me vehte dhe dhjetra miqësira, krushqi, miq, nipër e mbesa, dajallarë e



xhaxhallarë e bashkë me to edhe dhimbjen e ndarjes në vite.

Viçishti ka qenë i lidhur që në kohët e hershme me Dibrën e Madhe me rrugë automobilistike nëpërmjet Urës së Spiles pranë Mireshtit, e cila është ndërtuar që në shekullin XV.

Pas ndërprerjes së tregëtisë me Dibrën e Madhe lidhjet kaluan me Shupenzën, Peshkopinë dhe direkt me Tiranën nëpërmjet rrugës së Arbërit e maleve të Tërnovës e të Martaneshit.

Dy rrugë automobilistike, ajo pranë kufirit shtetëror dhe ajo e Ramnagorës (Librazhdit) e fusin në mes duke ja bërë më të lehtë komunikimin, shtu këtu edhe rrugët bashkuese të Viçishtit qendër dhe Golovishtit.

Viçishti tani ka rreth njëqind shtëpi.

Fiset më kryesore të tij janë Cami, Lika, Suma, (Manjani), Xheka, Markja, Tola, Izvira dhe një shtëpi Dema e ardhur nga Homezhi dhe e zbritur përsëri në Homezh.

Viçishti ka katër lagje, Viçishtin qendër, Viçishtin e Poshtëm, (buzë Drinit të Zi), Golovishtin dhe Izvirën.

BETEJA KUNDËR HAJREDIN PASHËS NË FUSHËN E GJORICËS (Korrik 1844)

Fshatarët e Viçishtit dhe të fshatrave të tjera morën pjesë në betejën kundër Hajredin Pashës në Fushën e Gjoricës, ose në Fushën e Thatë siç njihet nga populli, vendi ku u zhvillua kjo luftë.

Ajo u udhëhoq nga figura të njohura si Sheh Mustafa Zërqani, Cen Leka, Mahmut Cami, Rizvan Alla, Mane Cami, Salë Markja, Fasli Malja, Shaqir Daci, Abdi Sturcja, Shaqir Jegeni etj.

FSHATI I TËRË PRANGOSET DHE BURGOSSET NË BURGUN FASHIST

Më 15 janar 1940 u ngrit një Grup Luftarak të rinjsh me në krye akademistin Ahmet Cami dhe të përbërë nga Fasli Feta Cami, Sefer Ramiz Cami, Ejup Shahin Cami, Uke Dullë Cami, Dullë Shaban Cami, Mahmut Dalip Cami, Spiro Velko, Mexhit Lezi, Hidër Rrahman Cami, Musa Rrahman Cami etj. Në këtë grup erdhën edhe Haxhi Lleshi dhe tre nipat e Camit, vëllezërit Lutfi, Imer e Hamdi Pëllumb Lleshi. Me 11 prill 1941 burgosen në një ditë: Ahmet Cami, Uke Cami, Dullë Cami, Adem Cami, Islam Cami, Izet Cami, Sulë Cami, Destan Cami, Remë Cami, Shahin Cami, Tufik Cami, Dilaver Cami, Ibrahim Buziu, Selim Mjeshtri, Bexhet Cami, Aqif Cami, Hidër Cami, Liman Cami, Taf Cami. Rifat Cami, Hasan Cami.

FORMIMI I BATALIONIT PARTIZAN TË DIBRËS, 26 KORRIK 1943

Mbledhja paraprake për rënien dakord për formimin e batalionit partizan të Dibrës, për vendin e organizimit dhe për komandantin u bë tek shtëpia e Uruç Karasanit në Radovesh. Aty u vendos që vendi të ishte Gjorica e

Spërme dhe komandant Haxhi Lleshi.

Krerët e Parisë së Dibrës dhe fashistët u përpoqën të na ndalonin, duke u bërë presione popullit të Gjoricës, por toka ku do të bëhej organizimi i batalionit ishte pronë e Zenel Camit dhe e pasuesve të tij, ishte kulla e Mahmut Camit, dhe për rrjedhojë askush nuk mund ta ndalonte. Influenca e Ahmet Camit, që jo rastësisht mbante edhe emrin e babait të Zenel Camit ishte e madhe. Këtu një ndihmë konkrete dha edhe imami i Gjoricës, Sheh Latifi i cili kishte të falura katër hektarë tokë nga Cami.

Në përbërje të batalionit ishin Çeta e Sllavës, Çeta e Grykës së Vogël, Çeta e grykës së Madhe dhe Çeta e Gollobordës.

BUJQ DHE BLEGTORË TË MREKULLUESHËM

Pas çlirimit të vendit shumica e fshatarëve përfituan tokë nga reforma agrare. Pati edhe fshatarë të mesëm që nuk u cënuan nga reforma. Pas reformës ky fshat u muar me bujqësi dhe me blegtori. Në vitin 1957 u formua kooperativa bujqësore e Viçishtit me kryetar Dilaver Likën. Më vonë kryetar kooperative ka qenë Mane Cami. Në vitin 1959 u bë bashkimi me kooperativën e Gjoricës. Kooperativa vazhdoi deri në vitin 1990.

Është një fshat i bukur dhe i begatë që ka pyje e kullota, ujëra të bollshme të pijëshme e për vaditje, toka prodhuese. Kultivohen të gjitha pemët si molla, rrushi, dardha, kumbulla, arra, gështenja, thana etj si dhe të gjitha perimet si domatja, kastravec, speci, qepa, patatja etj. Bima bujqësore që kultivohet më shumë nga dritërrat është misri, por rritet edhe gruri, thekra etj.

Rakia e thanës është jo vetëm pije e preferuar tradicionale por edhe një pije mjekësore kuruese.

Shtëpitë e ndërtuara përballë diellit, kopshet gjithashtu, u japin mundësinë që të shfrytëzojnë në maksimum energjinë diellore e të bëjnë dy prodhime në vit megjithëse është vend i ftohtë.

Ky fshat është i njohur për kultivimin e bimave të qepëvë, speceve e të lakrave duke i prodhuar me sera e duke i nxjerrë në prodhim që në muajt e pranverës.

Më pas mbjellin bimë të tjera e marrin prodhime të plota.

Po kështu mbjellin bimë hamullore e misër foragjer, përveç mbjelljes e prodhimit tradicional.

Shfrytëzimi i tokës së pakët, i ujit, dhe diellit është karakteristikë e banorëve të këtij fshati që njihet si fshat i begatë dhe shumë prodhues.

Është i rrethuar me pyjet e veta që janë dëmtuar por që me kalimin në pyje të komunitetit dhe me ndarjen sipas pronësise se dikurshme do të ringrihen edhe më të mëdha e më të mira. Lisat e gjatë e të shpeshte mbulojnë vendin me gjelbërim e freski. Bashkë me pyjet dhe midis tyre janë burimet ujore

që njihen me emrat e izvorëve të Viçishtit, të Golovishtit e të Izvirës që kanë ujë të ftohtë e të bollshëm që përdoret edhe si ujë i pijshëm dhe për nevoja të tjera. Në këto pyje e lëndina rriten me qindra kokë bagëti dele e dhi si dhe dhjetra lopë e viça që u sigurojnë këtyre banorëve qumësht, lesh e mish gjatë gjithë vitit, bile edhe për të shitur.

ARËSIMDASHËS DERI NË SAKRIFICË

Shkolla e parë është ndërtuar në vitin 1940 dhe ka filluar si kurs analfabetizmi me mësues birin e këtij fshati nxënësin e Shkollës Normale të Elbasanit, Fasli Cami. Zyrtarisht hapja e shkollës daton vitin 1944.

Nxënësit e Viçishtit ndiqnin mësimet në shkollën e Gjoricës e cila ka patur shkollë të sistemit 5 vjeçar me mësues Haxhi Skënderin ose Haxhi Ademin siç njihet nga populli, një mësues i reptë, por shumë i mirë. Një pjesë tjetër ndiqte mësimet në Internatin e Kastriotit dhe në shkollën e Zërqanit. Për një kohë të gjatë ka punuar si mësuese e shkollës fillore Femije Cami.

Nga shkollë fillore në shkollë 8 vjeçare u kalua në vitin 1968 me mësues e drejtor Emin Camin. Pas Eminit e mori drejtimin e shoqja e Eminit, Lirie Cami.

Drejtorë të tjerë në vitet e mëpastajme kanë qenë Nazif Sulku, Rustem Murrja, Avni Mera, Fisnik Manjani dhe Femi Lika.

Me ndikimin e drejtpërdrejtë të Tefta Camit, bijës së këtij fshati, (Ministre e Arësimit dhe Kulturës në vitet 1976-1986), u ndërtua shkolla e re e fshatit, dykatëshe dhe u shëndrrua nga shkollë 8 vjeçare në shkollë të mesme. Pas vitit 1990 për mungesë të numrit të nxënësve dhe të arësimitarëve të kualifikuar u kthye përsëri në shkollë 8 vjeçare. Shkolla mban emrin e mësuesit të parë, birit të këtij fshati, dëshmorit Fasli Cami. Shkolla tjetër e fshatit Gjoricë mban emrin e Komandantit të Çetës së Gollobordës Ahmet Camit. Me ndërhyrjen dhe përkujdesjen direkte të Tefta Camit, ministre e arësimit në vitet 1976-1987, u ndërtuan disa shkolla të reja në rrethin e Dibrës dhe veçanërisht në zonën tonë si në Viçisht, Gjoricë, Zërqan etj

Në shkollën e Viçishtit kanë shërbyer shumë mësues nga ky fshat si Fisnik Manjani mësues dhe drejtor, Destan Cami, Fehmi Lika, mësues dhe drejtor, Rustem e Zurie Murrja, Avni Mera, Bashkim Lila, Mehmet Leci, Fadil Cami, Latif Dema, Hashim Suti, Shemsi Ceka, Ajet Suma, Mereme Cami, Donika Cami si edhe dhjetra mësues nga fshatra të tjera e rrethe të tjera.

Një nga nxënësit e kësaj shkolle ka qenë edhe gazetari, deputeti, politikani, ministri Luan Mersin Rama.

* * *

Ky ishte një vështrim i shkurtër për këtë fshat të vogël, që ka më shumë dëshmorë se sa shtëpi, që ka nxjerrë figura kombëtare dhe kuadro që kanë drejtuar vendin.

Bujaria shqiptare dhe meskinllëku maqedonas



Nga:
**Rexhep
TORTE**

Me shekuj shqiptarët kanë qenë përkrah maqedonasve me bujari e trimëri, saherë që maqedonasit kanë qenë në rrezik. Nuk mund të gjejmë asnjë shembull që shqiptarët t'u kenë bërë hile maqedonasve.

Përkundrejt kësaj kemi shembuj të shumtë të sjelljeve armiqësore të maqedonasve ndaj shqiptarëve. Mos shkojmë më larg, në Kryengritjen e Ilindenit me çka aqë shumë mburren maqedonasit, shqiptarët luftuan përkrah maqedonasve, por kjo sakrificë e shqiptarëve fshehet dhe aspak nuk përmendet në përvjetorët që shënohen në Meçkin Kamen të Kruшевës. Pas vitit 1912 kur Shqipëria u shpall e pavarur, kur gllabëroheshin trojet shqiptare, maqedonasit u vunë në krah të serbëve e bullgarëve kundër shqiptarëve.

Gjatë LNÇ-së 1941/45, shqiptarët luftuan sëbashku me maqedonasit kundër nazifashizmit, por pas luftës shqiptarët u persekutuan, u burgosën e u vranë, kur maqedonasit u vunë në shërbim të plotë të UDB-së jugosllave kundër shqiptarëve.

Me ardhjen e pluralizmit dhe demokracisë në Maqedoni, vazhdoi avazi i vjetër i maqedonasve ndaj shqiptarëve. Kjo dëshmohej me ngjarjet tragjike të Gostivarit për Flamurin Shqiptar, me ngjarjet tragjike të Tetovës me rastin e hapjes së Universitetit të Tetovës, pastaj me ngjarjet e Radolishtit, Bit Pazarit, Tanushës, Sopotit dhe shumë ngjarjeve tjera, kur të rinjtë maqedonasit helmomin e kërkonin edhe dhoma gazi për shqiptarët.

Të gjitha këto sollën edhe luftën e UÇK-së me të vetmin qëllim që shqiptarët t'i fitojnë të drejtat e tyre legjitime për të qenë të barabartë me maqedonasit. Për këtë u nënshkruajt edhe Marrëveshja e Ohrit në vitin 2001, si vullnet i mirë për tu ndalur gjakderdhja e me garanci të faktorit ndërkombëtar. Këtij viti u shënuat 10 - Vjetori i kësaj marrëveshje, e cila për fat të keq ende nuk është realizuar plotësisht. I tërë faji për zvarritjen dhe mosrealizimin e kësaj marrëveshje sërish qëndron te maqedonasit, të cilët në vazhdimësi nxjerrin nëpërkëmbëza dhe pengojnë realizimin e kësaj marrëveshje. Kjo marrëveshje është dashur të realizohej me kohë, por edhe të ishte pasuruar me vlera edhe më të mira për shqiptarët.

Shënimi i 20 - Vjetorit të Pavarë-

sisë së Maqedonisë më 8 shtator 2011, nuk la shpirt shqiptari pa e zemëruar dhe irrituar. Kjo sepse maqedonasit këtë manifestim e bënë pa shqiptarët, edhe pse para botës vazhdimisht deklarojnë se janë për barazi e demokraci. Maqedonasit nuk qenë të denjë të ftojnë asnjë këngëtar e ansambël shqiptar në hepeningun e organizuar në shënimin e këtij njëzet vjetori, edhe pse në këtë shtet në trojet e veta etnike jetojnë më shumë se 30 përqind shqiptarë. Të tillë janë maqedonasit. Këtë me siguri e vërrejtën edhe ambasadorët dhe organizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Shkup.

Të ndalemi pak te shënimi i 20 - Vjetorit të Pavarësisë së Maqedonisë. Fjala e urtë populllore shqiptare për diçka që nuk përputhet me rrethanat dhe realitetin, thotë se, "Nuk i ngjan peri gëzofit", ndërsa për të njëjtën gjë kroatët, thonë, "Këmbe e likasit në këpucën vijeneze", duke e ditur se këmba e madhe e dalmatinasit nuk mund të hyn në këpucën elegante të Vjenës. Këtyre dy thënieve të urta populllore u ngjante edhe Maqedonia në këtë përvjetor.

Organizimi aqë masovik i autobusëve dhe mikrobusëve për udhëtim falas, nga tërë Maqedonia për në Shkup, për të marrë pjesë në sëleminetin qëndror, përbën gënjeshtër më të madhe shtetërore, sepse paratë për këtë gjoja udhëtim falas, shteti ia ka marrë popullit me kohë, ose do t'ia merr fill pas kësaj nëpërmjet taksave e tatimeve të ndryshme. Fundja ne nuk dëgjua asnjëherë që Gjorgje Ivanov, kryetar shteti, Trajko Veljanovski, kryeparlamentar apo Nikolla Gruevski, kryeministër, të deklarojnë publikisht se për këtë manifestim kanë dhënë para nga xhepi i tyre i majmë.

Një pjesë e popullit udhëtoi nga periferia në Shkup, për të pa nga kurreshtja se çka është ndërtuar me projektin "Shkupi 2014", ose të nxitur nga emisarët partiakë të VMRO-DP-MNE.

E ç'anë të shohin 400 mijë të papunët në Maqedoni, veç ndërtesave grandioze të ministrive të ndryshme, disa rrugëve të zgjeruara dhe trotareve të pllakëzuara, monumenteve gjigante historike maqedonase dhe skulpturave të luanëve ardhacakë, sepse në nënqiellin tonë rriten vetëm arrusha, ujë e dhelpira, por jo edhe luanë. Këtu del sheshazi edhe simbolika mashtruese e këtij shteti. Historia e Shkupit është e lidhur ngushtë me shqiptarët, ndaj është dashur që të ngriten në të njëjtën kohë edhe monumentet e shumë personaliteteve të shquara historike shqiptare. Edhe për këtë fajn e kanë vetëm maqedonasit.

Një fjalë tjetër e urtë populllore thotë se, "Dyqani e blen shtëpinë, ndërsa shtëpia dyqanin jo". Kjo filozofi e urtë e popullit, tregon se dyqani përbën punën. Duke punuar e fituar

krijohet kapitali që pastaj mundëson të blesh edhe shtëpinë.

Sa i lumtur do të ishte populli në Maqedoni, sikur shteti miliona euro që po i shpenzon për projektin "Shkupi 2014", t'i kishte shpenzuar për ndërtimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme nëpër tërë Maqedoninë, ku do të punësoheshin qindra mijëra të papunë, me ç'ka do të rritej dukshëm mirëqenia popullit, se sa këto monumente e ndërtesa të ftohta që nuk mund ta kënaqin asnjërin me barkun bosh. Të zbatosh Projektin "Shkupi 2014" në këtë krizë ekonomike globale, kur kanë rënë në gjunjë të bankrotit shumë shtete të fuqishme, s'është gjë tjetër veçse një aventurë donkishoteske. Kjo është Maqedonia me perin që nuk i ngjan gëzofit.

Njollë e zezë e këtij manifestimi ishte edhe përlotja e zemërimi i 17 nxënësve shqiptarë të klasës së parë të Nerezit në shkollën fillore "Bratstvo" në Komunën Karposh të Shkupit, për shkak të moshapjes edhe të një klase në gjuhën shqipe. Lajm që me ditë qarkulloi në mediumet në Maqedoni. Nën presionin që inspektorët e arsimit ushtruan mbi prindërit e nxënësve se do t'i dënojnë me nga 1000 euro, këta voglushë shqiptarë tashmë udhëtojnë çdo ditë me mikrobushin në shkollën që është shumë më larg se ajo që e kishin te pragu i shtëpisë. Arsyetimet që u dhanë në respekt të rajonizimit territorial, janë të pakuptueshme për një mendje të shëndoshë politike. Ç'faj kanë shqiptarët që në trojet e tyre, pa dëshirën e tyre kanë mbetur në Maqedoni. Ç'faj kanë shqiptarët për katër ndarjet territoriale që janë bërë në Maqedoni. Edhe për këtë, faji qëndron te maqedonasit dhe sjelljet e tyre retrograde ndaj shqiptarëve.

Sa e dobishme do të ishte për të gjithë sikur të ishin krijuar kushte e raporte që 20 - vjetorin e Pavarësisë së Maqedonisë ta shënonin bashkarisht edhe shqiptarët edhe maqedonasit. Edhe për këtë sërish fajn e kanë maqedonasit dhe politika e tyre mis-kine nacionaliste maqedonase. Edhe kësaj radhe u dëshmua se shqiptarët kishin plotësisht të drejtë ta nisin luftën e 2001- shi.

Mosrealizimi i Marrëveshjes së Ohrit nga maqedonasit, përbën mullë shërri edhe për partitë opozitare shqiptare, ku secila pretendon se do të kishte bërë më shumë. Edhe kjo mullë shërri e ka gjenezën te politika maqedonase përçarëse anti-shqiptare, sepse është më se e qartë se politika maqedonase është ajo që e pengon realizimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit.

Tani mbetet shpresa te faktori ndërkombëtar, i cili duhet të heq dorë nga lazdrimet që ia bënë Maqedonisë, e t'i tundën njëherë e mirë maqedonasit, sepse çdo ditë e më shumë po dëshmohet bujaria shqiptare dhe meskinllëku maqedonas.

Larg shantazhet nga feja islame

Nuk më hiqet nga mendja kur isha nxënës shkolle në kohën e monizmit, kur drejtorët e shkollave bëheshin aqë servilë dhe injorantë, gjenin bashkëmendimtarë mësimdhënës e profesorë, futeshin nëpër zyrtarë e arsimtarë dhe nëpër klasë e nxënësve, duke mbajtur në dorë gota me ujë për tua prishur agjërimin besimtarëve në muajin e shenjtë të Ramazanit. Sa komikë e budallenj dukeshin këta prishës të agjërimit kur vepronin dhe sidomos kur mburreshin si karkaleca për atë mëkat dhe punë të mbrapshtë që bënin. Ata me këtë sjellje të tyre nuk arrinin asfarë suksesi, sepse ata që agjëronin vazhdonin të agjërojnë edhe më me devotshmëri, se morali i atyre që agjëronin ishte shumë më i lartë se marrëzia e agjërimprishësve.

Nga ana tjetër kur shkova për studime në Beograd, ku ishte edhe bastion i komunizmit, habitesha kur kalimthi shikoja që në festat fetare orthodoxe shkonin në kisha udhëheqës të lartë komunistë e shtetërorë.

Tani kur hapërojmë e jetojmë në pluralizëm dhe demokraci, mjetet elektronike e të shkruara të informimit njoftojnë për mungesën e një xhamie të madhe në Tiranë dhe në Prishtinë, ku besimtarët janë të detyruar që faljen e namazit të Bajramit ta kryejnë edhe në rrugë. Përkundër kësaj në qendër të Tiranës vite më parë është ngritur një kishë e madhe orthodoxe, kurse në Prishtinë janë ndërtuar një kishë orthodoxe dhe një katedrale katolike përmbri Universitetit të Prishtinës.

Ndërkaq në Maqedoni nuk lejohet ndërtimi i Burmalit Xhamisë në vendin ku ka ekzistuar, por nga ana tjetër është ndërtuar Kryqi i madh orthodoks në malin Vodno të Shkupit dhe në ndërtim e sipër është kisha kontestuese dhe irrituese në Kalanë e Shkupit, të dyja me paratë edhe të taksapaguesve myslimanë. Duhet përmendur edhe faktin se para disa viteve gjatë rikonstruimit të Urës së Gurit u hoq qëllimisht mihrabi në urë dhe u ndryshua pamja origjinale e saj.

Tirana zyrtare ende nuk e ka caktuar lokacionin e përshtatshëm për ndërtimin e një xhamie të madhe tiranase për plotësimin e nevojave të besimtarëve myslimanë. E njëjta gjë po ndodh edhe në Prishtinë, ku fundjavën që shkoi mijëra besimtarë myslimanë organizuan një protestë ku kërkonin caktimin e një lokacioni të përshtatshëm për ndërtimin e një xhamie, dhe shprehnin zemërimin e tyre edhe kundër vendimit të Parlamentit të Kosovës kundër mësimit fetar nëpër shkollat dhe kundër mbajtjes së shamisë nëpër shkollat.

Sipas të dhënave statistikore në Shqipëri dhe në Kosovë pjesa dërmuese e popullatës i takon religjionit islam. Është e pakuptueshme që përpos këtij numri të madh të myslimanëve të bëhen pengesa të kësaj natyre. Problemi tjetër është edhe në moskthimin e pasurisë së vakëfeve myslimane në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni.

Këto probleme as nuk duhet të fshihen e as të zvogëlohen, por duhen të zgjidhen shpejtë dhe drejtë, sepse pengimi i zhvillimit dhe edukimit fetar sjell dëme për tërë shoqërinë.

Edukimin që e jep feja e mirfilltë islame nuk mund ta japë asnjë parti politike dhe asnjë klasë udhëheqëse.

Jemi dëshmitarë të krizës së madhe morale e të korrupsionit enorm në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, për çka shprehin shqetësimin e tyre edhe institucionet përkatëse ndërkombëtare. Zbatimi i fesë islame forcon moralin dhe lufton korrupsionin.

Ku'ani është libri më i përkryer dhe i pazëvendësueshëm në edukimin individual, familjar e shoqëror. Ai që ecën rrugës kuranore është i vyer për veten, familjen e shoqërinë.

Jeta e ka provuar dhe e provon çdo ditë, se në rast fatkeqësie apo sëmundje, nuk ka vlerë as paraja, as pasuria e as shoqëria. Shpëtimtare është vetëm përkrahja e Perëndisë, natyrisht nëse e kemi merituar.

Rexhep TORTE

"RRUGA E ARBERIT"

merr kopjen tënde

eshte koha per tu pajtuar...
telefono: (04) 22 33 283

Njeriun që e ... Dua

Nga: **KRISTO ZHARKALLIU**

Shumë njerëz që banojnë në një shtet të madh me muze të pasura dhe me qendra të famshme arkeologjike, shumë rrallë i vizitojnë këto. Duke qenë afër tyre besojnë se kurrë nuk mbaron koha për t'i vizituar, kështu, me sot e me nesër nuk i vizitojnë kurrë. Kam takuar njerëz që janë lindur e rritur në Athinë të cilët nuk kanë shkelur asnjëherë në Akropol ose në ndonjë muze të qytetit, duke menduar se është e natyrshme që dikur të shkojnë, por duke e shtyrë nga dita në ditë nuk shkojnë asnjëherë.

Kjo hyrje do të duket pakëz e çuditshme për një njeri ka vizituar muzetë e vendet e lashtësisë jo vetëm të Greqisë por edhe të vendeve të tjera si Austria, Franca, Egjipti dhe, domosdo, Shqipëria etj. Por fjala këtu ka nuk të bëjë me vizitat në muze.

Këtu bëjmë fjalë për një krijues mik. Prej më se pesëmbëdhjete vjet kam pasur pranë-herë herë kam thënë mikun e vetëm shqiptar- një intelektual të cilit i kam lexuar me dhjetëra shkrime të mia, ashtu si kam lexuar dhe unë shkrime të tija- por asnjëherë nuk mendova të shkruaj diçka për të duke e shtyrë me sot e me nesër, duke harruar se koha kalon dhe ai tashmë i ka mbushur të shtatëdhjetat, madje këtë përvjetor e festoi disa muaj më parë duke botuar librin e fundit dhe të pestë (deri tani se ai ka akoma kohë të shkruajë dhe pesë të tjerë!) të ciklit të tij me titullin kuptimplotë: “NJERËZ QË I DUA...”

Fjala është për gazetarin e njohur Abdurahim Ashikun.

Abdurahim Ashikun (ose më mirë Duron si e kemi zakon t'i flasim) e njoha një ditë të vitit 1996 në një kafene të Omonjës, kur shqiptarët ishin menjëmend të çorientuar, të trembur dhe të zhgënjyer nga jeta dhe rrethanat e reja që përjetonin, sidomos në Greqinë aspak mikpritëse për ta. Në atë lokal popullor ishin mbledhur shumë intelektualë dhe gazetarë shqiptarë që sapo kishin mbërritur në Greqi pothuajse të dëbuar nga Atdheu i tyre. Ai m'u afrua menjëherë- nuk më kujtohet kush na prezantoi- dhe më tha se ishte tepër i brengosur se nuk kishte ku të shkruante më përderisa akoma nuk kishte qarkulluar në Athinë ndonjë gazetë shqiptare. “Po të kisha ndonjë makinë shkrimi do të shkruaja mbresat e mia të përditshme, më tha, por ku me e gjet një makinë të tillë?” Ndërkohë më tha se ishte nga Dibra dhe unë i thashë se miqtë e mi të deriatëhershëm kishin qenë nga Veriu, shi nga Kosova. Nuk dua të theksoj këtu se si u zgjidh çështja e makinës së shkrimit, ai vetë e ka shkrojtur disa herë, por është fakt i padiskutueshëm se shkrimet e tij të para, që më vonë do të botoheshin në gazetata e Athinës dhe më tej në librin e parë, u shkrojtën pikërisht me atë makinë që kishte ardhur nga Kanadaja dhe ishte dhuratë e një dibranit tjetër! Që atëherë shkrimet e tija nuk munguan asnjëherë nga faqet e shtypit shqiptar të mërgimit, ku ai përshkruante në mënyrë të përsosur jetën, telashet dhe hallet e mërgimtarëve. Krahas shkrimeve, në rastet e shumta ai nuk mernte kurrfarë shpërblimi për shkrimet që bënte, atij i duhej të punonte për të nxjerrë bukën e gojës duke pasur përherë ndihmën e çmuar të Natashës e cila, megjithëse kishte qenë arsimtare e dalluar në ven-

din e saj, shpejt mësoi të punonte pa u lodhur në gjithfarësoj punësh që gjente. Këtu nuk mund të harrojmë djalin e tij të vogël Indritin cili, kur sapo kishin ardhur ndonëse katëmbëdhjetë vjeçar, për mjaft kohë ishte njeriu i vetëm që punonte dhe mbante ...familjen me bukë! (Indriti më vonë do të shkonte në shkollë, do të bëhej specialist në përdorjen e riparimin e kompjuterëve dhe tani, si ka mbaruar Universitetin e Athinës, është punësuar në një shoqëri dhe grekët (padronët) e “duan” kaq shumë sa nuk e lënë as pushime të shkojë! Gjithashtu edhe Erblina, e bija, me këmbënguljen dhe punën e saj të palodhur u bë një intelektuale e denjë për prindërit e saj, Natashën dhe Duron)

Por le të flasim për Duron tonë dhe për librat e tij që kemi në dorë...

Librin e parë ai e botoi në vitin 2007, duke përmbledhur aty disa nga artikujt e tij më të mirë që kishte botuar në shtypin shqiptar. Ndoshta duke qenë i shpërndarë në shtypin e përditshëm ose të përjavshëm, këto shkrime me vlerë të padiskutueshme për jetën e emigrantëve në Greqi, do të ishin lexuar dhe tashmë do të ishin harruar. Me daljen e librit në qarkullim bibliotekat e shqiptarëve u pasuruan me një “histori” për jetën dhe vuajtjet e shqiptarëve në Greqi. Duroja, ndonëse flet me dashuri dhe respekt për bashkatdhetarët e tij, nuk tregon kurrësi mllef, zemëratë ose urrejtje ndaj grekëve që shumë herë sillleshin me prepotencë, duke mos fshehur ndjenjat e tyre raciste antishqiptare. Ai ka mundur gjithandej të gjejë të mirën, ngaherë ekziston e mira mjafton të mundësh ta gesh, të zbulojë atë që në shekuj i ka afruar shqiptarët dhe grekët, të cilët kanë bashkëjetuar tre mijë vjeçar pranë e pranë ose bashkërisht. Dhe jo vetëm kaq: ai zbuloi dhe arvanitasit tanë që janë ngulitur në tokat helene shekuj më parë dhe ruajnë “gluhën e mëmës” akoma. Nuk ishte rastësi që ai u bë mik, madje i mori disa intervista me hulumtuesin e njohur të jetës dhe gjuhës shqipe në Greqi, të paharruarin Aristidh Kola. Ashtu si ka mundur të zbulojë virtytet e larta shqiptare, pa u përpjekur ndërkohë të fshehtë të metat dhe dobësitë njerëzore. Sigurisht shkrimet e tija ishin inkurajuese duke paraqitur ngaherë të veçantën, të mirën dhe kjo ishte patjetër e nevojshme për shqiptarët e sfillitur të asaj kohe. Ai na thoshte se nuk ekzistonte vetëm mjerim, uri, frikë dhe ngricë, jo, më tej kishte diell dhe shqiptari, si ngaherë ishte i zoti ta zbulonte të mirën, ngrohtësinë, dashurinë humanizmin. Duke folur pra për ata shqiptarë që ishin dalluar, duke folur për diellin e Specës ose të Hidrës na tregonte se gjithsesi e mira ekziston mjafton të kesh dëshirë të mirë, këmbëngulje dhe punë që ta gesh. Dhe shqiptarëve nuk u mungonin këto. Megjithëse u gjendën në një ambient pothuajse “armiqtësor” (grekët u trembën, humbën toruan nga vërshimi i dhjetramijerave shqiptarëve leckamanë të uritur në vendin e tyre dhe, ndonëse në fillim donin të tregonin se ishin gati të ndihmonin, pastaj e humbën durimin, humbën besimin dhe nisën të tregojnë qëndrimin e tyre armiqtësor që në fakt u kultivua nga disa qarqe shoviniste nacionaliste dhe nga masmediat private.) Por Duroja nuk ka rënë në kurth të nacionalizmit të egër, ai e ka ruajtur gjakftohtësinë

dhe në shkrimet e tija nuk gjen asgjëkund “britma” mallkuese ndaj vendit “mikpritës” ku shqiptari po bëhej sinonim i kusarit, fanatikut dhe kriminelit.

Tashmë, pas kaq vjetësh, duket qartë se gjakftohtësia argumentuese e Ashikut ishte e drejtë kësisoj libri i tij i parë, ndonëse na përshkruan gjallërisht jetën e shqiptarëve në këtë vend të bekuar, askurrë nuk gjejmë anatema, nuk gjejmë ankime, ose antigreqizma.

Nuk vonoi dhe ai botoi librin e dytë me titullin “Rilindësit e kohës sonë” titull të cilin, sipas tij ja dha Dritëro Agolli. Me të drejtë se këtu merret me arsimimin e shqiptarëve në gjuhën e tyre në Greqi. Ishte koha kur bëhej zhurmë e madhe për shkollën shqipe në Greqi të cilën shteti grek nuk e lejonte. Si Duroja ashtu dhe Natasha si ish arsimtare, brengoseshin dhe përpigeshin shumë që të hapeshin shkollat shqipe ku fëmijët e emigrantëve shqiptarë do të mësonin gjuhën e mëmës. Për këtë çështje është shkruar shumë por, mjerisht edhe deri sot është bërë shumë pak ose aspak. Sigurisht atëherë gëzoheshim e entuziazmoheshim për çdo nismë, për çdo përpjekje dhe shumë herë i zmadhoni gjërat me qëllim që të merrnin shembull dhe të tjerët. Mjerisht emigrantët shqiptarë në këtë drejtim nuk patën as ndihmën më të vogël nga shteti shqiptar. Tirana ishte e kënaqur që përditë hynin në arkat e shtetit me miliona euro nga djersa e emigrantëve, por askurrë nuk e çau kokën për arsimimin e fëmijëve të më se një milion shqiptarëve të emigruar. Në librin e dytë të Ashikut ka një dëshirë dhe optimizëm pak të tepruar për të ardhmen e arsimit shqiptar në Greqi që mbeti ngaherë shpresë e kotë.

Sidoqoftë libri është një dëshmi tjetër e punës dhe të sakrificave të Ashikut për të dhënë kontributin e tij në themelimin e zhvillimin e arsimit shqiptar në Greqi...

Libri i tij i tretë tregon edhe njëherë pasionin dhe brengën e tij të madhe për shkollën shqipe për emigrantët në Greqi, prandaj i kushtohet pothuajse plotësisht shkollës private që ka hapur në Athinë Lorenc Koka. Ndoshta nga dëshira dhe entuziazmi i tij për mbarëvajtjen e arsimimit shqip në Greqi ka bërë të kapërcejë pak cakun duke e shndërruar librin në një reklamë pak të tepruar ndaj pronarit të shkollës. Por kjo nuk e ndryshon thelbin e problemit. Si të mos e teprojë pakëz kur kaq vjet lufton me penën e tij për shkollën shqipe dhe ja tani e gjen përpara të gatshme, moderne dhe tepër premuese? Besoj se ky “teprim” u bë për të nxitur dhe shqiptarë të tjerë të ndiqnin shembullin e Kokës, madje të zgjonte pakëz dhe “mandarinët” e Tiranës që bënin dhe bëjnë gjumë të qetë arsimor. Mjerisht as shqiptarët e Greqisë as Ministria e Tiranës u zgjuan dhe i vetmi qerë ndriques i gjuhës shqipe në Athinë mbetet ai i librit të Abdurahim Ashikut në sheshin ... “famëkeq” të Athinës... Viktoria.

Pas kësaj, me librin e tij të katërt ndryshon krejt drejtim

Titulli kuptimplotë “Po Dibrës! Jo Skavicës!” tregon ndjenjat e tij lokaliste ndaj vendlindjes, por këtë nuk e bën me britma ose ankime të kota ndaj ujëmbledhësit të Skavicës, por me argumente bindëse duke u përpjekur të na mbushë mendjen se një vepër e



Në foto: Kristo Zharkalliu dhe Abdurrahim Ashiku



tillë në kushtet e vendit dhe sidomos të Dibrës, do t'i sjellë vendit me shumë dem se sa dobi. Brenga e tij e madhe është se do të përmbysten me dhjetëra fshatra të bukura malore nga ku do të shkulen nga vatrat e tyre shekullore me mijëra banorë që të ndërtohet një vepër tjetër energjetike, kur dihet se të gjitha këto vepra që i japin dritë Shqipërisë, janë ndërtuar në Veri, shi në Dibër ku akoma nuk është ndërtuar rruga e Arbrit! Ai nuk thotë mjaft më me Dibërën, thjesht me argumente shken-core (pyetja se ç'kanë përfituar banorët në këto zona nga hidrocentralet që i japin dritë gjithë Shqipërisë, mbetet e papërgjigjur...)- aty ka mendimet e shumë specialistëve dhe shkencëtarëve të energjetikës- tregon se sa e dëmshme do të jetë një vepër e tillë jo vetëm për Dibërën brenda kufijve të Shqipërisë por edhe për popullsinë shqiptare të Dibrës së Madhe. Unë nuk mund të shpreh mendimin tim për këtë çështje se nuk e njoh aspak, madje nuk jam dhe... dibran...dhe më e keqja...(?) jam nga jugu ku më duket e natyrshme të kem në tavan një llambë elektrike... prandaj deri diku e kam kundërshtuar qëndrimin e tij “lokalist” në bisedat tona të shpeshta, por tani besoj se ai ka të drejtë ashtu si kanë të drejtë dhe specialistët e tjerë që përpiqen të na bindin në këtë fushë. Por rëndësi nuk ka të më bindin mua, por “kokat e mëdha” të Tiranës që ëndërrojnë të pasurohen duke eksportuar dritë elektrike që do të përfitojnë me ndërtimin e hidroçentralit të Skavicës..

Me librin e tij të fundit ai i kthehet përsëri gazetarisë, korrespondencës, të cilën kaq mirë e njeh. Titulli i librit “Rrëfime të komshiut” na tregon se këtu kemi biseda e regjime të emigrantëve, të cilët shprehin mendimet dhe vuajtjet e tyre të papërshkrueshme në emigracion. Njerëz që kaluan malet me dëborë, njerëz që ecën ditë të tëra pa ngrënë e pa fjetur, njerëz të lekosur, të vojtur, të uritur e të etur për pak mirëqenie, tregojnë në faqet e librit të Ashikut se si kanë mundur të fitojnë dhe të kapërcejnë të gjitha pengesat dhe rreziqet që të rifillojnë një jetë më të mirë në një vend të huaj aspak mikpritës. Por edhe njëherë shqiptari fitoi, ashtu si ka mundur të mbijetojë nëpër shekuj në kushte tejet të rrezikshme. Këtu Duroja tregon të tërë mjeshtërinë e tij të një gazetarit me përvojë dhe të talentuar. Se unë besoj që të shkruash një reportazh, të përshkruash një dukuri, duhet talent dhe këtë A. Ashiku e disponon prej shumë vitesh që atëherë kur braktisi profesionin e tij të dashur të agronomit që t'i kushtohet plotësisht gazetarisë. Besoj se ky libër është më i arrirë si nga temat ashtu dhe nga paraqitja, jo se duam të nënvleftësojmë librat e tjera të tij. Këtu kemi një ndryshim themelor: tregon se si shqiptari shkallë-shkallë, hap pas hapi e ngriti nivelin e tij i jetesës dhe brenda pak vjetëve u bë jo vetëm i pranishëm në shoqërinë greke, por dhe të nevojshëm që të mos themi të domosdoshëm. Prandaj ky libër si më i ri dhe më i

freskët, na duket më i mirë dhe nuk duhet të harrojmë se ky libër u botua me rastin e 70 vjetorit të lindjes të publicistit tonë të palodhur. Tek e fundit sot një shtatëdhjetëvjeçar është mjaft i...ril.

Por duhet të vëmë në dukje kushtet se si u shkruan dhe u botuan këto libra. Një lexues i thjeshtë mund t'i duket një gjë e lehtë të nxjerrësh në qarkullim një libër, sidomos kur je në emigracion. Megjithatë Ashiku ka mundur të kapërcejë të gjitha vështirësitë, sidomos ato ekonomike dhe na “detyroi” të rradhisim në bibliotekat tona pesë libra që janë shkrojtur me zëmër por ngaherë me urtësi, me mëndje të kthjellët.

Aktivitetet e gazetarit të njohur kanë qenë të gjithanshme në Greqi. Ai ishte nga nismëtarët e parë për nxjerrjen e një gazete shqipe në Athinë, duke mos kursyer as mund as kohë. Mjerisht këto gazeta gjysmë të paligjshme shumë herë ranë në duar jo të “pastra” gjë që detyronin ngaherë Duron të tërhiqej. Por ai pati punë të suksesshme me gazetata e Artan Kristos si dhe me Gazetën e Athinës ku fjala e tij nuk mungoi asnjëherë.

Krahas këtyre, si thamë më lart ai nuk pushoi të punojë për arsimin shqiptar dhe vitet e fundit është nga të parët që merr pjesë në seminarin për gjuhën shqipe që herë organizohet në Durrës, herë në Strugë, herë në Mitrovicë e së fundi në Prishtinë Ai nuk lodhet edhe nuk kursehet dhe nuk ka munguar kurrë nga këto seminare ku përfaqësohet arsimi shqiptar të diasporës. Me gjithë përpjekjet e tij, nuk mund të mos vë në dukje të mungesës të një arsimit të tillë në Greqi. Kanë një organizatë arsimtarësh, zgjedhin kryesinë çdo vit veçse shkolla shqipe nuk hapen as do të hapen kurrë më në Greqi. Dhe kjo jo për fajin vetëm të grekëve. Me gjithë ankimet dhe artikujt që A. Ashiku ka shkrojtur për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë, andej e bëjnë veshin shurdhër dhe ambasada shqiptare në Athinë nuk ka hapësirë të mjaftueshme që të ndihmojë në këtë drejtim.

Megjithatë Ambasada ka mundësi të nderojë njerëzit e shquar të shtypit dhe të letërsisë në Greqi dhe nuk e fsheh se më vjen keq që nuk u organizua një mbrëmje nderi në selinë e saj për gazetarin e shquar me rastin e përvjetorit të 70-të të lindjes ku do të paraqitej dhe vepra e tij.

Tani ka ardhur koha që shqiptarët po riadhesohen për arsye të krizës ekonomike të Greqisë.

Dua të besoj se Duroja ynë do të gjejë mënyrën të shkruajë një libër dhe për këtë dukuri kur po mbyllet një epokë tragjike për shqiptarët. Librat e tij do të jenë për brezat e ardhshëm një mësim i mirë historik që të mos përsëriten më prapësi të tilla tragjike.

Ashtu si besoj se një shkrim si ky i imi nuk mjafton për të paraqitur veprën dhe punën e Abdurahim Ashikut. Dua të shpresoj se në të ardhmen-aq sa më mbetet- të shkruaj diçka me të gjatë dhe të hollësishtme për të.



Sistemi eshtëror për të bërë të bindshme dukuritë historike e shoqerore të mësipërme duhen kërkuar me ngulm e durim në arshivat ku fshihen të dhenat e rregjistrimeve të popullsisë shqiptare në katraktet vullkanike të shekujve, vetëm kështu çimentohet uniteti kombëtar, vetëm kështu gjëndn dejet e gjakut të këtijë kombi që i japin jetë e lëvizje shumë qelizave të veprimtarisë njerëzore në të katër anët e globit.

Kush e ka numëruar popullsinë shqiptare?

Nga: **Dr.Selman MËZIU**

(Vijon nga numri i kaluar)

Ndërsa po ta shohim këtë çësh tje duke marrë objekt studimi krijuesit e hartave të kombësive mbi shpërndarjen e popujve në gadishullin Ballkanik situata paraqite si më poshtë: Anglezët *Makenzie* e *Irby* udhëtuan në këto vende në vitin 1867 dhe parqitën hartën me shqiptarët në shumicën e vilajetve, ndërsa e kundërta ndodhi me Gjermanin *H. Klepert* Profesor në Universitetin e Berlinit i cili me 1867, shtrembëron realitetin kur paraqet shpërndarjen e popullsisë sipas racave, i ndikuar së tepërmi nga historiani grek *P. Aravantinos*, në të njëjtat gabime rrëshqet studiuesi Serb *J. Cvijiç*, në vitin 1909 ku per hartën e tijë ai shkruan se: "Në Veri jetojnë serbë të shqiptarizuar dhe shumica e jugut janë grekë të shqiptarizuar.", (21)

Me sa më sipër kuptohet vetëvetiu inventarizimi i hollsishtëm i popullsisë ka patur vështirësitë pa konceptueshme, duke i shtuar edhe shlytysa të tjera politike e pushtuese, siç na tregon një studiues tjetër Serb *Dr. Vaso Çubriloviç* "Nga 1876 deri më 1900, jo më pak se dyqind mijë shqiptarë u dëbuan nga krahinat e *Prokuples*, *Vranjes*, *Leskocit*, *Nishit* etj. Gjatë luftës Ballkanike, njëqindë e njëzetë mijë shqiptar janë përzanë me dhunë nga Kosova. Ndërsa midis dy luftave botërore, terqindë mijë Shqiptar kane ikur në Turqi dhe pesëdhjetë mijë drejt Shqipërisë. Trojet e tyre jane populluar me 65613 kolon serb. Pas luftës së dytë botërore rreth pesëqind mijë shqiptar janë larguar drejt Turqisë, vendeve Evropiane, Australisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.", (11)

Nuk po trajtojm qëndrimin e rregjimit të Josif Broz Titos për rreth tridhjetë vjet mbi shqiptaret e Jugosllavisë, ndërsa masakrat e rregjimit gjakatar të diktatorit serb Slllobodan Milosheviq dhe debimi i Shqiptarëve në masë, sepse ato janë më afër nesh në kohë e ne jemi deshmitarë fizikë dhe real.

Kjo gjëndje përdhunie për pastrim etnik ka ndodhur edhe në kraninën e Çamërisë dhe ja pak rrjeshta nga kjo situatë shkatërruese dhe njëkohesisht e përgjakshme: "Genocidi Grek nisi më 27 Qershor 1944, ushtarët e Zervës (gjenerali grek Japolan Zerves S.M.) Rrënonin gjithëçka që gjenin perparabanorët Shqiptar të Parathimis u kapën në befasi dhe nuk gjetën dot mjete mbrojtëse. Barbarët e Zervës hynë natën në qytete dhe vranë 673 burra, gra e femijë, në Filat 1286, në Pragë 640, ...rrafshuan mbi 5800 shtëpi dhe gjashtëdhjetë e tetë fshatra, qindra të tjere u shkretuan. Nga një popullsi rreth tridhjetë e pesë mijë banorësh që ishin para luftës, mbetën dhjetra familje, te tjerë iu drejtuan Turqisë dhe Shqipërisë.", (16)

Duke studiuar me gjithë kompleksitetin të dhënave që na vijnë nga burime të ndryshme në statistikat e popullsisë gjejmë dëshmi të pamohueshme të kombësisë, historisë së

sajë, kulturës, mjedisit natyror, bujqësor dhe të dhëna etnografike. Dhe ja se si e shpejgon albaneologu i shquar Italian Prof. Antonio Baldaçi në lidhje me përcaktimin e kufijve të vitit 1913: "Edhe në këto pjesë të kufirit shqiptar te vendosur tanimë, nuk mund ta përballojë as edhe një lloji provimi(gabimin e bërë) nga pikpamja gjeografike, dhe as etnike, edhe po kështu nga pikpamja administrative, ekonomike, politike e ushtarake, në të gjitha kuptimet, përçatë kufirit me Jugosllavinë e njëjta gjë edhe në drejtimin me kufirit Grek ...", (12)

Nuk paraqet shkak apo moskuptim që të zgjatemi për ato që shkruajtëm më sipër prandaj kalojmë në studimin krahasues nga një rregjistrim në tjetrin se çfarë ndryshimesh kanë ne mes qendrash të ndryshme të banuara: "Nënshkodra në vitin 1417 përfshinë shtatëdhjetë e katër fshatra; tridhjetë e tre prej tyre dalin më 1485, pra, vazhdojnë egzistencën në masën dyzetë katër pikë gjashtë përqind. Përveç këtyre kishte edhe dyzetë e një fshatra që ishin braktisur si vendbanime. Prej tyre katërmëdhjetë si trullishte, kurse njëzete e shtatë të tjera nuk përmenden fare në rregjistrimin e vitit 1485. Dokumentohen edhe fshatra të reja që dalin për të parën herë në defterin osman të me sipërm. (Këto janë Shënmmri, Megalen, Melgush, Kuçi... Mazreka dhe Irmal)

Te tilla dukuri demografike do të shfaqen me siguri duke bërë të njëjtën mënyrë studimi në kohët e sotme sikur të kryheshin rregjistrimet, kështu do të dilnin në pah lëvizjet e mëdha të popullsisë, që kanë ndodhur dhejetëvjeçarit e fundit të shekullit të njëzetë dhe më vonë. Lëvizjet nga Veriut drejt Shqipërisë Qëndrore dhe Jugu po në të njëjtin drejtim dhe zmadhimi i qytetve, mbi të gjitha, atyre bregdetare. Shumatorja e këtyre studimeve do të vërtetonte më së miri perfundimin e studiuesit Gjerman G. Shtadmyler: "Fshatarët e fshatit shqiptar nuk ishin të palëvishëm, se banorët e tij nuk ishin endacak dhe as barinj bredhëtar.", (12)

Nga këto dokumente që na zbulojnë prova mjaft dobiprurëse edhe mbi kulturat bujqësore dhe njësitë matëse e tjera, po e bëjmë të besueshëm, me një shembull të fshatit Piqeras, në krahinën e Delvinës në vitin 1485: "Grurë-Barrë, vlera 600; Elb –Barrë...; Badihavaja – taksa e martesës, gjobat për faje, shpendët dhe të tjera sipas vendimit të mëparshëm; E dhjeta e ullirit...; E dhjeta e frutave; E dhjetat mushtit-madre; E dhjeta e Lirit; Taksa e Bostanit; E tagjisë-barrë; E dhjeta e zgjoit(bletëve S.M.); Taksa e mollës; E Barit; E derrave; E melit - Barrë dhe taksa e Mullinjëve", (4)

Me vlera të pazëvendësueshme studimi paraqet metodika e rregjistrimeve, të cilat janë dobisjellëse edhe për kohën e sotme, megjithë mangësitë që kishin, për shkak të politikës shtypëse e grabitëse, për shembull, të Turqisë e për këtë po marrim si argumenitim atë para e pas



vitit 1881. Në ato, para këtijë viti, rregjistroheshin vetëm meshkujt, të ndarë në: Mysliman, të Krishter, Izrailian, dhe Xingarët. Për myslimanët shënohesh: Emri, dita e viti i lindjes, lartësia e trupit, ngjyra e syve, lloji i punës që kryente, prejardhja gjeografike shoqëruar me datën e transferimit, viti i kryerjes së ushtrisë. Nuk rregjistroheshin gratë. (14)

Ndërsa pas vitit 1881 rregjistroheshin gjithë pjestarët e familjes me këto të dhëna: Gjinia (mashkull apo femër), datëlindja, vendbanimi, mosha, besimi fetar, profesioni, i martuar apo beqar, shëndeti, e ka kryer apo jo ushtrinë. (14)

Duke kryer një analizë të inventarit mbi popullsisë në vitin 1960 studiuesi italian Diego Kastria nxjerr në dukje një dukuri tjetër shoqërore, numurin e pjestarëve të familjes dhe ja si shprehet ai: "Megjithëse kundra vullnetit të zhvillimit urbanistik, krijohen familje të reja të cilat shkëputen nga antikitetit i përbërjes familjare patriakale bujqësore apo blegtorale, duke u transferuar në qytete, kështu që madhësia e familjeve të mesme shqiptare është shtuar nga katër pikë nëntë pjestarë në vitin 1923 në pesë pikë tre më 1960, familjet e mëdha të cilat kanë gjashtë apo nëntë veta janë shtuar duke u bërë më të shumta në numer, po të krahasohen me vitin 1955, gjejmë edhe nga ato me dhjetë njerëz.", (15)

Ta shikojmë çështjen e trajtuar deri në këto moment në një plan tjetër në atë të përcaktimit të origjinës së zyrtareve (Perandor, Kryeministër, Ambasador, Papë etj.) të lartë të Perandorisë Romake, Bizantine, Turke, Veneziane, Papëve të Vatikanit me prejardhje shqiptare. Vështirësitë që takohen në përcaktimin e vendoriginës së tyre për mungesë të dhënash të ndryshme. Ta gjykojmë nga ky paragraf i më poshtëm.

"Zëvendës ambasador i Shkodrës (në Venedik), në atë kohë ishte Anton Duodo, Duoda, ose Doda i martuem me Z. Marija Borci. Diq (vdiq) më 24 Nanduer 1766. Familja "Duoda,, gjindet edhe sot në Shkodër e njëfjet nën mbiemrin e Shanit të Tushit.... A ka kenë kjo familje shkoderane një gjaku me të famshmen familje vendikase Duodo? Nuk e dijmë me siguri, saktësojmë se edhe fakti që një pjestar i sajë ka kenë zëvendës ambasador vendikas, mundet me formue një soji argumenti. Duoda mbajnë gojdhane se një degë e tyre gjindet në Romë e një tjetër në

Austri.,,(17)

Shpërndarja e Ilirëve pra dhe e pasrdhësve të tyre Shqiptare në kontinentin Europian, Aziatik, Afrikan. përçatë rrjedhjes së shekujve ka qenë e zakonshme. Kolonitë shqiptare në Siqili, Kalabri, Abruco, Morize, Padova, Venezia, në pjesë të ndryshme të Dalmacisë, dhe më tej ja se si e përshkruan Albanologu italian në fushën e Gjuhësisë Karlo Taliavini: Koloni shqiptarësh (toskë) me prejardhje nga Bullgaria kaluan në Besarbi dhe më tej, rreth gjysmës së shekullit të kaluar(XIX, S.M) në Ukrain përçatë brigjeve të detit Azov në afërsi të Malitopolit. Të tjerë Shqiptar gjënden në Krimea e përreth Odeonës.

Në Turqinë Evropiane gjënden fshatra të ndryshme shqiptarësh në krahinat pranë detit Marmara si, Aftoni, Marmar, Kallzaqi; në afërsi të Adrianopolit ndodhen vendbanimet si Mandriç, Ibrik-Tepe, Sulltan-Koi, Alltun- Tas, Pazar- Dere, Zallof, Aballar-Karabkl.

Mjaftë të shtrime jane kolonite Shqipëtare në Sirmia(Slavonia) ku gjënden dy fshatra të emëtuara, Hertkovci dhe Nikinci.,,(18)

Për të plotësuar qëllimin e këtijë studimi po cekim edhe "ikjet,, pa u zënë këmbët dhe te popullsisë shqiptare pas viteve 1990:

Në pranverën e vitit 1991 shpertheu, i pokontrollueshmi invazion. Kështu zbarkojnë në Pulia pesëdhjetë mije refugjat shqiptar.....ndërsa në kufijte e Greqisë arritën katërqind mijë punëtor.,, (19)

Dhe kjo hemoragji e pandalshme e popullsisë shqiptare, shumica e të cilave janë të rinj vazhdon për rreth njëzetë vjet, duke gjetur strehë jo vetëm në vende më të zhvilluara ekonomike të botës por edhe në ato më të varfërat në të gjitha kontinentet. Nuk e ndiej të nevojshme të shprehem me shifra se ato janë të shkruar në ballin, shpirtin e zemrën e çdo shqipëtar i kudondodhur. Shrohet pyetja : A do të kërkohet për studime demografike të shqiptarëve , origjina e tyre, nga cili fshat, krahinë, qytet apo shtet ka mbërritur këtu apo atje në këtë vend? Sigurisht.

Paraqet rëndësi të madhe etnikopolitike organizimi i të gjithë forcave intelektuale e personaliteteve politike shqiptare e më gjërë për të ndërmarrë një rregjistrim të përgjithshëm të popullsisë shqiptare sa më shpejtë që të jetë e mundur, në trungun e vëtë nanë, e deri në skajet më të largëta të lamshit të dheut kudo që

ato kane futur rrajnët për të ndërtuar jetën e tyre.

Përfundime

1-Studimi me kujdes i të dhënave mbi popullsinë në periudha e ndryshme historike na lejon të përcaktojm, jetën mesatare sipas gjinive, ritmet e shtimit të popullsisë dhe raportine e moshave mbi gjashtëdhjetë dhe të rinisë. Vetëm kështu përcaktohet forca më aktive dhe e gjalle e veprimtarisë prodhuese.

2-Pema e jetës(Lisi gjeneologjik) sipas familjeve apo fiseve ndërtohet vetëm duke shfrytëzuar të dhënat e breznive sipas inventarizimit në harqet kohore të shekujve. Dhe kështu për familjet e mëdha zbulohen edhe stemat e tyre. Pse jo edhe ndërthurjet e krushqite në mes familjeve të fiseve të ndryshme.

Kështu njerëzit do të njohin breznitë, parardhësit e tyre dhe do të thurin më me vërtetësi ngjarjet, datat, episodet më të rëndësishme, dhe kështu do të njohim ë më mirë dhe më me vërtetësi vetëveten duke undierëm kështu më krenar e më të fortë.

3- Duke gjurmuar në hapsirën e fshatrave apo krahinave, njihemi me emërtime të sipërfaqeve bujqësore, pyjore etj(onomastika) të cilat përputhen me mbiemrat e pronarëve në periudha të ndryshme. Saktësimin e vërtetësinë na e dhurojnë vetëm rregjistrat e banorëve të këtyre zonave ndër shekuj.

4- Studiuesve të të historisë natyrale të zhvillimit të njeriut (Antropologjia, S.M) iu shërbejnë të dhëna e ndryshme përmasore të marra nga rregjistrat e numurimit të popullsisë ose burime të tjera të natyrës ushtarake etj, të cilat në kohë të ndryshme janë shumë të vlefshme, për përcaktimin e rracave e dallimet midis tyre.

5-Popullimet e krahinave të ndryshme, formimi i fshatrave të reja apo qyteteve, përbëjnë për shkencën e demografisë dhe studiuesit e historisë elementë të domozdoshëm për të gjetur arsytet politike dhe ekonomike etjer të ç'vëndosjes së tyre e rigrupimeve të reja. Dhe kjo realizohet vetëm duke kërkuar në rregjistrimet e banorëve të këtyre vendeve në periudha të ndryshme kohore.

6- Duke analizuar vendodhjen e secilit fis (familje me të njëjtin mbiemër) të gjetur në krahina, qytete apo edhe në shtete të ndryshme, krahasimi i të dhënave duke shfrytëzuare burimet e e sipërpërmendura na ndimojnë të gjejmë origjinën e vërtetë të tyre, motivet e shpërnguljeve për periudha të ndryshme historike, dhe njëkohesisht përcaktohet origjina e njerëzve që kanë lenë gjurmë në veprimtarinë, kulture, politike, veprimtarinë fetare, ekonomike, shtetërore brënda e jashtë vendit tonë.

7- Ndarja e popullsisë sipas besimeve fetare , raportet në mes tyre, dhe emrat e përdorur janë materiali më serioz i rregjistrave të popullsisë të një populli e kështu nxirren të dhëna e perfundime historike mbi ndikimet fetare në gjithë veprimtarinë, ekonomike, demografike e ndikimet e njërës fe të tjera dhe forca e tyre në propogandimin e

Në Institutin që propozojmë të ngrihet, te formohet arshiva e dokumentacionit nga rregjistrimet që do të kryhen dhe të tjerave që janë kryer përgjatë shekujve në vendin tonë dhe jashtë tijë.

ideologjisë fetare. Gjithashtu saktësohet origjina e prejardhjes së emrave e trashgueshmëria e tyre në familje e fise, ne periudha te ndryshme kohore.

8- Ritmi i zhvillimit të një kombi vlerësohet nga mosha mesatare e jetës, përqindja e vdekjeve e shkaktuar nga faktor natyral, sëmundje të natyrave të ndryshme, epidemi të perbotshme ose kombëtare, shtimi i popullsisë në dhjetëvjeçare apo gjysëm shekulli, si dhe numuri i të vdekurve sipas moshave dhe lindjeve në sejcilin vit apo grupime vitesh këto të ndara sipas krahinave, qytetve e periudhave të ndryshme. Të gjitha këto përfundime të rëndësishme arrihen duke shfrytëzuar e logjikuar mbi shifrat e regjistruara në kohë të ndryshme.

9- Priirja e shqiptarëve për të luftuar ose shërbyer në ushtritë e ndryshme, perandorake, shtetërore si maqedonase, romake, romako – bizantine, veneciane, turke, ose të komanduar nga, ushtarak Venecian, Napolitan, Hasburgas të Austrisë apo të Spanjoll-Napolitan, Barbonian të Francës ose të Napolit, Angliez, Rusë, Prusian etj, për njohjen e tyre përveç shtypit të kohës, apo historianëve bashkohës të këtyre ngjarjeve, kërkohet shfrytësimi i regjistrimeve të popullsisë në vend origjinën si dhe të vendeve ku kanë luftuar.

REKOMANDIME

I- Formulimi nga qeveria e tanishme e një ligji mbi rregjistrimin e popullsisë Shqiptare në vend dhe jashtë sajë, dhe diskutimi e vendosja e këtijë ligji nga Parlamenti i saj si organ ligjvënës.

II- Krijimi i një komisioni të përbërë nga Juristë, Historian, ekonomiste,gjeograf etj për hartimin e një metodike apo udhëzuesi per kryerjene e regjistrimeve me nivelin bashkëkohor.

III- Hapja e një debati në shtypin, televizionin e radiot shqiptare mbi krijimin e një **Instituti të studimeve Demografike**, me statusin e një instituzioni shkencor, e te modernizuar me mjetet e sotme të informacionit.

IV- Angazhimi i Akademisë së Shkencave Shqiptare për të përkthyer, defterët apo regjistrat e periudhave të ndryshme Për shembull atë të vitit 1881 i cili gjendet edhe ne Arkivin e Shtetit Shqipetar e të tjera, që ndodhen ne Barcelon të Spanjës, në Stamboll dhe Ankara të Tuqisë, në Vjenë të Austrisë , në Napoli, Romë dhe Venezia të Italisë, në Beograd të Serbisë, ne Shkup të Maqedonisë, në Bukuresht të Rumanisë etj.

V- Në Institutin që propozojmë të ngrihet, te formohet arshiva e dokumentacionit nga rregjistrimet që do të kryhen dhe të tjerave që janë kryer përgjatë shekujve në vendin tonë dhe jashtë tijë.

VI- Të vihen në dispozicion nëpërmjet një faqeje të Internetit nga institucionet e mesipërme; regjistrat original dhe burimet e shkruara mbi demografinë e popullsisë shqiptare në vend, Greqi, Maqedoni, Serbi,

Kosovë, dhe Mal të Zi si dhe mbi shtegëtimet e popullsisë të vendit tonë dhe vendbanimeve shqiptare të sipërpërmendara në rrokullimën e shekujve ne gjithë botën.

VII- Instituti të shërbejë edhe si qender ndërlidhje me gjithë diasporën shqiptare të kudo ndodhur për të ndjekur hap pas hapi shtimin e popullsisë e ndryshimet e vendbanimeve dhe të dhëna të tjera individuale, familiare dhe fisnore të kurbetelinjëve shqiptar.

* * *

Duke studiuar me imtësi historigrafine Shqiptare nëpërmjet nje shumice të madhe dokumentash, si dhe shkaqet e lëvizjeve te popullsisë shqiptare Albhoneologu **Zef Valentini** arrin në një studim të vitit 1941 ne perfundimin:

“Shkaqe të ndryshme ndikojnë fuqishëm në çvendosjen, ndërftjen dhe përhumbenj e popullsisë, kolonizimi ose perzania me forcën e armeve të autoriteteve Qeveritare apo Mbretërore, shtegëtimi i blegtorisë sipas stinëve të vitit, kërkimet për të gjetur terrene më të përshtatshme banimi e bujqësore ose dhe klime më të shëndetshme, pushtimet e huaja, nevoja per t’i shpetuar gjakë marrësit,,

Sistemi eshtëror për të bërë të bindshme dukuritë historike e shoqerore të mësipërme duhen kërkuar me ngulm e durim në arshivat ku fshihen të dhenat e regjistrimeve të popullsisë shqiptetra në katraket vullkanike të shekujve, vetëm kështu çimentohet uniteti kombëtar, vetëm keshtu gjëndn dejet e gjakut të këtijë kombi që i japin jetë e lëvizje shumë qelizave të veprimtarisë njerëzore në të katër anët e globit.

Burimet e shfrytëzuara
1-Cordignano Fulvio “L’Albania nella storia e nella vita ossia visione panoramica di un piccolo mondo primitivo,, “Rivista d’Albania,, Anno II, Marzo. pp 19-33, Milano 1941
2-Halil Inalcik (Ankara) Les regions de Kruja e de la Dibra autour de 1467,, “Studia Albanica,, N. 2, Anno 1966. p. 89-102
3-Iliaz Kaca Kontribut për lokalizimin e disa qyteteve peneste sipas të dhënave burimore e Arkeologjike. “Dibra dhe Dibranët,, f. 59. Peshkopi 1981
4-Ferit Duka Shekujt osmanë në hapësirën Shqiptare (Sudime dhe dokumente) f. 224, 171. Tiranë 2010
5-Cordignano Fulvio Catasto veneto di Scutari e Registrum concessionum. f. 7, 8, Tolmezzo 1944
6-Giancarlo Valone Aspeti giuridici e sociali nell’eta ‘Aragonese: I Castrota nella terra d’Otranto. Atti del Convegno f. 225. Otranto 1970
7-E. Salaris L’Albania “La rassegna nazionale,, vol. CIV. f. 707,708. 16 Dicembre 1898.
8-Franz Seiner Numrim i parë i popullsisë në Shqypni. “Hylli i Dritës,, f. 560, 558. Dhjetor, 1922
9-Selami Pulaha Elementi shqiptar sipas onomistikës së krahinave të sanxhakut të Shkodrës ne vitet 1485-1582. “Studime historike,, N. 1. f. 63 Tiranë 1972
11-Çubrilović, V. L’expulsion des Amauts. f. 2, 3. Kosovë 1992
12-Antonio Baldaçi Note Epirotiche. “Rivista d’Albania,, Anno II. Giugno 1941. f. 115-116, Milano.
13-Përparim Huta Fshati ne sanxhakun e Shkodrës në shekujt XV-XVI. f. 22, 23, 40. Tiranë 1990
14- Google Regjtri di popolazione e censimenti in Albania f.1 Luglio 2011
15- Diego de Castro L’Albania il vicino di casa che gli Italiani non conoscono. “La stampa,, 4 Agosto 1965
16-Përkujtohet 66 vjetori i masakres se ushtrisë Greke mbi popullsinë Çame. Google. Qeshor 2011
17-At Guseppe (Zef) Valentini Publicistike, studime dhe tekste. f. 751, Tiranë 2005
18- Carlo Tagliavini La stratificazzione del lessico Albanese. f. 12, 13. Bologna 1965
19- Toti Bellone Albania giorni della rivolta. f. 13, 14. Congedo Editore, 1999
20- Giuseppe Valentini La migrazione stradiotica nell’onomastica e toponomastika Albanese,, “Rivista d’Abania,, Anno II, f. 228. Settembre 1941. Milano
21- Una popolzione Albanian. Google. Korrik 2011

Fillon zyrtarisht regjistrimi

Regjistrimi i popullsisë ka nisur zyrtarisht në të gjithë Shqipërinë. Por për shkak të fundjavës, procesi do të fillojë praktikisht ditën e hënë, kur grupet e regjistrimit do të udhëtojnë shtëpi më shtëpi.

Perfaqesuesit e Aleances Kuqezi, e cila ka kontestuar ne vazhdimesi kete proves deklaroi para zyrave te INSTAT, se vec te tjerash, ky proces bie ndesh edhe me vendimin e fundit te Gjykates Kushtetuese.

"INSTAT dhe zyrat e tjera shtetërore, të cilat paguhen me taksat tona shkelin vendimin e Gjykatës Kushtetuese. I bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve shqiptarë, që në momentin që grupet e regjistrimit do të trokasin në dyert e tyre, të grisin formularët. Ky veprim nuk bie në kundërshtim me ligjin dhe as me kushtetutën e vendit, pasi vetë ligji i ka cilesuar këto dy

PYETJE MBI CENSUSIN

Çfare është Censusi i Popullsisë dhe Banesave?

Censusi i popullsisë dhe banesave është numërimi i të gjithë njerëzve, banesave dhe pronave brenda territorit të Shqipërisë në një kohë të caktuar. Ai është një imazh statistikor që tregon, përmes të dhënave, kush jeton në Shqipëri, kushtet socio- ekonomike dhe kushtet e jetesës. Censusi është një nga veprimtaritë statistikore më të rëndësishme e cila siguron një informacion te detajuar mbi numrin dhe strukturën e popullsisë, e krahasueshme edhe në njësi shumë të vogla gjeografike. Censusi nuk është i lidhur me regjistrat e taksave, pensioneve, pronësisë, shpërndarjes se energjisë elektrike apo statusit të emigrantit.

Për çfarë shërben Censusi?

Censusi jep një përshkrim të detajuar të gjitha aspekteve ekonomike, sociale dhe të jetës në Shqipëri. Sa njerëz banojnë në Shqipëri sot dhe si jetojnë ata, për çfarë shërbimesh kanë nevojë ata, dhe shumë aspekte të tjera të shoqërisë. Të dhënat e Censusit do të sigurojnë këtë informacion dhe do të ndihmojnë autoritetet përgjegjëse të planifikojnë mbi baza reale dhe të hartojnë politika për nevojat konkrete në fushat e shëndetësisë, edukimit, punësimit, infrastrukturës etj. Për më tepër të dhënat e Censusit mundësojnë krahasimin midis qyteteve dhe zonave kështu që institucionet ndërkombëtare dhe shqiptare mund të ndjekin me lehtësi zhvillimet dhe të planifikojnë aktivitetet e tyre më me saktësi.

Pse i shkruani emrat e të gjithë familjes time kur thoni që të dhënat janë anonime?

Të dhënat personale përdoren vetëm gjate fazës së numërimit për të siguruar që një pyetësor individual është plotësuar për çdo person, por ato nuk do të përdoren në asnjë mënyrë pas përfundimit të kësaj faze. Të dhënat do të përdorën vetëm në formë të agreguar dhe jo të personalizuar.

Ku mund të gjej informacion shtesë rreth Censusit?

A: Për më shumë informacion ju lutem vizitoni adresën e faqes së internetit te Censusi: www.census.al ose nëse keni pyetje të tjera në lidhje me çështje të tjera të Censusit ju lutem na dërgoni një e-mail në: info@instat.gov.al ose na telefononi: 0800 3333 ose 0800 8888.

Çfarë do të ndodhë me të dhënat e mia?

Ligji garanton mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. I gjithë informacioni i mbledhur do të jetë konfidencial dhe do të shërbejë vetëm për të nxjerrë të dhënat zyrtare të Censusit dhe statistikat e tij. Pyetësorët do të jenë të sigurt dhe vetëm INSTAT do të mund te kryejë hedhjen dhe përpunimin e të dhënave. Informacioni personal i Censusit mbahet konfidencial. Të dhënat e Censusit do të përdorën vetëm si shifra të agreguara dhe do të shërbejnë vetëm për të publikuar të dhënat dhe statistikat zyrtare të Censusit.

Pse pyesni rreth besimit fetar dhe etnik?

Individët mund të tregojnë në Censur etninë dhe besimin e tyre fetar nëse ata dëshirojnë, por sigurimi i këtij informacioni nuk është i detyrueshëm. Ky është një parim në përputhje me standartet ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara japin disa rekomandime lidhur me këtë pike. Në “Parimet dhe Rekomandimet për Censusin e Popullsisë dhe Banesave 2008” thuhet: të dhënat etno-kulturore janë të rëndësishme për të kuptuar diversitetin kulturor të një popullate, pozicionimin e grupeve etnike në shoqëri si dhe për hartimin dhe monitorimin e politikave antidiskriminuese.”

pyetje si fakultative", thonë përfaqësues të Aleancës.

Dite me pare, permes ministrit te Inovacionit dhe Teknologjise Genc Pollo, qeveria i beri thirrje qytetareve qe te marrin pjese ne kete proces, i cili kryhet per here te dyte pas 10 vitesh. "Apeloj që cdo qytetar me krenari të bashkëpunojë me censusin, me krenari të deklarojë të dhënat, e veta të banesës, të familjes, sepse kështu jep kontribut për vendin", tha Pollo.

Kunder censusit eshte deklaruar edhe organizatat e minoritetiti grek ne shqiperi 'Omonia', e cila beri thirrje per bojkotimin e procesit. Regjistrimi i popullsisë mbi bazen e etnise dhe fese ka shkaktuar mjaft debat dhe polemika, edhe per faktin se keto te dhena te pordhuara nga instat mund te perdoren nga qarqe te ndryshme naciobaliste greke. *(Tch)*

Shumë shtete e përdorin këtë informacion për të kuptuar proceset e integritit të emigrantëve dhe fëmijëve të tyre. Ky informacion gjithsesi është vullnetar, kështu që asnjëri nuk është i detyruar të tregojë besimet e tij kundër dëshirës së tij/saj.

A duhet t’ia tregoj kartën time të identitetit numëruesit?

Jo! Të dhënat personale (data e lindjes, vendlindja, gjendja civile, etnia, shtetesia, shkollimi,etj) do të mblidhen mbi baza të deklarimit vullnetar. Megjithatë ju mund të përdorni kartën tuaj të identitetit dhe çdo dokument tjetër nëse ju ndihmon të jepni informacion të saktë.

A ka pasoja ligjore ose tatimore mbledhja e të dhënave të Censusit?

Jo! Të dhënat e mbledhura nuk kanë pasoja ligjore. Ato nuk mund të përdorën për ndjekje penale ose tatimore.

Për çfarë do të përdorën të dhënat e Censusit?

Politikëbërësit dhe vendimmarrësit i përdorin të dhënat e Censusit për të planifikuar një gamë të gjërë shërbimesh në përputhje me nevojat e njerëzve. Institucionet akademike i përdorin të dhënat e Censusit për kërkime demografike, shkenca sociale, ekonomi, mjedis, menaxhim publik, edukim dhe shumë të tjera. Te dhënat e Censusit janë gjithashtu të rëndësishme për biznesin dhe zhvillimin ekonomik. Të dhënat e mbledhura të Censusit japin një profil të detajuar të tregut të punës, nivelin e shkollimit të personave të punësuar,tregojnë zonat me papunësinë më të lartë, nevojat për ndërhyrje shtetërore dhe programe edukimi. Të dhënat e sakta ndihmojnë në zhvillimin e ekonomisë duke siguruar të dhëna esenciale për investitorët dhe programet e ndihmës.

A jam unë i detyruar të përgjigjem?

Po. Të gjithë njerëzit që jetojnë në Shqipëri,vendas dhe të huaj, me përjashtim të stafit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët janë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në kohën e Censusit, janë të detyruar të sigurojnë saktësisht informacionin e kërkuar për Censusin, për veten dhe të afërmit e tyre. Pjesëmarrja në Censur e të gjithë njerëzve që jetojnë në Shqipëri është një detyrim shoqëror dhe komunitar.

Si do të numërohem nëse nuk kam shtëpi?

Të gjithë personat qe nuk kane një banese do të konsiderohen të pastrehë dhe do të regjistrohen si të tillë. Vetëm pyetësori individual do të plotësohet prej tyre.

Po nëse asnjë pjesëtar i familjes time nuk është në shtëpi gjate vizitës së anketuesit?

Nëse asnjë pjesëtar i familjes nuk do të jetë prezent në banesë gjatë vizitës, numëruesi do të lerë një njoftim për të ju informuar për datën dhe kohën e vizitës tjetër duke lënë numrin e tij/saj të telefonit kështu që familja mund ta kontaktojë, dhe nëse është e nevojshme të bien dakord për një datë tjetër.

Kush do të numërohet?

Njerëzit që jetojnë në Shqipëri - përfshirë rezidentet e huaj – të gjithë që kanë qëndruar minimumi 1 vit, ose me qëllim për të qëndruar të pakten një vit. Vetëm diplomatet nuk do të numërohen. Nëse në apartamentin tuaj ndodhet si qiramarrës një shtetas i huaj, ju lutem lejojeni anketuesin të takohet me të. Njësitë ekonomike familjare, banesat (të banuara apo jo) banesat kolektive të banuara do të përfshihen në numërim gjithashtu. *(http://census.al)*

Parku i Lurës ka një sipërfaqje prej 1.280 hektarë dhe ndodhet në pjesën lindore të malit masiv të quajtur “Kurora e Lurës”.



Me 14 liqenet e tij akullnajrore krijohet një ambjent piktoresk dhe tërheqës në një lartësi nga 1.350-1.720 m. Midis këtyre Liqeneve më të mëdhenjtë janë: Liqeni i Madh 32 hektarë, liqeni i Pishave 13 hektarë, liqeni i Zi 8 hektarë dhe liqeni i Luleve 4 hektarë



Lura ka pasuri të rralla nëntokësore do të kërkohet të investohet nga biznesi vendas dhe i huaj për të investuar në këto pasuri e kryesisht në krom, bakër e gurë dekorativ dhe të gjitha këto do të arrihen me ndërtimin e rrugës Perlat – Kurbnesh – Lurë.

Lura ka nevojë për infrastrukturë rrugore

Nga: ing. SHKËLQIM LUSHA

Parku i Lurës ka një sipërfaqje prej 1.280 hektarë dhe ndodhet në pjesën lindore të malit masiv të quajtur “Kurora e Lurës”.

Me 14 liqenet e tij akullnajrore krijohet një ambjent piktoresk dhe tërheqës në një lartësi nga 1.350-1.720 m. Midis këtyre Liqeneve më të mëdhenjtë janë: Liqeni i Madh 32 hektarë, liqeni i Pishave 13 hektarë, liqeni i Zi 8 hektarë dhe liqeni i Luleve 4 hektarë

Në dimër këto liqene janë të mbuluara nga akulli.

Cila është në të vërtetë Lura? Mjafton të ngjitesh në Majën e Kurorës, 2121 metra e lartë, ku syri të kap një hapësirë të gjerë, para ke një “det” të tërë me male dhe lugina. Pamje te Ilila jo cdokund mund te perseriten

Kënaqësitë për pushime nuk vijnë vetem nga brigjet e deteve ato vijnë dhe nga malet, madje të ndjehesh më i adrenalizuara në tërë trupin dhe mendjen; më i freskët, më energjik, më i frymëzuar teksa kalon nëpër gryka e hone, majë malesh, , kullota alpine e kreshta pyjesh, të peshkosh në liqenet natyrore, t’u ngjitesh të tatëpjetave dhe të zbresësh mes flladit dhe erës aromatike që përcjellin lloj-lloj bimësish që nga shkurishtet deri tek arneni, bredhi apo ahnajat

Ky pra është turizmi malor i Shqipërisë !..

Por që t’i shijosh këto bukuri duhet infrastruktura ku më e rëndësishmja dhe më kryesorja për mendimin tim (shprehjen si inxhinier) është infrastruktura rrugore ashtu siç i kanë dhe simotrat Razma, Boga, Voskopoja ,Dardha, Valbona, Llogaraja etj. Është infrastruktura rrugore ajo që sjell zhvillimin në tërësi të të gjithë aktiviteteve të tjera jetësore (pa infrastrukturë rrugore nuk ka zhvillim).

Kushtet hidrologjike të Lurës po bëjnë të mundur ndërtimin e tre Hidrocentraleve të vegjël në Lumin Molla e Lurës, ku me vënie në shfrytëzin të tyre do të prodhohet energji për zonën e Lurës e për më tej.

Lura ka pasuri të rralla nëntokësore do të kërkohet të investohet nga biznesi vendas dhe i huaj për të investuar në këto pasuri e kryesisht në krom, bakër e gurë dekorativ dhe të gjitha këto do të arrihen me ndërtimin e rrugës Perlat – Kurbnesh – Lurë.

E thënë në mënyrë të përmblendhur ndërtimi i këtij aksi rrugor, ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël dhe shfrytësimi i pasurive të rralla mbetokësore dhe nëntokësore do ti japin një zhvillim të madh kësaj zone (perlë turistike)

Lurës

Me ndërtimin e rrugës së kombit (Durrës – Kukës – Prishtinë) edhe Lura ky park i madh turistik i vendit tonë është afruar më shumë me Tiranën duke i dhënë një shtysë më të madhe zhvillimit të turizmit malor

Kështu për tu lidhur me aksin kryesor të kësaj rruge që kalon nëpër grykën e Fanit do të duhen investime vetëm 37 km ku 19 km është aksi rrugor Fushë Lurë – Kurbnesh dhe 18 km të tjera janë Kurbnesh- Perlat .

Kurse aksi rrugor Perlat – Rrëshen është një rrugë e kryer . Me ndërtimin e këtij aksi rrugor do të bëhet e mundur që vetem për dy orë të shkohet nga Tirana në Lurë

Mbi projektin e Rrugës Perlat i Epërm – Kurbnesh – Lurë (termat e referencës)

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve i ka hartuar termat e referencës për studim projektimin e rrugës Perlat i Epërm – Kurbnesh - Lurë – Liqenjtë e Lurës

Rruga Perlat i Epërm – Kurbnesh - Lurë- Liqenjtë e Lurës (56 km) lidh rrugën kryesore duke filluar nga Rrësheni, krijon lidhjen me rrugën e vjetër të Burrelit në Urakë dhe vazhdon në

drejtim të Perlatit të Epërm në Lurë dhe vazhdon në drejtim të Peshkopisë.

Gjatësia totale e rrugës shkon në rreth 56 km dhe fillon në fundin e projektit të segmentit Prosek – Perlat - Kurbnesh në vendin e quajtur Ura e Ndreajt dhe përfundon në Kryqëzim Liqenjtë e Lurës në fillimin e investimit të kryer nga pushteti lokal.

Gjërësia e trupit të rrugës ekzistuese varion nga 5-8 m.

Rruga zhvillohet në terren kodrinor dhe kryesisht malor në formacione gjeologjike përgjithësisht të përshtatshme si bazament inxhinierik. Rruga eksistuese është e tipit makadam me kalldrëm dhe me mbulesë çakulli, gjendja teknike e rrugës është e mirë. Elementet altimetrik dhe planimetrik janë të vogla duke kufizuar ndjeshëm vështirësojnë lëvizjen e trafikut. Rruga përban një inventar të konsiderueshëm veprash arti me gjërësi 4-7 m, ku gjendja teknike e një pjese e konsiderueshme të tyre ka nevojë për zëvendësim, rikonstrukcion dhe zgjerim.

Rruga Perlat i Epërm – Kurbnesh - Lurë- Liqenjtë e Lurës (56 km) lidh rrugën kryesore duke filluar nga Rrësheni, krijon lidhjen me rrugën e vjetër të Burrelit në Urakë dhe vazhdon në drejtim të Perlatit të Epërm në Lurë dhe vazhdon në drejtim të Peshkopisë. Fillon në fundin e projektit të segmentit Prosek – Perlat - Kurbnesh në vendin e quajtur Ura e Ndreajt dhe përfundon në Kryqëzim Liqenjtë e Lurës në fillimin e investimit të kryer nga pushteti lokal.



Naim Berisha, të mërkurën më 5 tetor 2011, në orën 18:00, në Sallën e Akademisë së Shkencave do të prezantojë krijimtarinë e tij më të re artistike: romanin “Gurkështjella”, vëllimin me poezi e poema “Vjershë e ndaluar” si dhe një album me këngë “Për ty këndo”.

Në ç’truall lindi ky libër

Në vend të përcjelljes të romanit “Gurkështjella”



Nga:
**NAIM
BERISHA**

Që në moshë fëmimore kam qenë i dhënë shumë pas librave me fabula. Kisha lexuar herët Ezopin, La Fontenin, Krillovin, etj. Mjaft nga fabulat e këtyre autoreve të mëdhenj, të cilat unë i kam pasë recituar në Shtëpinë e kulturës së vendlindjes sime, etj., qysh kur isha nxënës i tetëvjeçares, i mbaj mend dhe sot e kësaj dite. Njëpër oda iu vija veshin meseleve, fjalëve nën shtrijore, anekdotave që tregonin më të moshuarit, etj., dhe rreksha të kapja nëntekstet dhe mesazhet që përcilleshin. Kur nuk mundja t’i deshi-froja si duhet kodet dhe bisedat alegorike, pyesja të afërmit e mi, më të pjekurit, me të cilët isha i shoqëruar, fjala vjen, babanë, mixhën, një kushëri a një mik. Aq shumë qesh dashuruar pas të folurit figurativ që në vogli, sa që edhe pse isha i prirë jashtë mase, në të njëjtën kohë, pas muzikës, kur erdhi dita, e braktisa këtë të fundit dhe studimet e larta i kreu për gjuhë-letërsi.

Në Dibrë, thuhet rëndom, se gjëja më e lezetshme është kuvendimi. Ai që di të kuvendojë, hijeshon vendin ku rri. Mirëpo ka dhe syresh, që, duke mos nuhatur semantikën ose manane (larghedhjen e fjalës shifer) jo rrallë, i ngarkojnë nëntekstet, gabimisht, mbi kurrizin e tyre, gjë që krijon, pastaj, situata të pakëndshme, qesharake, deri në perversitete.

Kur isha student m’u dha shansi, një herë, të pija një kafe diku në një bar të Tiranës me profesorët Zihni Sako dhe Qemal Haxhihasani. “Është nga Muhurri, ...” më prezantoi pedagogu im i folklorit përpara profesor Zihniut, që ish pensionist. “Qenke, m’u drejtua me gisht ai, (past ndjesë) nga treva e Dine Hoxhës. Treva e Muhurrit edhe para kohës së Dines, - theksoi profesor Zihni Sako, ka qenë treva më figurative e Dibrës dhe, pse jo, e gjithë Shqipërisë. Mua më erdhi mirë që më lavdëroi katundin, por më shumë më bëri përshtypje se si ai përmendi pa frikë emrin e Dine Hoxhës, (atëherë edhe pse s’jetonte, ai qe shpallur kryekulak dhe gjithë fisi i tij luftohej) dhe, që të jem i singertë, u frikësova pak se mos po kapesha, si me thënë, gafil ...(!?) Më pastaj pikasa se të dy profesorët ishin aq të hapur dhe konfidentë me mua, sa folën me hollësi për historinë e Dines. Muhurritin e quajtën zemrën e Dibrës dhe njërin nga Nëntë Malet më në zë të saj.

I kisha kryer studimet dhe punoja si drejtues i kulturës në Shtëpinë e Ushtarakëve të Peshkopisë, kur ia

dhashë për t’ ma parë një libër, dorëshkrim me poezi, profesorit tim të nderuar të mbrojtjes së diplomës Nasho Jorgaqi. Pas një muaji, sipas fjalës, u ritakua. E nuhata qysh në fillim nga çehria se profesor Nashos nuk i kish pëlqyer dhe aq libri, sado që rrekej me fjale duke sheqerosur ndonjë vjershë, tek-tuk, për të mos ma prishur. Në fund, kur po ndaheshim, më këshillon si një prind i urtë: “Naim, në do suksesin në poezi, mbështetu fort në folklor, në eposin e kreshnikëve. Ti je dhe nga veriu. Pse ka sukses, psh, Ndoc Papeleka? Sepse shfrytëzon Epin e Veriut. Së dyti, në do që të ecësh, pa lënë pas dore poezinë, përkushtoju më fort mësimi të anglishtes. Sot është e domosdoshme anglishtja!”


Pse i perifrashova profesorët e mi të paharrueshëm? Sepse fjala e tyre më ka nxitur shumë në krijimtarinë time. Jam mbështetur, sipas këshillave të tyre, në mençurinë e pamatë të popullit, në krijimtarinë e tij aq të pasur dhe domethënëse. Kështu, pas librit të parë të suksesshem poetik “Ngado sytë e vajzës”, botuar te “Enciklopedikja” me 1993, shoqëruar me një parathënie të shkëlqyer nga profesor Bedri Dedja, Akademik, pasuan shpejt dy libra të tjerë, gjithashtu, poetikë, tek “Toena”. Nuk shkoi gjatë dhe me 29 janar 1996, shtëpia botuese më prestigjioze në gjithë trevën autentike shqiptare, “TOENA” organizoi në qytetin e bukur të Burrelit promovimin e dy librave të rinj: “Hiq dorë” dhe “Lejlekët e lumit tim”. Qe një festë e vërtetë. Më sinjifikative e bënë atë, prania e shkrimtarëve të shquar, si: Dritëro Agolli, Teodor Laço, ish ministër i Kulturës, Odhise Grillo, Ferit Lame, Hasan Çipuri, Adem Jakllari e shumë të tjerë, profesorë e doktorë të nderuar, që kishin ardhë nga Tirana, kishin bërë njëqind kilometra rrugë për hatrin tim dhe, njëherësh, të librave të mi. Por edhe pritja që organizuan shkrimtarët dhe artistët matjanë, si: Basir Bushkashi, Behar Gjoka, Hasan Huta, Esat Ruka, Rakip Lasku, Hamdi Uka, Ben Bici e të tjerë, ishte e jashtëzakonshme. Ndaj, edhe pse kanë kaluar më shumë se 15 vjet, unë s’e harroj atë ditë derisa të vdes. Ajo do të mbetet nga ditët më të bukura të jetës sime. Ajo ditë, më bëri të ndjeja më mirë rritjen, si pasojë e drejtpërdrejtë e mbështetjes në folklor.

Nejse. Kur po iknin, shkrimtari i shquar Odhise Grillo, pastë ndjesë, më dorëzoi librin dorëshkrim me

fabula, të cilin ia kisha dhënë kohë më parë për t’i hedhur një sy. Kam bërë më tha disa ndreqje të vogla, me të cilat nuk e di a do të pajtohesh! “ Ç’është ajo fjalë!, - i thashë. Në verën e ’97, u transferova familjarisht në Tirane. Edhe me Dritëroin, Teodorin e të tjerë takohesha shpesh, kurse me Odhisenë gati përditë. Pinim kafe, zakonisht, te “Vjeshta” ish kioska përbri pallatit të madh të kulturës. Një ditë më pyeti për atë librin me fabula që e kish redaktuar vetë. I thashë se kisha ndërruar mendje, se librin me fabula po e transformoja në një poemë të gjatë fabulike dhe që mund ta quaja roman. Si thua, - i thashë. Shumë mirë, - tha, - nëse ka veprim. Kur ta mbarosh, po të duash, ma kalo mua ta shoh, përpara se ta botosh. Pas një jave librin e kisha gati dhe ia dhashë Odisesë në dorë. Shikoje, avash-avash, se nuk kam ndërmend ta botoj tani, - i thashë. - Dhe, të lutem, sa të mundesh më shumë t’i biesh kresë! Nuk dua lavdërime. E di si më thotë im atë, - i thashë. - Ruaju nga ata që të lëvdojnë, jo nga ata që të kritikojnë! Odiseja qeshi. Dua të njihem me babanë tënd. Nga kjo fjalë që më the ti për të, e gjykoj burrë të urtë. Një natë e mora Odisenë në shtëpi. Ishte një gëzim i veçantë për babanë tim të njëhej me Odhise Grillon, të cilit ia kishte lexuar, së paku, gjysmën e librave. Jo të gjitha! Se ku lexohen më shumë se njëqind libra që ka Odhiseja.

Mbas disa ditësh Odhiseja më thotë se e kishte lexuar romanin, të cilin, ende, e kisha me dy tituj “Xhungla” dhe “Istref Kulla shoë”. Të dy titujt Odhiseja nuk m’i pëlqeu. Meqenëse ngjarjet, tha, ndodhin në Gurkështjellë, titulloje “Gurkështjella”. Ç’mendon, e pyeta, për shembull: “Njerëz dhe kafshë”. Mirë, tha, po me kuptimplotë është “Gurkështjella”. Po për “kafshët e kështjellës” si thua? Ai rrudhi buzët. Është romani i Xhorxh Oruellit “Kafshët e fermës”. Duket si një paralelizëm...! Pastaj, ti, i më tha, në roman nuk flet vetëm për kafshë, por edhe për njerëz. Ekzakt, ia bëra unë. Tek e fundit, shtoi, s’ka shumë rëndësi titulli. Desha të të them, se ke bërë një punë shumë frytdhënëse, ke shfrytëzuar në mënyrë krijuese folklorin tonë. Do të jetë një roman i një lloji të veçantë, i pashkruar deri sot tek ne. Mund të quhet roman në vargje “Këngët e Milosaos” së De Radës, po yti është i një zhanri të përzier, sa romantik, social-

■ Duke përcjellë këto rreshta, u rreka t’i tregoj lexuesit tim të dashur, se në ç’truall frymëzimi lindi dhe mori jetë ky roman në vargje. Roman, të cilin, nëse do të gjesh kohën, durimin dhe përqendrimin e duhur të vëmendjes, për t’i shkruar deri në fund, mund t’ju siguroj, mik i nderuar i librit, se nuk do të zhgënjehesh!



NAIM BERISHA

Naim Berisha ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në degën Çjuhë-Letërsi, Tiranë. Më pas ka punuar si mësues, muzike, gjuhë-letërsie, drejtues e kulture në terren dhe në ushtri. Në qytetin e Peshkopisë, në qytetin e Burrelit dhe në ushtri. Në qytetin e Peshkopisë, në qytetin e Burrelit dhe më pas në Tiranë ka punuar si gazetar.

Që nga viti 1998, ai punon dhe jeton në Londër. Atje ka kryer edhe disa kualifikime pasuniversitare për media, muzikë, kritikë letrare, letërsi angleze etj.

Ai, tashmë, është autor i pesëmbëdhjetë librave artistikë. E ka nisur krijimtarinë me librin poetik “Ngado sytë e vajzës”, më 1993, pasuar me vëllimet e tjera poetike: “Lejlekët e lumit tim”, “Hiq dorë”, “Zog i qiellit”, “Le të vij në vajzat”, “Njëzet lumenj rrjedhin në klasën time”, “Ç’m’i ra vrugu gjethit t’verës”. Të tjerë libra të autorit janë: “Nata e një lypësi” (tregime), “Kafshët në kuvend” (poema me fabula), “Djallëzia e kafshëve” (poema me fabula), “Vetëvrastja e shpirtit” (roman), “Bjeshkët e dashurisë” (roman) etj.

Naim Berisha herë pas here ka marrë vlerësime për poezinë dhe prozën e tinga shumë personalitete të spikatura të letrave shqipe si Dritëro Agolli, Teodor Laço, Fatos Arapi, Nasho Jorgaqi, Xhevahir Spahiu, Odhise Grillo, Bedri Dedja, Ramadan Musliu, Mehmet Kraja, Xhavalin Kola, Fatmir Terziu, Behar Gjoka, Hajri Mandri, Mujë Buçpapaj, Skënder Zogaj, profesor doktor Murat Z. Gecaj e të tjerë.

psikologjik, e mbi të gjitha, satirik. Ai fshikullon çdo lloj diktature dhe çdo shfaqje totalitarizmi, akroballeku, autoritarizmi, inferioriteti, ligësie, sadizmi, etj. Sa mirë që të ka shkruar në mendje. Pastaj ka dhe koherencë, ka lidhje logjike, të besueshme midis ngjarjeve, rrethanave, karaktere të krijuara me kujdes dhe fantazi, po ka dhe humor. Aty flasin dhe veprojnë njerëzit, po flasin dhe veprojnë dhe kafshët e shpendët. Ka dhe kafshë të egra, dhe të buta, dhe të zgjuara, dhe trashamane, etj.

Mendimet e tij i ruaj të shkruara ashtu siç m’i ka dhënë 14 vjet më parë, në një dyfletësh aritmetike, të dorëshkruar pastër e kuptueshëm me atë kaliografinë e tij të veçantë të bukurshkrimit, një shenjë më shumë kjo e inteligjencës së rrallë të tij. Për vlerat e librit në fjalë, për hir të së vërtetës, më duhet të them se ai është shprehur me më superlativa se në parathënie që shoqëron librin e dytë poetik “Lejlekët e lumit tim”. Në momentin e duhur unë do ta botoj dorëshkrimin kritik të tij.

Takimi i fundit me Odhise Grillon ka qenë me 15 shtator 1998 në kafën e Lidhjes së Shkrimtarëve, një natë para se të nisesha për në Angli. Përgjatë gjithë kohës, në të cilën nuk u takuam më kurrë, për shkak të ikjes së papritur të tij, ne kemi pasur korrespondencë të rregullt. Në njërën

nga letrat e shumta, të cilat unë i ruaj si relikte tejet të çmuara, më pyet se çfarë kisha në mend të beja me romanin “Gurkështjella”. Ai, (pastë ndjesë atje tek është në parajsën qiellore) atëherë, punonte te “Toena” dhe më nxiste që t’ia nisja për botim. Kur kam marrë vesh vdekjen e tij, jam ndërjerë plotësisht i shokuar dhe për një kohë të gjatë nuk e kam marrë veten. Me humbjen e tij, unë, për vete, humba një thesar të pagmuar! Ai s’ishte veç një shkrimtar i madh, por, mbi të gjitha, ishte një ndihmëtar i madh, i pakursyer, i papërtueshëm, që s’kishte asnjë lloj kompleksi, një mik i të gjithëve dhe, mbi të gjitha, një njeri aq i dijshtë, por dhe aq i thjeshtë. Një njeri i vërtetë dhe, njëherësh, një artist i lindur, tek i cili, më mirë se te kushdo tjetër, mishërohej ajo fjala e madhe e Zhan Pol Sarrit: “Tek e thjeshta, edhe madhështia, tek një lot, edhe një det.”

* * *

Duke përcjellë këto rreshta, u rreka t’i tregoj lexuesit tim të dashur, se në ç’truall frymëzimi lindi dhe mori jetë ky roman në vargje. Roman, të cilin, nëse do të gjesh kohën, durimin dhe përqendrimin e duhur të vëmendjes, për t’i shkruar deri në fund, mund t’ju siguroj, mik i nderuar i librit, se nuk do të zhgënjehesh! Ju faleminderit!

Shaban Dervishi rrëfen jetën: nga “suksesi” në “dështim”. Përpjekjet për rehabilitim dhe tentativa e dështuar për të takuar Enver Hoxhën.

“Krenarinë nuk ia uli as diktatura”

Pyetje: Z. Shaban, me sa dimë, këto ditë ju mbushni 75-vjet nga dita e lindjes. Ju urojmë edhe shumë vite të tjera me shëndet e lumturi! Në këtë përvjetor pak fjalë për jetën e Shaban Dervishit?

Përgjigje: Ju faleminderit që qenkeni interesuar për mua dhe për urimin që më bëtë për 75 vjetorin e lindjes.

Unë kam lindur, më 2 tetor të vitit 1936, në fshatin Dardhë të Dibrës. Babai im Elezi qe një vëlla i vetëm. Punoi dhe u lodh shumë. Për disa kohë punoi si çoban i të pasurve në malin e Gramës. Atje ra në kontakt me përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe kontribuoi për të, me ushqime dhe veshmbathje. Pas disa vitesh u kthye në fshat dhe pati një ekonomi të dobët. I vetmi, isha unë që duhej ta ndihmoja si djalë i madh i shtëpisë. Prandaj, që kur mbusha 12 vjeç punova si hyzmeqarë te disa familje tiranase. Kam qenë ndër të parët e asaj kohe që mbarova një shkollë profesionale l'veçare dhe fitova kategorinë e katërt si karpantjer. Pas shumë vitesh kam mbaruar shkollën e mesme ekonomike si dhe kursin tremujor të Partisë.

Kam punuar në ndërmarrjen e Përpunim Drurit në Peshkopi dhe në ndërmarrjen Bujqësore Kamës. Aty gjeta një drejtor të zot, Gafurr Korçën, i cili e kishte njohur nga afër babain tim që kur ishte partizan. Ai u interesua mrekullisht për mua dhe në sajë të këtij kujdesi e të punës time arrita të bëhem edhe drejtues i Bashkimeve Profesionale të NB Kamës me 400 anëtarë.

Në vitin 1959 provova një hidhërim të madh. Më sëmuret rëndë babai. I bëmë të gjitha ndërhyrjet e vizitat në Peshkopi dhe Tiranë, por gjendja e tij shëndetësore nuk u përmirësua, përkundrazi u keqësua dhe vdiq. I bëmë ceremoninë e lamtumirës si më mirë. Pas vdekjes së babait unë qëndrova në vendlindje. Aty fillova punë, fillimisht si shitës dhe më vonë magazinier. Isha i qetë dhe i saktë në punën time, çka më bëri të fitoja shumë respekt te bashkëfshatarët e mi.

Pyetje: Ju nuk keni qenë vetëm një punëtor i thjeshtë, por edhe kuadër. Çfarë mund të na thoni për këtë?

Përgjigje: Isha një nga të rinjtë e shkathët të fshatit. Pata punuar me rininë dhe shokët e Komitetit të Rinisë rrethit, vetë sekretari Sinan Saraçi më njihte e më vlerësonte shumë.

Duke parë punën e qëndrimin tim nuk mungoi edhe ngritja në detyrë. Kështu për disa vite kam kryer detyrën e sekretarit dhe të kryetarit të Legalitetit deri në shkrirjen e tyre. Në vitin 1973 u emërova edhe Kryetar i Kooperativës Bujqësore të Dardhës. Megjithatë kisha shumë vështirësi si terreni i hapur, temperaturat e ulëta,

infrastruktura mungonte etj. pata disa arritje, kryesisht në rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore e blegtorale si dhe në rritjen e vlerës së ditës së punës. E gjeta me 1.8 lekë për ditë pune dhe e çova deri 5 lekë, brenda vitit duke likuiduar edhe një pjesë të kredisë ndaj shtetit. Nga viti në vit pata rritje të vlerës së ditës së punës, e cila në vitin 1975 arriti në 8-10 lekë për ditë pune. Kooperativa Bujqësore e Dardhës krejtësisht malore, qe radhitur ata vite ndër kooperativat bujqësore më të dalluara të rrethit Dibër. Gjithashtu, unë fitova një emër të mirë jo vetëm në Dardhë, por në gjithë rrethin. Më donin dhe më vlerësonin të gjithë kuadrot e partisë e të pushtetit të rrethit.

Pyetje: Ju keni qenë anëtar i PPSH, por aty nga viti 1975 jeni përjashtuar. Për ju foli Sekretari i Parë i KQ të PPSH, Enver Hoxha dhe që nga ajo kohë ju nuk u rikthyet në parti. A mund të na thoni si ndodhi dhe çfarë peripecish kaluat?

Përgjigje: Është e vërtetë se unë për 16 vjet kam qenë anëtar i thjeshtë i PPSH. Gjatë gjithë kohës punova me përkushtim dhe u mundova ta mbaja me nder e me dinjitet taserën e Partisë. Nuk isha i dhënë pas luftës së klasave dhe në disa momente qeshë kritikuar për zbutje të saj. Në vitin 1971 filluan traumat e genies anëtar partie. Atë vit për arsye biografike, pavarësisht se nuk qëndronin ashtu siç flitej dhe unë bëra sqarimet e duhura, organizata bazë e partisë Zall-Dardhë më dha vërejte me paralajmërim për përjashtim nga partia. U mundova të punoj me ndershmeri e ndërgjegje të lartë dhe ta shlyj sa më parë këtë masë ndëshkimore.

Por, çdo shpresë u shua dhe gjëma e madhe erdhi në vitin 1975. Ato ditë prilli, në tavolinën e Sekretarit të Parë të KQ të PPSH vajti një letër. Ajo ishte përpiluar nga ustallarë të vjetër, cmirëxhinj dhe dashakeqës të mi. Aty ishin ngritur disa probleme dhe kryesisht biografike. Enver Hoxha e merr, e lexon, bën shënimet dhe bëri një përgjithësim për gjithë Republikën në një buletin me përdorim të brendshëm të asaj kohe, i cili u punua në të gjitha organizatat bazë të partisë në vendin tonë. Erdhi edhe në Dibër e në fshatin tim. Midis tjerash Enver Hoxha konkludonte: **“Kush është ky kryetar kooperative? Skandaloze!”**

U bënë mbledhje pas mbledhjesh derisa më në fund u përjashtova nga partia. E përjetova me shumë dhimbje. Kalova një situatë shumë të rënduar shpirtërore dhe psikologjike.

Nuk e pranova masën ndëshkimore dhe nuk lashë derë pa trokitur në rreth dhe në Tiranë. Muaj të tërë qëndrova në Tiranë, 16 letra e telegrame Sekretarit të Parë të Rrethit, të KQ të PPSH Enver Hoxhës, Hysni

Të fundit takim pata me z. Ramiz Ali, Ibrahim Sinën e të tjerë anëtarë të Byrosë Politike. I kërkova të më takonte me Enver Hoxhën, pasi ai kishte folur direkt për mua. Mu përgjigj se ishte e pa mundur, pasi ai ishte i sëmurë rëndë. Unë e dija fort mirë, se askush nuk mundej t'i a prish atij e ti thoshte se ke gabuar me Shaban Dervishin.

Kapos, Haxhi Lleshit etj, por asnjëherë nuk munda ta takoj personalisht Enver Hoxhën.

Të fundit takim pata me z. Ramiz Ali, Ibrahim Sinën e të tjerë anëtarë të Byrosë Politike. I kërkova të më takonte me Enver Hoxhën, pasi ai kishte folur direkt për mua. Mu përgjigj se ishte e pa mundur, pasi ai ishte i sëmurë rëndë. Unë e dija fort mirë, se askush nuk mundej t'i a prish atij e ti thoshte se ke gabuar me Shaban Dervishin. E dija, se ata e kanë gënjyer dhe se po të mësonte të vërtetën do më kthente në Parti. Sa për të tjerët e dija se nuk mund të më riabilitonin sërish. Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Asnjëherë dhe askush nuk mundi të më japë taserën e Partisë, por dhanë porosi për të më punësuar në detyra më të vogla. Unë nuk pranova të marr detyra e përgjegjësi dhe kërkova vetëm të punësohesha. Fillova punë si magazinier në Zall-Dardhë. Për fat asnjë dëmtim, asnjë deficit, asnjë suficit gjatë gjithë kohës që punova.

Nisur nga përvoja dhe pastërtia e ndërgjegjja ime, kohët e fundit më emëruan në një nga magazinat qendrore të vendit, në Milot. Aty shkarkohej nga treni i gjithë gruri që importohej dhe shpërndahej në të gjithë vendin. Koha që shumë e vështirë. Rrëmuat kishin filluar. Tranzicioni qe shumë i brishtë. Veçanërisht Miloti kishte rrëmujën më të madhe. Punova me kokë në strajcë. Shpesh më kërcënuan në forma të ndryshme, më provokuan me llojlloj mënyrash, më bënë edhe shumë oferta për të bashkëpunuar e për të zhvilluar korrupsionin.

Nuk mundesha, të bëja dallavere e ta zizoja faqen në prag të daljes në pension. Realisht ai vend ishte një vend pëllumbash, siç e përdorim nga anët tona që të bënte me para e me shtëpi. Jo i thashë vetes. Nuk njollosët Shaban Dervishi, edhe sikur të



më japin Shqipërinë dhe gjithë pasurinë e botës!

Qëndrova në hallin e punën time, por ky qëndrim nuk u erdhi mirë atyre që ishin të lidhur me krimin, me pushtetarë e titullarë të korruptuar. Edhe këtu u munduan të më bëjnë gjëmën. Më bënë një mijë akuza në hetuesi. U përballa me hetues e krye-hetues, por isha në të drejtën time, nuk u theva, nuk pranova asgjë, argumentova me dokumenta gjithçka dhe i shpëtova për mrekulli burgut. Singërisht, i kënaqur e i fituar nga kjo betejë në fund të jetës sime, dola në pension pleqërie. U vendosa me banim në Tiranë dhe po mendoja për ta kaluar këtë pjesë të jetës me rehati e shije.

Pyetje: Edhe tani nuk bëni një jetë të mbyllur. Kemi mësuar se drejtoni një shoqatë joqeveritare çfarë mund të na thonë për detyrën dhe shoqatën që drejtoni?

Përgjigje: Merrem me Shoqatën “Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë”. Ajo është një nga shoqatat më të vjetra dhe më serioze në Shqipëri. Unë aderoj në këtë shoqatë për më shumë se 10 vjet. E kam filluar anëtarësimin kur kryetar i saj ishte Prof. Hasan Banja, vazhdova me publicistin e dëgjuar Bektash Zite dhe pas vdekjes së tij më zgjodhën si kryetar të përgjithshëm, pasi unë kisha qenë kryetar i komisionit të Revizionimit dhe prej disa vitesh sekretar i Përgjithshëm.

Përipiqem të jap maksimumin tim në rritjen e rolit dhe veprimtarisë së shoqatës. Kemi një unitet mendimi

e veprimi. Kemi organizuar një larmi veprimtarish si dhe jemi përpjekur e do të punojmë të bashkëpunojmë ngushtë me Ministrinë e Punës dhe të Shëndetësisë për hartimin dhe miratimin e statusit të pensionistit. Shoqata jonë përfshin gjysmë milioni pensionistë dhe 82000 vetëm në Tiranë. Kjo shoqatë është anëtare e Unionit Ballkanik me qendër në Sofje. Ajo ka strukturën e saj, seksionet, nëndegët e degët.

Gjejë rastin të falënderoj për punë të mirë degën e Tiranës me kryetar Enver Hasën, të Fierit që drejtohet nga z. Ramiz Basha, të Lacit me kryetar dhe sekretar Dilaver Hoxhën e Maliq Kolecin. Nuk mund të lë pa përmendur e falënderuar kolegët e mi, nënkryetarët e përgjithshëm: Halil Robin, Velecie Osmanin, Ramiz Bashën, sekretarin e përgjithshëm Faik Khanin, anëtarët e kryesisë, prof. Dr. Zihni Haskaj, Nonda Buxhukun, Seit Milën, Hyda Alipajn, Misim Premçin, Tofik Subashin, miqtë tanë Reshat Bardhin, Alban Yllin, Miftar Fana, po edhe publicistë e gazetarë, z. Fatime Kulli, Mevlud Buci, Ramazan Illicën, Dukagjin Hatën, Servet Tartarin, Sefer Dukën në Burrel, Qamil Xhetanin etj që bashkëpunojnë ngushtë me ne dhe kanë bërë një punë të lavdërueshme në pasqyrimin e punës dhe aktivitetit të shoqatës “BPPSH”.

Singërisht, ndihem mirë midis këtyre njerëzve të mrekullueshëm dhe nuk do të kursej asgjë për mbrojtjen e interesave të Moshës së Tretë, deri në minutën e fundit të jetës time.

Bisedoi: **FAIK KHANI**

NJOFTIM

Gazetari dhe poeti i mirënjohur dibran, Mentor Hoxha, autor i 7 librave dhe qindra artikujve në shtypin e përditshëm, gazetar dhe kryeredaktor ne disa gazeta dhe revista të njohura, po përgatit librin për zonën e Fushë-Alies dhe të Çidhnës. Cilido që është i interesuar për të kontribuar financiarisht dhe me materiale për figurat e këtyre zonave mund të kontaktojë në:

<mentor_hoxha39@hotmail.com> ose në <personazhevip@yahoo.com>.

Çdo kontribut i juaji do të shënohet në këtë libër, i cili do të shërbejë si një urë komunikimi mes brezave.

Redaksia

Nga: MA TEFTA NUREDINI*

Kohët e fundit ka dalë nga shtypi libri universitar “Gjuhësi teksti” i hartuar nga prof.as.dr. Tefë Topalli. Autori është lector i Sintaksës në Universitetin e Shkodrës, Tiranës dhe prej vitesh jep leksione të kësaj discipline në Fakultetin e Mësuesisë të Universitetit të Podgoricës, si dhe ka qenë pedagog i jashtëm në Katedrën e Albanologjisë të Universitetit të Beogradit. Për hartuesin nuk është një eksperiencë e re botimi i këtij libri, pasi ai është autor i mjaft librave, përmendim këtu, librin universitar “Gramatika nëpërmjet tekstit”, dy vëllimet voluminoze “Kërkime gjuhësore”, monografinë “Histori e gjuhës së shkruar” si bashkëautor si dhe një sërë studimesh në buletine të ndryshme shkencore,

“Gjuhësi teksti” është i katërti i këtij lloji në lëmë të gjuhësisë shqiptare. Ai vjen pas tri botimeve, përkatësisht “Gjuhësi teksti” –Klodeta Dibra & Nonda Varfi 1999, “Gjuhësia e tekstit”- Hasan Muja 2004 (Kosovë) dhe “Koherenca tekstore” – Arbër Çeliku 2005 (Maqedoni). Libri nuk është vetëm një tekst alternative – krahasuar me tri botimet pararendëse – por edhe një tekst me prurje bashkëkohore dhe profile të reja në shume segmente të saj, të përshtatshme dhe të asimilueshme për studentët e degës së gjuhësisë dhe gazetarisë. Këto të fundit kanë mundësi që njohuritë mbi tekstin si kategori ligjërimore t’i marrin duke i vënë edhe në nivel krahasues me trajtesat e bëra edhe me studiues të shkollave të ndryshme: anglo-saksone, gjermanike dhe latine, duke u ndalur te emra të njohur të kësaj fushe.

Pa frikë mund të themi, se mënyra interesante e strukturimit, përmbajtja shkencore dhe e qartë e librit janë gërshtatshme dhe të asimilueshme për studentët e degës së gjuhësisë dhe gazetarisë. Këto të fundit kanë mundësi që njohuritë mbi tekstin si kategori ligjërimore t’i marrin duke i vënë edhe në nivel krahasues me trajtesat e bëra edhe me studiues të shkollave të ndryshme: anglo-saksone, gjermanike dhe latine, duke u ndalur te emra të njohur të kësaj fushe.

Hartimi i librave të tillë, është një angazhim, e njëkohësisht edhe një guxim shkencor, që kërkon jo vetëm një përgatitje shkencore dhe përkushtim, gjë që nuk i mungon hartuesit, por edhe një përvojë jo të shkurtër mësimdhënieje në universitete, eksperiencë të cilën ai e ka ushtruar qoftë në universitetet brenda kufijve shqiptar, qoftë edhe në ato jashtë tyre.

Libri nis me hyrjen. Autori ia ka besuar vetvetes atë dhe shkurtimisht na njeh me vijën historike të kësaj discipline nga studiues shqiptar (më

“Gjuhësi Teksti”, një vepër me vlera në fushë të Linguistikës

Hartimi i librave të tillë, është një angazhim, e njëkohësisht edhe një guxim shkencor, që kërkon jo vetëm një përgatitje shkencore dhe përkushtim, gjë që nuk i mungon hartuesit, por edhe një përvojë jo të shkurtër mësimdhënieje në universitete, eksperiencë të cilën ai e ka ushtruar qoftë në universitetet brenda kufijve shqiptar, qoftë edhe në ato jashtë tyre.

gjërë paraqitet në kapitullin e parë) dhe me tej me një paraqitje sintetike shfaq konceptet bazë të kësaj discipline të re në lëmë të linguistikës, që në kapitujt në vazhdim do t’i trajtojë në mënyrë të imtësishme. Në mbyllje të hyrjes hulumtuesi me modesti falenderon individët që e kanë ndihmuar për realizimin e kësaj vepre.

I ngajshëm me tekstet e tjera universitare edhe ky tekst kapitullin e parë i’a kushton objektit të disiplinës që trajtohet, në rastin konkret, përkatësisht “Gjuhësia e tekstit” si dhe lidhjes së saj me disiplinat e tjera gjuhësore e jashtëgjuhësore. Më tepër këtu i mësohet përkufizimit të tekstit të bërë nga studiues të shkollave të ndryshme. Po ashtu theksohet edhe lidhja e veçantë e kësaj discipline veçanërisht me *Stilistikën*, që jepet në këtë paragraph të cituar nga autori: “*Të gjitha studimet në fushën e stilistikës mbrojnë idenë se stili është rezultat i “një zgjedhje” tipike të mjeteve që ofron gjuha për të krijuar një tekst apo një tërësi tekstesh.*”

Kapitulli i dytë trajton *Aktin e komunikimit*, kjo për arsyen e thjeshtë, se studiuesi ka për qëllim t’i sqarojë lexuesit të tij konceptet bazë të kësaj discipline të re. Duke qenë se, object i “Gjuhësisë së tekstit” është **teksti** dhe vetë ky i fundit është “*njësi themelore e veprimtarisë komunikative njerëzore*”, atëherë përballemi me tri gjëra: emetuesin (dhënësin), mesazhin dhe marrësin, përndryshe me komunikimin. Topalli jep këndvështrimin e tij lidhur qoftë me *komunikimin* si kalim i qëllimshëm i informacioneve nëpërmjet shenjave, qoftë me *aktin e komunikimit* i cili është përherë një formë shkëmbimi dhe realizohet përmes gjashtë elementeve (dhënësi, marrësi, mesazhi, referenti, kodi, kanali).

Për secilin element të aktit komunikativ autori jep edhe funksionin gjuhësor përkatës. Qartësisht në këtë vepër jepen edhe llojet e komunikimit përkatësisht: komunikimi pa fjalë, me gjeste dhe qëndrime, me pamje si dhe komunikimi i përzier.

Teksti gjuhësor i përfshirë në kren e tretë zë pothuaj një të tretën e librit, gjë e cila flet qartë për rëndësinë e kushtuar nga ana e hartuesit kësaj çështje. Ai na njeh me përkufizime të ndryshme për tekstin, të dhënë këto nga studiues të huaj dhe shqiptar, për të ardhur te përcaktimi i tij vetjak: “*Tekstet janë prodhime gjuhësore me gojë ose me shkrim, të pajisur me kuptim të plotë, bërë nga një transmetues dhe të marrë nga një marrës, në një situatë të caktuar, me qëllimin dhe efektin e komunikimit.*”

Duke u ndalur te koncepti i tekstit, përveç dhënies së dy veçorive esenciale të domosdoshme në ndërtimin e një teksti gjuhësor, pikërisht *mesazhit* dhe *përshtatjes së një situatë të caktuar komunikative*, hulumtuesi, mbështetur edhe te gjuhëtarët pararendës, na prezanton edhe shtatë kërkesat që duhet të kemi parasysh në ndërtimin e një teksti, përkatësisht: *kohezioni/ koherenca/ qëllimi/ pranueshmëria/ informimi/ situata/ intertekstualiteti*, si dhe me rregullat e thurjes së tij: *efiçenca, efektiviteti dhe përshtatshmëria*. Të gjitha këto kërkesa dhe rregulla nuk jepen përceptas (në mënyrë sipërfaqësore), por ato trajtohen në mënyrë të thelluar, bie fjala, kohezioni paraqitet me te gjithë elementet e tij: *rikthimi, zëvendësimi, riformulimi e elizioni*; apo koherenca na prezantohet me tërë nivelet e saj: *tematik, logjik, semantic e stilistik*. Duhet të theksojmë, se gjuhëtari ynë është mbështetur në një gamë të gjërë studimesh e trajtesash të bëra nga gjuhëtarë të shkollave të ndryshme, veçojmë ato gjermane e neolatine, sa i takon kësaj fushe, por theksojmë se ai ka ditur të ruajë një raport të drejtë me masën teorike, krahas karakterit praktik të librit. Vëmë në dukje, se të gjitha këto njohuri ilustrohen me pasazhe të shkëputura nga letërsia (kryesisht nga M. Camaj e I. Kadare) dhe publicistika, por edhe nga stile e ligjërime të tjera. Ajo që mund ta quajmë risi të këtij libri është edhe ana grafike e tij, e cila ka një efekt të padiskutueshëm te lexuesi, për një qëndrueshmëri afatgjatë të njohurive.

Natyrsh, që hapësirën më të gjërë në këtë vepër, prof. Topalli i’a ka lënë tipologjisë së teksteve, e cila del i plotë në kapitullin e katërt. Fillimisht jepen kriteret e e klasifikimit të teksteve (*tipi i komunikimit/ marrësi i mundshëm/ zgjedhjet gjuhë-*

sore), për të cilat studiuesi ka patur si pikë referimi linguistin gjerman Egon Eierlich, i cili dalloj pesë grupe të teksteve gjuhësore (teksti *deskriptiv, informativ, argumentues, narrativ, rregullues* ose siç njihet në tekstet shkollare *udhëzues*), pa përfshirë tekstin *poetic*, i cili shtohet prej J. Michel Adam. Ekzistenca e tekstit poetic argumentohet prej tij me ekzistencën e gjashtë funksioneve të gjuhës, një prej të cilëve është edhe ai poetic, që natyrshëm i rezervon një ndarje tekstuale edhe tekstit në fjalë. Është mjaft interesant fakti, që hulumtuesi në trajtimin që u bën gjashtë tipeve të tekstit, jo vetëm e njeh lexuesin me veçoritë e secilit prej tyre, por zgjedhja dhe përshtatja e shembujve është e goditur, e padyshim e ndihmon marrësin në përthithjen e asaj që i ofrohet.

Siç thamë më lart, të gjitha llojet e teksteve trajtohen me të gjithë specifikën e tyre dhe jepen shëmbëllizimet përkatëse, por për vetë dendurinë e përdorimit dhe veçantinë e ndërtimit të tij në krahasim me tipat e tjerë tekstorë, *tekstit narrativ* i është rezervuar vendi kryesor. Krahas përkufizimit tradicional të tekstit narrativ si *tekst i shkruar a gojor, nëpërmjet të cilit një narrator tregon një histori*, studiuesi konceptin e tij e sheh më gjërë, duke përfshirë në të edhe një cikël afreskësh, një legjendë (fjala vjen si ajo e Shën Gjergjit që mposht djallin), një kompozim muzikor a koreografia e një baleti. Strukturi i qendër të librit është krijuar mundësinë e njohjes së nocionit të sekuencave, të cilat ndërtojnë unitetin narrativ të tregimit, si dhe tipave të tyre. Trajtimi i bërë në masën e duhur si i *kohës narrative* ashtu edhe i *narratorit*, është tregues i shkallës së lartë të formimit të T. Topallit, jo vetëm nga ana shkencore, por edhe metodike. Studentit në veçanti dhe lexuesit në përgjithësi i ofrohen njohuri mbi tekstin narrativ i cili dimensionohet jo vetëm në hapësirë, por edhe në kohë. Operacionet e ndryshme me kohën narrative, informacioni që mirret për klasifikimin e narratorëve, shëmbëllizimet mjaft të gjetura për secilin rast, bëjnë të mundur formimin e plotë të tyre në këtë fushë, e sidomos i ndihmon ato në analizën e teksteve letrare e publicistike, ku paraqiten edhe vështirësitë më të mëdha tek të gjithë kategoritë e lexuesve.

Vend jo pak të rëndësishëm, studiuesi i lë edhe tekstit poetic të përfshirë në kapitullin e katërt, e kjo për faktin se siç nënvizon edhe K. Dibra-N.Varfi, *tipologjia e klasifikimit të teksteve në literaturën gjuhësore ka pasur si pikënisje klasifikimin e shkollës gjermane të përfaqësuar nga W. Werlich, Gulisch & Raible, W.*

Dressler, të cilët nuk e përfshijnë tekstin poetic. Ky i fundit, siç u përmend më sipër, u pranua më vonë si i tillë nga J. Michel Adam, çka do të thotë, se qe një fushë e hapur studiimi për gjuhëtarët, gjithmonë në lëmë të kësaj discipline. Trajtimi në mënyrë të detajuar i këtij teksti dhe vendi që ai zë në këtë vepër, flet qartë për rëndësinë që i ka kushtuar studiuesi tekstit në fjalë në lëmë të tipologjisë tekstore. Ai thekson, se mund të flitet për poezi, jo vetëm për “*Iliadën*”, “*Komedinë Hyjnore*”, “*Këngët e Petrarkës*”, por edhe për “*Vuajtje e djaloshtit Eëter*”, “*Sinfoninë e Bethovenit*” a për një perëndim dielli të zjarrtë.

Paraqitja e koncepteve si: *aluzionet foniko-timbrike të tekstit poetic, domethënia horizontale dhe pingule, shndërrimi i tekstit, bashkimi i domethënieve* etj., në këtë kapitull, janë një ndihmesë e formimit të studentëve në këtë disiplinë. Ajo çka do të theksoja, si vlerë të këtij libri janë edhe analizat e teksteve të ndryshme poetike të bëra nga autori, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për studentin i cili shumë shpejt do të kalojë në stadin e mësimdhëniesit e modele të tilla do të jenë me të vërtetë një ndihmesë e padiskutueshme. Në këtë kre autori ka trajtuar edhe tekstin dialogjik, duke na dhënë njohuri të reja të pacikura më parë. Kështu, me tekstin në fjalë duket sikur studentët formohen plotësisht me njohuritë mbi tipologjinë e teksteve.

Kapitulli i pestë dhe i fundit, si rifocim i gjithë librit i dedikohet *paratekstit* i cili siç thotë vetë studiuesi “*është pragu që duhet përshkuar për të hyrë e për të dalë në tekst*”, thënë ndryshe, në të përfshihen: emri i autorit, titulli i librit, nëntitujt, citimet, parathënia, përfundimet, bibliografia etj.

Së fundmi, mund të themi se libri në fjalë është një arritje në fondin e librave universitar. Gjithashtu, mendojmë, se ky teksti do të plotësojë një nevojë praktike e teorike të kësaj discipline. Nga ana tjetër, shpreh bindjen se libra si këto, renditen ndër tekstet më me vlera në lëmë të gjuhësisë, si për informacionin e ri ashtu edhe për argumentet bindëse. Vepra “Gjuhësi teksti” me një gjuhë të pasur me mjete shprehëse, stil të veçantë dhe sintaksë të arrirë është një hap përpara në fushë të linguistikës, pasi ai plotëson njohuritë mbi aktin e komunikimit, tipologjinë e teksteve e koncepte të tjera që lidhen me tekstin. E uroj autorin për librin dhe dëshiroj që vepra të tjera kaq me vlerë të na dhurojë në të ardhmen.

* Autorja është Master Shkencor në Gjuhësi. Ajo punon si mësuese e Letërsisë në gjimnazin “Sait Najdeni”, Peshkopi.

“Sot asht’ dita kur i vdekun mbetesh i pavdekshëm”

Nga: **Dionis XHAFA**


Dibra e Luma, fortesa që s’iu tremb Ser bisë. Fokusimi në luftën ndaj “shkjaut” të dibranëve dhe terrori serb mbikëto krahina e më gjerë në vitin e zi për mbarë shqiptarinë, 1913-të. Një panoramë mbi trojet e sotme shqiptare në Maqedoni.

Në fillim të shtatorit të vitit 1913-të, fill pas smbrapsjes së ushtrive turke nga trojet dibrane e më gjerë, në zonat veriore, e më së tepërmi në pellgun e luginës së Drinit të Zi zbriti komanda serbe. Menjëherë filloi represioni i paparë serb, mbi 60 persona nga paria e Dibrës së Madhe u burgosën. Çdo dibran që gjendej në qytetet përreth Dibrës, në Gostivar, Kumanovë, Kërçovë, Tetovë, Ohër e Strugë u vra dhe shumë nga këta u torturuan. Në krye të ushtrisë serbe qëndronte Nikolla Pashiç, post që i ishte caktuar nga Johan Vaslijeviç, një shovenist e tiran që gjithçka e kishte kthyer në anarki. Pushteti serb, në zonat e Pollogut as që egzistonte dhe “lutjet” për respektimin e ligjeve serbe as që përfilleshin nga ana e shqiptarëve¹.

E, në kesi rrethanash, krerët e Dibrës u mbledhën në fshatin Arras të Peshkopisë, mbledhje e bërë pa asnjë këshillim me Qeverinë e kohës. Në këtë mbledhje, përveç tjerëve, morrën pjesë dibranët të arratisur e të paarratisur, si: nënkolonel Ramiz Dibra, Elez Isufi, Ramiz Daci, Dine Dema, Dine Hoxha, Izet e Dine Maqellara, Selim Noka, Dervish Lusha etj. Këtu u bisedua ndërmarrja e një aksioni kundër Jugosllavisë. Qëllimi kryesor ishte çlirimi së paku i Dibrës shqiptare dhe se do luftohej deri në pikë të fundit të gjakut për këtë qëllim. Mirëpo, lufta për mbrojtjen e Dibrës nuk kishte përkrahjen e Qeverisë së Tiranës, ashtu si lufta e Vlorës. U vendos data e Kryengritjes, koordinimi i forcave dhe Komandant i Përgjithshëm u zgjodh Elez Isufi. Dine Hoxha, përmes një letre dërguar komandantit jugosllav, iu drejtua për heqjen dorë nga Dibra shqiptare, por përgjigja ishte negative. Dibranët u bënë gati për luftë. Kuvendi i zhvilluar në Arras, me parinë e Dibrës dhe 800 burrave i dërgoi një letër mesazhi në formë ultimatumit gjeneralit serb: “Do lini kokën në trojet tona!”². Një ndër krerët e Dibrës, ndër të tjera u tha mbanë dibranëve: “Sot asht’ dita kur i vdekur ngelesh i pavdekshëm!”²

Serbët nga ana tjetër, me mbështetje të fuqishme nga aleati i saj rus, një ditë pas fillimit të sulmit të tyre, kishin planifikuar intensifikim të sulmeve në dy drejtime. I pari, që nga Gjakova, Qafa e Prushit, Qafa e Malit, Puka dhe për të mbërritur në Lezhë dhe i dyti fillonte që nga Prizreni, Kukësi, Mirdita, Lezha e për të mbërritur në Durrës për të plotësuar ëndrrën serbe për të patur shtrirje në det. Të nesërmen, më datë 9 nëntor e 10 nëntor, forcat e armatosura serbe gjetën pengesën dibrane e lumjane. Në kulmin e betejës, në Lumë, ku po zhvilloheshin beteja të përgjakshme arrin Elez Isufi. Ushtria serbe u dorëzua, humbi plot ushtarë e municione, u thye ushtria e xhandaria serbe. Luftime të përgjakshme, gati kasaphanë u zhvilluan në “vijën strategjike”, sot kufiri mes rrethit Dibër dhe Maqedonisë. Humbje pati nga të dyja palët, sidomos në popullin e varfër dibran, ku u plaçkitën, u dogjën dhe u shkrumbuan shtëpi e katandi por me rëndësi ishte thyerja dhe kthyerja mbrapsht e ushtrisë serbe. Dibra e Vogël, siç njihet sot, u çlirua. Elez Isufi, kryekomandanti dibran, çliroi Peshkopinë, qytetin e Dibrës, Ohrin, Strugën, Gostivarin dhe Tetovën. Ai u bë tmerri i serbëve, aq sa kishte filluar të quhej “arusha e maleve”³.

Mirëpo Serbia nuk do t’ia falte lehtë këtë qëndresë Dibrës. Edhe pse sulmi i parë i ser-



“Oxhaku përballë furtunës”. S.Bocku

bëve u thye, forca të reja të shumëfishta hynë në luftime. Kryengritësit u tërhoqën. Serbia u fut në kërbizë të Shqipërisë dhe arriti që përkohësisht të siguronte edhe dalje në det. Elez Isufi nuk i lëshoi aspak armët, por qëndronte maleve. Serbët kapën familjen e tij peng, në mënyrë që Elez Isufi të vetëdorëzohej ose përdryshe familja e tij do të masakrohej. Dy oficerë arritën në shtëpinë e “kryetrimt dibran” dhe i dhanë ultimatum për t’u vetëdorëzuar. Mirëpo, Elez Isufi i dehu dy oficerët, mori familjen dhe u arratis nëpër male. Elez Isufi u plagos rëndë dhe pas dy javësh vdiq në ngjarjet e qershorit 1924, ku kundërshtoi hapur kthimin në pushtet të Ahmet Zogut, i cili po kthehej nga Serbia për të hyrë në Shqipëri nga Dibra e Madhe.⁴

Masakrat serbe në Dibër janë nga më të tmerrshmet në histori të Ballkanit, e sidomos pas kësaj rezistence, ushtria serbe ishte egërsuar së tepërmi. Konkretisht, po citoj me qytetin dhe fakte rrëqethëse:

Në Dibër (qyteti), është dhënë urdhër për ekzekutimin e 18-të udhëheqësve të qytetit. Por, vetëm 3 prej tyre janë ekzekutuar, pasi kanë ndërhyrë dibranët e tjerë të qytetit. Serbët grabitën krejt qytetin dhe morrën mbi një milion lira turke. Shumë shtëpi u dogjën. Masakruan shumë të tjerë që nuk kishin lidhje me kryengritjen. Qyteti në çastet e dorëzimit është shkretuar komplet. Njerëzit kanë ikur nëpër male dhe brenda në qytet gjendeshin jo më shumë se 200 persona.

Në gjithë krahinën e Dibrës janë masakruar afërsisht 1.000 persona, mes të cilëve burra, gra, pleq, madje dhe fëmijë. Vrasjet më të rëndomta kanë qenë ata me bajoneta, ku shumë persona therreshin në fyt. Pasi digjinin e plaçkisnin fshatrat, ndërsa digjeshin shtëpitë, në zjarr hidhnin përgjithësisht fëmijë nën moshën 12 vjeç dhe gra. Shumë gra dhe burra janë vrarë në prani të fëmijëve të tyre dhe e anasjellta.

Krimet serbe në Dibër e më gjerë i ka parë për së afërmi edhe shkrimtari Haki Stërmilli. Ai për masakrat serbe në Dibër (shtator-tetor

1913), shkruan: “Në qytet, tabakhaneja, që ishte thertore bagëtish, u bë thertore njerëzish. Qytetit i vinte erë gjak njeriu, kudo mbretëronte pasiguria dhe një heshtje tmerri. Përveç tabakhaneve edhe në qytet brenda, ndër postat e gjindarmërisë kishte nga një burg, ku mjaftonte vetëm urdhëri i postkomandantit ose dëshira e ndonjë xhindarmi që të njomeshin mirë muret e atij burgu me gjak shqiptarësh të pafajshëm.”

Dibra e Shqipërisë nuk u morr nga shovinistët serb, por gjaku për të u derdh lumë. Serbët mbledhën “leakat” nga Dibra dhe u larguan përgjithmonë. Mirëpo dibranët lanë një gjysmë zemre jashtë trupit të tyre. Por, nderi, besa dhe patriotizmi dibran shkuan në vend. Sot, populli i këndon këngë nga më të ndryshmet, si:

....”mos na shtie ne ma ngushte,
sepe ndryshe kemi pushke.
kemi pushke jo besa pak,
S’shkelen malet jo pa gjak”.
“T” na shkoje zani ne shtate krala
ne shtate krala ne ballkan
Luftë po bejne trimat per vatan”.
‘Bini djem kush do me vdek,
trojet tona kush ska me na i prek’.....⁶

Por gjithkush besoj do ishte kurioz të pyeste: Si paraqitet situata sot në Maqedoninë Perendimore? Sot popullsia shqiptare në Republikën e Maqedonisë është shtuar në mënyrë progresive. Kështu, nga 19 % e popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë, në vitin 2002, kur dhe është kryer regjistrimi i fundit i popullsisë me përbërje etnike, shqiptarët përbënin 25,2 % të popullsisë së përgjithshme. Etnologët vlerësojnë se në Maqedoni sot ka më tepër se 500.000 njerëz që flasin gjuhën shqipe. Nga ana tjetër, maqedonsit këmbëngulin se shqiptarët nuk përbëjnë më tepër sesa 20 % të popullsisë së Republikës. Shqiptarët, siç dihet janë të përqendruar kryesisht në Maqedoninë Perendimore, ku qytetet kryesore me përqindje më të lartë të popullsisë etnike

shqiptare janë: Tetova (70%), Gostivari (65%), Dibra (65%), Struga (52%), Kërçova (55%), Shkupi (35%) dhe Kumanova (28%).⁷

Shqiptarët në trojet shqiptare të Maqedonisë kurrë nuk u dorëzuan, gjithnjë kërkuan të drejtat e tyre, që nga krijimi i shtetit maqedonmë 1991. Mëvetësimi i Maqedonisë nga Jugosllavia formoi parti politike, që në vend të një karakteri ideologjik, vinin në pah karakterin etnik. Si rezultat i këtij tranzicioni, papunësia ishte në shifra alarmante, marrëdhëniet ndëretnike ishin tepër të keqësuar dhe korrupsioni ishte në nivele të larta. Shqiptarët i humbën të drejtat e tyre në Kushtetutën e vitit 1991, pas miratimit të kësaj Kushtetute vetëm nga ana e deputetëve maqedonas, pasi deputetët shqiptarë e braktisën në parlament miratimin e një kushtetute të tillë.

Vitet 2000, për shkak edhe të ashpërsisë mes dy etnive kryesore, asaj shqiptare dhe maqedonase karakterizoheshin nga papunësi në shifra rekord dhe qeveria udhëhiqej nga një parti në thelb nacionaliste. Punësimi i shqiptarëve ishte në proporcion të zhduar me numrin e tyre të përgjithshëm. Shkaku kryesor i rebelimit të shqiptarëve ishin të drejtat e cunguar të shprehura në Kushtetutë, sipas së cilës, gjuha shqipe u kufizua, pamundësia për përdorimin e simboleve etnike dhe u kërkua punësimi në administratë në proporcion me popullsinë. Sipas opinionit maqedonas, shkaku real i një kryengritje të tillë, ka qenë krijimi i një Shqipërie të Madhe. Zyrtarisht, ky konflikt u zhvillua mes UÇK (Ushtria Çlirimtare Kombëtare) dhe Forcave të Sigurimit Maqedonase.⁸

Në këto rrethana që sipërpërmendëm, në shkurt 2001, në fshatin Tanush, në Mal të Zi të Shkupit, filloi konflikti sllavo-shqiptar. Avionë ushtarakë fluturonin në qiejt e Lipkovës dhe Kumanovës, Shkupit e Tetovës. Përgjatë këtij konflikti, UÇK-ja, sulmonte forcat e sigurimit të Maqedonisë, mobilizoi për ekspedita ushtarake një pjesë të mirë të popullsisë. Nga ana tjetër e medaljes, forcat e Sigurimit të ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë përgatitën prita për ushtarët e UÇK-së, sulmonin popullsinë civile dhe sidomos ata persona që dyshoheshin për bashkëpunim me UÇK-në. Si pasojë, u shkaktuan viktima dhe dëme të mëdha materiale, si: objekte kulti, fetare, kulturore e historike.

Sot e kësaj dite shqiptarët kërkojnë me ngulm që historia e popullit shqiptar në Maqedoni të shkruhet pa devijime, ashtu siç ndodh me historinë që mësohet aktualisht nëpër shkollat maqedonase. Kanë qenë jo të pakta “gabimet trashanike” dhe që kanë shkaktuar polemika nga më të ashprat në këtë shtet. Si përfundim, edhe sot, afro një shekull më vonë pushtimit të egër serb, vazhdon “qëndresa” dhe haset një mospërzjerje mes etnisë maqedonase dhe asaj shqiptare. Gjurmët e kësaj “ndarje” mes dy etnive janë shkruar me gjak në fletët e historisë.⁹

Literatura:

- ¹ Lufta e shqiptarëve të Maqedonisë, prof. doc. Vebi Xhemali.
- ² Dine Hoxha në krye të 13 mijë luftëtarve, Forumi Shqiptar.
- ³ 85 vjet nga vdekja e Elez Isufit, Dalip Greca, Gazeta “Dielli.”
- ⁴ Lufta e shqiptarëve përballë ushtrisë serbe, Halil Rama, Shqipëria / Shekulli.
- ⁵ Corriere della Puglia, Bari XXVI, 354, 21 dhjetor 1913, perkthyr nga Gezim Aliu.
- ⁶ Kuvendet e Dibrës, Fatos Daci.
- ⁷ Shqiptarët në Republikën e Maqedonisë.
- ⁸ Lufta në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë më 2001.
- ⁹ Shqiptarët në Maqedoni e duan luftën e 2001-shtit në librat e historisë, ShqipMedia, 14 gusht 2010.

opinione

Ataku serb ndaj femrës shqiptare

Nga: **Rexhep TORTE**

Para syve tanë po ndodh një ofansivë jo e rastësishme e meshkujve serbë nga Serbia që martohen me femra shqiptare nga Shqipëria. Kjo dukuri është e paramenduar dhe e studjuar mirë nga politika dhe qarqet nacionaliste serbe.

Gazeta "Faki" është i vetmi medium shqip që për këtë dukuri e informoi me kohë opinionin dhe sensibilizoi për këtë rrezikshmëri të pranishme.

Redaksia e "Faktit" para sa vitesh dërgoi në Zonën e Shkodrës ekipin e gazetarëve, i cili gati një muaj rrjesht mbushte faqet e gazetës me reportazhet trishtuese e sensibilizuese të martesave të vajzave shqiptare të mbishkodrës me serbë të Serbisë. Repotazet në "Fakti" treguan se ishte krijuar një makineri emisarësh shqiptarë, të cilët për një shumë parashë që merrnin nga serbët e Serbisë propagandonin, rekrutinin dhe mashtronin vajzat shqiptare të martohen me serbë nga Serbia. Për fat të keq kjo dukuri nuk e shqetsoi fare Shtetin shqiptar për të ndërmarë diçka për pengimin e saj. Kjo dukuri është duke vazhduar edhe sot e kësaj dite nëpërmjet shfrytëzimit të gjendjes vështirë materiale dhe mosinformimit sa duhet të familjeve shqiptare lidhur me këtë dukuri të imponuar.

Mentaliteti shqiptar me atë serb nuk ka asgjë të përbashkët. Këto femra shqiptare të mashtruara e të martuara për serbët në Serbi, shumë shpejt e kanë kuptuar se martesa e tyre në Serbi s'është gjë tjetër veçse një qyp plot me mut i mbuluar sipër me një shtresë të hollë mjalti, ose siç thotë populli "deri i egër e han mollën e butë".

Njohesit e mirë të gjendjes së femrave në Serbi, e kanë të qartë se Serbia ka mjaft femra serbe për meshkujt serbë. Por një gjë është e qartë, siç ka shkruar edhe shtypi serb, se femrat serbe të lindura në fshatra migrojnë në vazhdimësi në qytetet serbe për një jetë më të mirë, dhe më mirë rinë pa u martuar fare në qytet, sesa të martohen me fshatarë serbë për të punuar tokën e për të jetuar në fshat. Të gjendur në një situatë të këfillë, të rinjtë serbë, por edhe të moshuarit serbë që jetojnë në fshatra, i kanë drejtuar sytë e shpresat drejt Shqipërisë, ku ende shërohen plagët nga rregjimi diktatorial gjysëm shekullor komunist. Kujdesi i pamjaftueshëm i Shtetit shqiptar për femrat shqiptare, ndikoi edhe në rritjen e kontrabandimit dhe mashtrimin të femrave shqiptare drejt metropoleve të perëndimit me qëllim prostitucionin, gjë që nuk ka qenë kur në natyrën shqiptare më parë.

Serbët nuk janë fare naivë. Ata u janë drejtuar femrave shqiptare, sepse ato janë të mençura, të shkolluara, të vyera dhe të edukuara, përkundër meshkujve injorantë serbë që jetojnë e punojnë në fshat, e që menynë kryesore e kanë rakinë dhe mishin e tymosur, sllaninën serbe.

Edhe në sistemin monist në republikat e ish Jugosllvisë kishte martesa të përziera etnikisht. Por më shumë mes serbëve dhe femrave boshjake apo sllovene, të joshura më shumë nga uniformat ushtarake apo funksionet e privileguara. Ndërkaq nuk mund as të mendohej që ndonjë femër shqiptare të martohet me serbë. Kishte edhe ndonjë rast të rallë martese të meshkujve shqiptarë me femra serbe, por të disajnuara nga siguri operativ serb për t'i patur në kontroll këta meshkuj shqiptarë.

Lufta e fundit në Bonjë dëshmoi marrëzinë e çifteve të përziera boshnjako-serbe.

Ekzistojnë dokumente të shkruara historike serbe se gjatë sundimit otoman në Ballkan, femrat serbe edhe të klerikëve mbretërore serbe, gjenin mundësinë që të argëtohen fshehurazi me pashallarët turq, që u dukeshin më të pastër dhe më të bukur. Ekzistojnë gjithashtu dokumente të shkruara se turqit që kishin okupuar Zemunin, kalonin me varka në pjesën tjetër të lumit që ishte nën Autro-Hungarinë, për të takuar vajzat serbe të cilat i mashtronin dhe dërgonin nëpër haremet e Stambollit.

Masakrat serbe ndaj shqiptarëve kanë kronologjinë e vet historike. Lufta e gjenocidit serb ndaj shqiptarëve, dhunimi i femrave shqiptare në Kosovë në vitin 1999, dhe vazhdimi i politikës negative serbe edhe pas Pavëarësisë së Kosovës, flet qartë se truri serb ende nuk është pastruar nga sindromi antishqiptar.

Gatishmëria e politikanëve serbë për të lejuar martesat e serbëve nga Serbia me vajzat shqiptare nga Shqipëria, ka për qëllim që t'i mbushin krevatët me femrat shqiptare, t'i shfrytëzojnë vetëm si inkubator riprodhues, denigrues, ofendues e asimilues dhe asgjë tjetër.

Lidhur me këtë fenomen serb që atakon femrat shqiptare në Shqipëri, urgjentisht dhe detyrimisht duhet të angazhohet me seriozitetin më të madh Shteti shqiptar, sëbashku me sociologët, filozofët, drejtësinë e politikën shqiptare, si edhe me asociacionet joqeveritare duke përfshirë edhe Lëvizjen "Kuq e Zi", për të dhënë spjegimet dhe informatat e duhura dhe për t'i dhënë fund kësaj gjëme negative në mbrojtje të femrës shqiptare.

Reklamoni biznesin tuaj!

GAZETA "RRUGA E ARBËRIT"
VË NË DISPOZICION
HAPËSIRAT E NEVOJSHME
PËR REKLAMËN TUAJ!

Tel: (04) 22 33 283

Email: rrugaearberrit@gmail.com

Shkruajnë lexuesit

GËZIM ALPION:

E lexova me shumë interes gazetën tuaj. Me pëlqeu shkrimi i Xhafer Martin. Hysen Lalën e kam njohur personalisht dhe kam pasur shumë muhabet kur isha në Peshkopi gjatë stazhit, pas mbarimit të shkollës së mesme. E takoja dhe bisedoja edhe kur kthehesha me pushime gjatë kohës që studioja në Kajro. Më pati lënë mbresa shumë të mira; ishte dashamirës dhe erudit.

Punë të mbarë dhe suksese!

Letër nga adresa <jareah_center@yahoo.com>

Pershendetie!

E morem xhormalen e mirenjohur "Rruga e Arberit". Ne fakt tranzmetimi online është një mbrekulli e informatikes moderne. Trajtimet janë nga me mbreselene, pavaresisht se si e ka konceptuar stafi organizues çeshtien e mbledhies se te ardhurave, pasi kopia e printuar siell te ardhura dorazi, pra direkte.

Nisur nga fakti se ne e lexojme dhe kujdesemi per kete xhormale, do te deshironim qe ne numri e ardhshem te mund te kishte nje shkrim, ose nje trajtim ne lidhie me viziten e fundit te ish-kryetares se dhome se perfaqesuesve italian Iren Piveti ne Vlore. E ndoqem repliken mes saj dhe nje nene shqiptare. E keqja e kesaj pune eshte se ne gjithmone jemi prirur t'i shohim gjerat bardhe e zi, d.m.th t'i japim vlere vetem vehtes tone. Ne gjuhen e diplomacise, meqenese une kerkuesi, vete, kam punuar ne nje sektor te tille, ekziston ne konceptin e ashtequajtur "diplomaci direkte".

Çfare eshte "diplomacia direkte"?

Ne te gjithë e pame pozicionin e veshtire te ish-kryetares se dhome se perfaqesuesve te Parlamentit Italian, Iren Pivet gjate vizites se saj ne Vlore kete fillim jave. Ne e pame ate te kerkonte ndiese njerezore, e perserisim njerezore. Nderkohe, ne nuk pame nje ndiese njerezore ne krahun analog, qe do te thote te pales shqiptare, qe perfaqesohej, nga nje nene e djegur. Ne fakt ne nuk pame nje nene te djegur, por pame "nje nene politikane". Shprehia "ju nuk duhet te shkelnit token shqiptare" te ngjan me nje deklarim skajmersisht te politizuar, nje atribut te tejkaluar persa i perket tragave qe perfaqeson nje individ, duke perjashtuar ndiesine qe ka nje nene ka per femijen e saj. Gjithkush i kupton pershtellimet qe te siell ky moment. Por, mos valle ajo qe ishte perpara kesaj nene ishte nje vrasese, pra nje killer ndaj te ciles ishte paraqitur çasti i volitshem per shpagim!?

Ajo qe ne ne te deshironim t'i kujtonim jo Iren Pivetit, por kesaj nenes shqiptare eshte kjo. Perse femija e saj guxoi te shkelte token italiane!? Perse nuk e pyet vehte ajo se sa bujare dhe mikprites u tregua populli italian kur priti jo sot, por nder shekuj bashkeatdhetaret tane. Perse nuk e pyet vehten ajo dhe kushdo tjetër se sa bujare dhe mikprites jane treguar italianet kur kane pritur pafundesisht shqiptare, qe u perdhunuan dhe perçunduan nga nje sistem mizerable dhe depotik siç ishte shporra dhe funderrina komuniste ne Shkypëri dhe ajo qe ndodh sot me funderrinat e e koherave moderne ne Libi. Perse ajo nuk e mekoi te birin se te shkelesh toket e tjeterkujt pa leje eshte mekat, delikt dhe krim!?

I nderuar mik!

Ne jemi shqypetar dhe ne i kuptojme shume mire poshtersite e njerit-tjetrit. Mori fund koha kur ne poshtersite i shisnim per virtyte. E pame se si reagan mediat dhe shtypi shipetar kohet e fundit ne lidhie me dekorimin qe Presidenti i vendit Bamir Topi, me te drejte, madje do te duhet te bente shume me shume, i beri Provinces se Pulais ne lidhie me priten madheshtore dhe bujare qe ajo province dhe mbare populli italian u bene shqiptareve. E pame dhe reagimin e te ashtequajtur "dallandyshe e pluralizmit"- "Koha Jone". Dhe thone, miku im, se nuk ka poshtersi me te madhe se mosmirenjohia. Dhe keshtu jemi ne, mosmirenjohes, dhe bejme siku jemi te ndershem. E dime se kjo nuk do t'u pelqente shume vetave, ne vecanti Nastradinin qe prej vitesh drejton kete vend dhe Nastradineve te tjere qe vegjetojne nen te dhe atyre Nastradineve qe i mbajne iso ketij, por ç'te besh miku yne, e verteta eshte e hidhur, vret, por eshte e vertete, dhe nuk ka gje me madheshtore, me sublime, me te kristalte, me perfekte dhe te adhurueshme, te dashur ashtu si vet kryeperendia yne i madherishem na meson, MIRENJOHIA, ndaj atij qe te ndihmon ne ditën e veshtire. Greqia, Italia, dy atethe te dyte per shkypet e malit, per ata shqipatre mosmirenjohes qe perveç egos se tyre nuk njohinasgje tjetër. e kush i hapi dyert si ata ne ditet me te veshtira!? Por gjithkush mund te harroje, por historia kurre. Ajo eshte kokeforte dhe e pakthyeshme, e pakorrigjueshme. Kjo eshte aksiome dhe kete duhet te mesojne Arnautet, ata qe nuk ditën te kthejne mbrapsht dhe t'i perkulen askujt. Ky eshte virtyti yne i harruar. Shkruaj, se keto jane te verteta. Seicli italina qe mberrin token e keti vendi duhet te ndiehet krenar per ate qe poltikane te tyre bene kete shekull. Ata jane te shjkelqyer. Chi se ne frega che pensano alcuni in Albania!?

Diplomacia e drejtperdrejte do te duhej qe ne nje fare mase te vepronte edhe ne siellien e Iren Pivet. Por si gjithmone, diplomacia fsheh tinzarine, prandaj dhe ajo nuk qe drejteperdrejte, me nje pergjigja facia-a-facia.

Sidoqofte, ky eshte nje reagim i yni, qytetar dhe nuk perben detyrimisht, detyrim per pasyrim ne organin tuaj, pasi per ne kjo ka pak rendesi dhe sigurisht varet nga ndiesia e organit tuaj mediatik per kete çeshtie.

Ju lutemi pranoni shprehiet e konsideratave tona te sinqerta!

SHËNIM:

Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit me lexuesit si dhe krijimin e hapsirave botimi "pa censure", gazeta do të botojë letrat dhe shkrimet e lexuesve pa iu nënshtruar procesit të redaktimit.

Na shkruani në adresën e emailit:

rrugaearberrit@gmail.com

Faleminderit për mirëkuptimin!

Duke filluar nga ky numër, gazeta do të botojë herë pas here materiale nga autorë të ndryshëm, të cilët nuk do ti nënshtrohen redaktimit apo korrektimit. Idetë, faktet dhe materialet e botuara do të jenë përgjegjësi e autorit.

Patriotët dhe intelektualët e Dibrës (1844-1912)

Nga: **AQIF KARAJ**

Malet e Dibrës janë plot gryka, lugina e fusha të mëdha. Këto janë pesë porta që u lënë shteg armiqve për t’u futur në Dibër: Dy grykat e Drinit të Zi në Veri dhe në Jug, si dhe grykat e Bulqizës, Qafë Murrës e Radikës. Këto gryka, janë shumë të rrezikshme për t’u kaluar nga ushtritë armike. Përveç epërsive natyrore, kjo zonë ka dhe njerëz me vlera të mëdha patriotike e intelektuale që kanë treguar mençuri, trimëri e patriotizëm në luftërat shekullore në gjithë zonën e Dibrës e më gjerë. Ata mbanin lidhje të ngushta dhe bashkërëndonin veprimet luftarake me gjithë krerët e Dibrës së Epër e të Poshtme si Sali Marken (Pasha) Sal Demirin e Çidhnës, Elez Murrja i Luznisë, Kazi-hanin e Selishtës, Trocin e Reçit, Kaloshin, Ndre-un, Karasanin, Lleshin, Demën etj. Në zonat e Dibrës jeton një popull i cili shquhet për patri-otizëm, trimërinë e zgjuarsinë e tij, që gjeneralët popullorë të këtyre zonave kanë mbrojtur me heroizëm këto male e gryka të cilët kanë lënë gjurmë në historinë e tyre të viteve 1840-1912 dhe më pas. Jo vetëm kaq, ajo ka qenë Dibra e luftërave heroike të njëpasnjëshme, të përvitshme, të për-muajshme, që nga koha e Skënderbeut. Nuk mund të harrohen betejat e popullit të Dibrës e gjithë Shqipërisë nën udhëheqjen e strategut Skënderbeu për 25 vjet rresht (1443-1468). Luftërat e zhvilluara në zonën e Dibrës si ajo e Drinit të Zi e udhëhequr nga Sheh Mustafa i Zer-qanit, Sal Markja e gjithë krerët e Dibrës, ajo e zhvilluar rreth Gurit të shpuar në fushën e Shehrit të dibrës, të kujtojnë luftërat e Skënderbeut, kur pas çdo fitoreje në sheshin e luftërave ndizeshin zjarre të mëdhenj dhe ushtarët të gëzuar këndonin e kërcenin gjithë natën. Sulltanët e Turqisë ishin shumë të shqetësuar për të rivendosur ad-ministratën në Dibër. Luftërat fitimtare dhe dësh-timet e ekspeditave të mëdha turke, e lanë Dibrën pa prefekt (Mytesarif) deri në vitin 1855. Disa herë kishte dështuar dhe në vitin 1855 ajo dërgoi Hys-ni Pashën, edhe ky dështoi... Ku për këtë pashë e të tjerë ka shumë anekdota të lezeçme nga pleqtë e mençur të Dibrës.

Numri i madh i të varërve që Hajredin Pasha la në Dibër, si dhe dështimi i ekspeditës së Valiut të Rumelisë, bënë bujë të madhe në Stamboll. Tur-qit me “tespi në duar”, pa shkollë e njohuri gjeografike për Shqipërinë thonin: Se Hajredin pasha kishte luftuar me nëntë malet e Dibrës, kuj-tonin se këto ishin nëntë krajli (mbretëri) Sulltani nuk pyeste për kulturën, mjaftonte t’i bëje ndonjë shërbim për të të graduar “Pashë”, si ç’bëri me Sal Marken, Has beg Karahasanin që do të shohim më poshtë, apo Iljaz Qokun nga Kllobocisht, që e fitoj këtë gradë me ryshfete. Kur u thonin se do të vini e të luftonin në Shqipëri, ata e dinin se do të luftojnë me nëntë krajla (mbretëri) bile ata e refuzonin, ose bëheshin të sëmurë siç bëri koza-kliu Sulejman Pasha. Luftërat e popullit shqiptar ndaj Turqisë, pas vitit 1840, kishin arritur në një shkallë më të lartë. Nuk bëhej më luftë kundër oxhaqeve ma të fuqishme, për t’ia dorëzuar detyrën e prefektit, oxhakut ma të dobët. Eksperi-enca u pat treguar fshatarëve, se oxhaku i dobët bëhej i fuqishëm. Populli thoshte: “Nuk kemi nevojë ma për prefekt” “për oxhaqe” Dibra e kish-te gjetur rrugën e saj se si të administrohej. Ox-haqet e Dibrës pothuajse e kishin humbur Shkël-qimin e përkrahjen e tyre në zonat e tyre, sepse ata bënin dhe gabime. Shumë prej tyre për inter-esa ekonomike, për troje e ç’fliqe viheshin në shërbim të administratës turke.

Krahina e Bulqizës duke qenë Mal më vete me në krye Dalip Karaj, nuk kishte oxhaqe e bajrak-tar siç kishte Dibra e Madhe, Dibra e Poshtme, ajo kishte udhëheqës popullor, patriotë e luftëtarë që udhëhiqnin popullin në kryengritje të armato-sur kundër pushtuesve turq të asaj kohe, si Fecë Canka, Dalip Karaj, Mehmet Duriçi. Kryengritësit Dibranë në vitin 1835 luftuan heroikisht në Strugë, Ohër dhe Elbasan, duke i bashkuar armët me kryengritësit e krahinave të tjera. Në shkurt të këtij viti nëntë malet e Dibrës e detyruan portën e lartë të pranoj kërkesat e kuvendit të Dibrës.

“... S’jemi mësuar këto armë me i dhanë Jemi rritur trima dibranë,

S’kemi pyetur për ty me flakë, Jemi trima bulqizakë..”.

Në betejën e vitit 1844 kundër ushtrisë turke të komanduara nga Hajredin Pasha u bë një luftë e rreptë sa që me luftërat e këtyre u bashkuan dhe gratë e fëmijët, ku në fushën e Gjoricës ushtria turke la mbi 12000 vetë.

Rapsodi Hazis Ndreu u këndoi me madhësi:

Hajredin Pasha, ku e ke ushtrinë Krejt në Dibër ma kanë gri, Jo më pak se dymbëdhjetëmijë Hajredin Pasha ku i ke gaborret N’fushë të Gjoricës i kanë vorret. 900 varret kush i bani Dibra e madhe e Zerqani.

Dibranët nuk i pranuan ligjet e Tanzimatit të shpallura nga Abdyl Mexhiti me dekret të veçantë që zgjati mbi 5 vjet. Me ardhjen e këtyre turqve qetësia u prish. Dibranët filluan të mblidhen grupe-grupe. Krerët e nëntë maleve mblidheshin ë kuvende e merrnin vendime, sqaronin situatën e krijuan, bënin pyetje e zbulime të ndryshme; çfarë pushkësh e municionesh kanë sjellë turqit?! Ç’plane kanë? etj. Kështu ata përgatiteshin për luftë... Mbledhja tek Gurra e Mazhicës u bë ditën e dytë të qershorit. Aty u grumbulluan krerët e fshatrave dhe burra patriotë të mençur dhe të pushkës.

Nga Bulqiza, erdhi Dalip Karaj e Mehmet Duriçi me çekiçët e tij, nga gryka e madhe, Ismail e Baloshi e Jashar Zeneli, Sul Shehu etj. Nga Gryka e Vogël, Sal Markja, Sefer Lleshi e Rrahman Dema me çekiçët e tyre. Nga Dibra e Poshtme erdhi Elez Murrja, Sali Nikolli e Hysen Manuka nga Luznia, kurt Hoxha e Abaz Pira nga Muhurri, Sal Demiri, Ali Lusha, Demir Noka nga Çidhna, Mahmut Tro-ci e Hasan Doda me çekiçët e tyre.

Tre vetë ishin të papranueshëm në këtë mbledhje se ata i kishin shërbyer turkut për inter-esat e tyre ekonomike! I pari foli Dalip Karaj i Bul-qizës i cili tha:

Ligjoni or burra! Sal Markja asht burrë i mençur, kur do asht dhe trim. Ai na ka mbledhë këtu, asht mirë ta nigjojmë para se të marrim vendim?! Po kështu dhe për Abas Pirën e Sal Demirin. Ashtu them dhe unë o Dalip Karaj i Bulqizës tha Elez Murrja. Kuvendi dëgjoi Sal Marken i cili në fjalën e tij shtroi “lojën” e taktikat e luftës, kundër Hysni Pashës. Kjo luftë tha Sal Markja të bëhet jashtë qytetit në fushë të hapur të Shehërit të Dibrës rreth Gurit të shpuar. Kështu u vendos udhëheqësi dhe organizatori, ngeli Sal Markja i Grykës së Vogël. Ai u bëri thirrje krerëve të maleve, kur t’u çojmë fjalë, të jeni gati për luftë. Kam shpresë se të gjithë këta turq do t’i zëmë rob, dhe ta marrë vesh sull-tani se kush asht Dibra! Kur ta marrë vesh Sulltani do t’i plasin damarët e qafës! Qeshën të gjithë. Ai porositi se plani i luftës të mbahet sekret deri në minutën e fundit. Pasha ra në kurth nga zgjuarsia dhe mençuria e krerëve të Dibrës?! U caktuan tre vetë për t’i uruar mirëseardhjen Hysni Pashës, Sali Markja, Sal Demiri dhe Rrahman Dema. Sali Markja dha urdhër të hapët pazari, i cili ishte mbyll prej ditësh nga frika dhe reprezaljet që mund të bënin turqit në qytetin e Dibrës së Madhe. Iljaz Qoku njoftoi Pashën për ardhjen e tre vetave. Iljaz aqa (Qoku) i tha Hysni Pashës se Sali Pashë Markun e ke me vete, ai e hapi pazarin. Hysni Pasha u gëzua shumë. Tre përfaqësuesit e Dibrës u pritën me shumë qef nga pasha. Ai doli bashkë me 300 kalorës në qytet për të parë se sa do ta respektonin ky popull. Sal Pashë Markja masi kish-te organizuar çdo gjë me kryengritësit e tij, i doli përpara Pashës, a do ta njohë apo jo. Pasha ndali kalin dhe i briti, ku je or Sali Pasha? Kam kaq ditë që të pres! U përshëndetën, por Sal Markja kishte vendosur që: Lufta fitohet me turqit, duke zbatuar 7 hile 1 trimëri.

Filloi muhabeti dibrançe, pasha tha: Milet i keq, asnjë vizitor, do ta djeg këtë qytet! Ç’asht Dibra para Turqisë?!

Ky popull duhet t’i bindet Turqisë. Ai duhet të paguajë taksat dhe të gjithë ata që kanë mbushur moshën e shërbimit ushtarak do t’i çojmë në Stam-boll. Ai filloi të tundë kërbacën para hundëve të Sal Demirit e Rrahman Demës, të cilët u prekën shumë. Ata filluan t’i njëri tjetrit: Pasha paska mjekrën e gjatë, e qenka tru thatë! Derrit tani për tani duhet me i thanë dash, tha Sal Demiri, të cilit nuk ju duruan më fjalët e Hysni Pashës!!!

- Or terxhumen (përkthyesit) i thuaj atij Pashës: Ne jemi pleqtë e maleve të Dibrës. Llafet bahen në hyqimet e jo në rrugë! Ne kemi ardhë si mysafir e jo si hasëm! I thuaj se nderin e vatanin nuk ja kemi shitur asnjë pashe e jo këtij!!! Pratoo or Salë! U dëgjua britma e Rrahman Demës. Ai na i muer nderin dh nxori koburen e ia drejtoi Hysni Pa-shës në lule të ballit. Ndërhyri Sal Markja, plumbi fluturoi në hava. Kalorësit turq i arrestuan të tre (Sal Marken, Sal Demirin e Rrahman Demën). I gjithë populli u shpërndanë. Pasha u fut në kre-vat, zabitllarët shanin arnautët me lloj-lloj fjalësh, duke thënë shyqyr që na shpëtoi pasha. Asqerëve dhe Pashës u hyri frika në palcë. Sala e Mane Dema bënin replika me njëri-tjetrin në burg, me duar të lidhura. Na u prish e gjithë “loja” që kurd-isëm te ura e Mazhicës me me krerët e nëntë maleve...?! Tani bëheshin plane se si të dilnin nga burgu! U thirr roja i burgut, i thuaj pashës se Sal Pashë Markja ta shpëtoi jetën, prandaj do me u takue, ka shumë gjëra për të thënë! Mendimi i zabitllarëve ishte që “tre arnautët” të vraren... Dy dervishët kërkonin takim me pashën (dervish Emurllahu e dervish Hyseni) që të lironin tre të burgosur. Dërvishët dëgjoheshin nga pasha si fetarë, por edhe populli i Dibrës së Madhe i don-te shumë, ata ishin të mençur dhe patriotë. Taki-mi u bë, muhabeti filloi në rrugë fetare. Allahu asht i madh. Pa urdhër të tij, robi-robit nuk mund t’ia shkurtoj jetën. Ne na ka dërguar gjithë ky mi-let i qytetit të Dibrës së madhe, gjithë besimtarët e fesë myslimane, për shyqyr që shpëtove! Allahu ta shtoftë ymrin e të ruajt nga rreziket! Pasha i përgëzoi dervishët. Por ai nuk kishte besim, ai kërkonte me forcë të krijojë administratën e tij, të sundojë dhe të nënshtrojë malet e Dibrës!

Dervish Hyseni i thotë pashës: Punët duhet t’i merrni ma ngadalë të dy palët, ju keni armë dhe ata kanë armë?! Ju duhet të merreni vesh me njëri-tjetrin?! Ky popull asht pak i egër, se po u zemrua, çohet në këmbë e bën hata! Ju e keni zemëruar shumë popullin që ditën e parë kur erdhët...! Ju mbylltë pazaret, u sollët shumë keq me popullin dhe krerët e nëntë maleve të Dibrës! Për të gjitha këto, do t’i shkruajmë sulltanit gjerë e gjat.ë po deshe me u marrë me vete! Ata dhe ne, erdhëm që të të ndihmojmë ty dh eushtrinë tënde, e jo të na tregosh forcën e të na fusësh në burg! Kështu Dibra nuk do të bintet kurrë...! Sal Markja ju shpë-toi jetën e ju e futni në burg. Kjo e të tjera do shkaktojnë një luftë të ashpër, të gjithë do të vriten, theksoi dervish Hyseni?! Pasha i frikësuar, u bind dhe liroi Sal Marken e Sal Demirin. Ata kërkonin me këmbëngulje që të lirohej dhe trimi Rrahman Dema... A kujton ti or Pashë, se duke mbajtur këto dy vetë në burg, do t’i rregulloni këto punë?! Edhe Hajredin pasha mbajti pengje, vrau, dogji e burgosi, por, a e ke nigjue se çfarë i ndodhi në Dibër? Sa sulltani e vari atë në Stamboll. Kështu si e ke nis ti punën, ne s’kemi si të të ndihmojmë.

Pasha nuk po hiqte dorë nga vendimet e tij, Sal Markja i tha: Atëherë na lejo, të takojmë ato në burg dhe më vonë të lëmë takim në fushë të hapur, ku të festojmë ardhjen tuaj në Dibër?! Këto ishin planet e maleve të Dibrës, për ta futur Pashën dhe ushtrinë turke në kurthe të pamenduarandon-jëherë. Kjo ishte mençuria dhe 7 hilet dhe 1 trimëri e patriotëve e krerëve të Dibrës heroike. Dibra organizoi takimin (festën) në fushë të hapur, anash Gurit të shpuar. Kalorësit dibranë kishin zënë pozicionet e tyre shumë sekrete. Kalorësit turq ishin vendosur në vende të ndryshme të ndarë në skuadra kurse Hysni Pashës i ishte shtruar tapeti e jestikët e kuq, ku i shërbenin shumë çizmetçi. Kuzhina gatuateu dreka të bollshme. Dreka u sh-trua: krerët shihnin pashën e asqerët. Ata filluan të bëjnë bejte e të thurin vargje:

“Gjeç belanë prej allahut, Se u banë për ibret Kaftanin me dhjam kau Edhe mjekra me sherbet!

Allahu të ardhhtë hakut Na ke ardh veç për sherr Në të zënça ngusht sokakut Do të të vras për der!”

Pas këtyre drekave e darkave Hysni Pasha e ndjen veten të sigurt në Shehër të Dibrës (qytet). Ai u dërgoi krerëve të Dibrës 8 kërkesa me shkrim për realizimin e detyrave për pushtimin e shfrytë-zimin e kësaj zone të pabindur. Krerët i kundër-

shtonin të gjitha këto kërkesa! Ato po përgatiteshin për shpartallimin e ushtrisë turke dhe ashtu u bë:

- U firmosën marrëveshjet ashtu siç donte Pa-sha, i cili nuk po e kuptonte lojën e mençur të krerëve të nëntë maleve të cilët refuzonin si mbledhjen e armëve, të taksave, të ushtarëve etj., replikat ishin të forta me pashën e zabitllarët e tij. Pasha ngulte këmbë e tundte shpatën duke thënë:

- E ardhmja e Shqipërisë asht Turqia, ajo asht e fortë! Shqipëria nuk mund t’i bëjë ballë shtetit turk etj.

- Krerët donin të bindin pashën që populli asht i varfër, ai nuk mund t’i bëjë gjë ushtrisë turke.

- Fshatarët dibranë nuk mund të jetojnë pa armë e pa bukë, nuk mund të dalin të lypin për të paguar haraçe etj.

- Dalip Karaj, Sul Shehu, Sal Markja, Elez Mur-rja, Sal Demiri, shumë burra të mençur e patriotë, trima e kalorës ishin vu në gatishmëri për të çar-matosur ushtrinë turke, ose t’u marrin fishekët dhe t’i nisinin për Manastir ose drejt Kosovës!

- Topat, municionet do të ruheshin në kazer-ma e depo të Dibrës së Madhe, se do të duheshin kur të vinte ndonjë pashë tjetër.

- Të gjitha këto plane ishin të panjohura për Pashën. Krerët e Dibrës e gjithë populli rrethoi ushtrinë turke, e çarmatosi atë, armët e tyre ishin pa fishekë dhe e nisi drejt Prizrenit (Kosovës), dhe një pjesë drejt Manastirit.

- Krerët e Dibrës mbajtën armatimin e topanx-hat e pashës e të oficerëve turq, si dhe kuajt, e të gjitha materialet e tjera të luftës që kishte sjellë Hysni Pasha për të ba “zap” Dibrën.

- Krerët e nëntë maleve hidhnin muhabete e bënin qyfyre me njëri-tjetrin duke përshëndetur njëri-tjetrin për mençurinë, trimërinë e Sal Markes, Sal Demirit, Elez Murrës, Dalip Karaj, Sheh Sulës, Sheh Fezë Bulqizës, Demollarëve, Kaloshëve, Trocit, Kazihanit, Karasanit, Dodës, Cadit, Ndreut etj., burrave trima e patriotë të Dibrës.

Në sajë të mençurisë së krerëve të nëntë ma-leve të Dibrës. Dibra mbeti ashtu siç kishte qenë më parë, autonome dhe e vetëqeverisur. Por sull-tanët e Stambollit herë pas here dërgonin gaborre të shumtë për të nënshtruar Dibrën. Në prill të vitit 1860 me në krye Avdi Pashën mbi 8000 forca hynë në Dibër të madhe. Feze Canga i Bulqizës së bashku me forcat e Grykës së Madhe, të Mar-taneshit, Gollobordës, Grykës së Vogël etj., dhanë kushtrimin luftarak. Ata zunë pozicionet luftar-ake të tyre në krahun e majtë të Drinit të Zi, duke u skaljonuar në thellësi nga ura Spile, Çerenec, Strikçan, Sofraçan, ura e qytetit në fushë-Bulqizë. Më 26 prill 1860 lufta nisi e ashpër. Gratë e fëm-ijët e fshatrave të Grykës së Vogël, grykës së mad-he, Bulqizës u larguan në male. Forcat kryesore që ishin në grykën e Bulqizës u tërhoqën me luftim, me qëllim që ushtria turke të futej në vende e pyje të panjohura. Shtëpitë e Grykës së Madhe, të Bulqizës, Martaneshit u kthyen në fortesa deri në luftim trup me trup. Sheh Feza i Bulqizës me 300 burra u tërhoq me luftim drejt pyjeve të Mar-taneshit ku me ta u bashkuan dhe 200 forca të kësaj zone. Qëllimi i turqve ishte të zinin të gjallë Fezë Cangën, si k... i pushtimit turk dhe përhapës i fesë bektashiane.

Dymbëhjetë djemtë bulqizakë, U dogjën në tym, u dogjën në flakë, U vranë me pushkë, u therën me shpatë, Qëndro sheh, qëndro or burrë, Se nami e shpirti jot, nuk vdesin kurrë.

Betejat për Dibrën ishin të panumërta si ajo e vitit 1872 më në krye Demir Pashën, ata të viteve 1881-1882, 1894, 1899, 1878, 1900, 1910

“Kush e ngriti flamurin tek hni, Dalip Karaj e Male Dani, Dalip Karaj një arush mali Kur thirri ai Dalip Karaj Fort u dridh ai mirallaj (koloneli)

Është krenari e nëntë maleve të Dibrës që luftu-an në shekuj dhe që përgatitën, shpartallimin e ushtrisë turke (xhonturqit) dhe arritën të përgatis-nin pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Në prill të vitit 1912, mbi 2000 kryengritës të udhëhequr nga Mersim Dema, Sheh Sula i Zer-qanit, Mehmet Duriçi i Bulqizës etj., kërkuan që të mos zgjidhej në Dibër deputeti i shpallur nga xhon-turqit. Ndryshe thonin ata: “Drini i vjetër do të marrë ngjyrë tjetër, me luftë do t’i fitojmë të drejtat kombëtare”. Të gjitha këto beteja ishin zbatimi i vendimeve të drejta të kuvendeve të Di-brës që udhëhiqeshin nga njerëz të mençur, tri-ma, patriotë e intelektualë të Dibrës martire.

“Rrëfimet e komshiut” prezantohet në Prishtinë



Nga: Shpëtim Hyka

Është bërë traditë që në seminarët kombëtare për Mësimin Plotësues të Gjuhës Shqipe në Diasporë të krijohej një hapësirë për krijimet e mësuesve shqiptarë, krijime letrare, publicistike, dokumentare, monografike etj. Duke u dhënë një ngjyrë dhe hapësirë të këndshme seminareve.

Nga Greqia, edhe këtë radhë, si edhe në seminarët e Strugës dhe Mitrovicës, erdhi Abdurahim Ashiku, gazetar dhe publicist i njohur në Greqi dhe në diasporë, erdhi me librin “Rrëfimet e komshiut” – Tregime të jetuara. Prezantimi i librit u bë në ditën e fundit të seminarit, prezantim në të cilin mori pjesë edhe Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë së Kosovës zoti Ram Buja dhe personalitete të tjerë të Kosovës.


Prezantimin e librit e bëri Andon Andoni, kryeredaktor i revistës “Mësuesi”, shkrimtar. Ai ndër të tjera tha:

“Libri i Abdurahimit është një libër që ka rrëfenja konkretisht të prekshme, të jetuara, të ndodhura siç ndodh në jetën tuaj të përditshme. Pak a shumë ato ngërthehen dhe ngjasojnë në një paralele edhe me shkrimtarin tonë të dëgjuar Pëllumb Kulla me librin e tij interesant “Rrëfime nga Amerika”.

A jo çka duket tek “Rrëfimet e komshiut” është se gazetari dhe publicisti Abdurahim Ashiku është një publicist i gjinisë letrare gjë e cila i shkon shumë mirë shoqërisë së sotme.

Për Abdurahimin unë nuk do flasë shumë në kuptimin e biografisë

Rrëfimet e komshiut” në kopertinë ka një pikturë ku siç thuhet në parathënie ka ngjyrat e dashurisë të një mësuesi në të vetmen shkollë shqipe në fshatin grek dhe të nxënësve të tij, fillon me një tregim për gjuhën shqipe për tu mbyllur po me një tregim për gjuhën shqipe, me tregimin “Dëshmitar në gjyqin e shqipes”, një ngjarje, një gjyq që tronditi dhe u bë zë i veçantë jo vetëm në shoqërinë greke por edhe atë botërore...



sepse flasin librat e tij duke filluar nga “Njerëz që i dua”, “Rilindësit e Kohës Sonë”, “Shkolla Shqiptare e Athinës-Rilindësit e Kohës Sonë-2” e deri tek “Rrëfimet e komshiut”. Në këto libra jeni ju, ai ju quan Rilindës dhe ju jeni me të vërtetë Rilindës të Kohës Sonë...”

Duke e marrë fjalën, mes emocioneve Abdurahim Ashiku tha:

“Jam i gëzuar dhe i emocionuar që në prezantimin e librit tim të ri ndodhet Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës Ram Buja emri i të cilit në Greqi, nga emigrantët shqiptarë, shqiptohet me respekt të veçantë.

Unë e kam më lehtë të shkruaj se sa të flas, për më tepër të flas kur është fjala për mua dhe punën time. Kam botuar 5 libra të serisë “Njerëz që i dua”. Të duash është gjë e madhe. Po nuk deshe nuk shkruan dot, nuk të shkon fjala.

Heronjtë më të dashur të librave të mi, që nga i pari tek i pesti, janë mësuesit shqiptarë në emigracion, në Greqi dhe në të gjithë Evropën, janë mësuesit, Rilindësit e Kohës Sonë.

Libri i fundit i serisë “Njerëz që i dua” – “Rrëfimet e komshiut” në kopertinë ka një pikturë ku siç thuhet në parathënie ka ngjyrat e dashurisë të një mësuesi në të vetmen shkollë shqipe në fshatin grek dhe të nxënësve të tij, fillon me një tregim për gjuhën shqipe për tu mbyllur po me një tregim për gjuhën shqipe, me tregimin “Dëshmitar në gjyqin e shqipes”, një ngjarje, një gjyq që tronditi dhe u bë zë i veçantë jo vetëm në shoqërinë greke por edhe atë botërore...

Thirrja ime është të shkruajmë më shumë, të botojmë më shumë, të themi fjalën tonë për gjuhën shqipe –shqip kudo ku jemi...”

Ministri Ramë Buja përshëndeti autorin për punën e bërë duke i ftuar të pranishmit që të shkruajnë dhe botojnë më shumë libra për gjuhën shqipe dhe shqiptarët në diasporë.

Zoti Ashiku i dhuroi Ministrit Buja katër nga librat e serisë së tij “Njerëz që i dua”

Libri “Rrëfimet e komshiut” është tashmë pjesë e bibliotekave të shumë mësuesve në mbarë Evropën.

Publicisti i njohur Halil Rama boton librin e tretë me monografi, recensionë e komente



Fundi i “Rrugës së vetme”, një libër me përfundime të vlefshme

Ka njerëz në botën e medias që shpërthejnë e bëjnë bujë me shkrimet e tyre dhe më pas velen me “arritjet” dhe vegjetojnë në ndonjë parti politike apo institucion, pasi kanë arritur qëllimet e tyre pragmatiste e të mëpastajme.

Ka njerëz në botën e medias që punojnë pa bujë dhe zhurmë dhe me shkrimet e tyre lënë gjurmë, në fillim gjurmë të thjeshta dhe më pas gjurmë që nuk shlyhen nga kujtesa e kombit.

Këtyre të dytëve u përket publicisti Halil Rama, i cili këto ditë sapo ka botuar librin e tij të tretë me titullin sinjifikativ “Fundi i Rrugës së vertme. Halili është nga Muhurri i Dibrës. Që në moshë të re ka shkruar në shtypin e kohës, në gazetën “Zëri i Rinisë”, “Luftëtari”, “Ushtima e maleve” etj., duke qenë një zë i veçantë dhe disi ndryshe për kohën që ishte.

Në vitet 1993-1996, krijon dhe drejton gazetën e parë pluraliste “Bullqiza”, gazetë, e cila luajti një rol të madh në zhvillimet demokratike të këtij qyteti të vuajtur minator.

Më vonë, në Tiranë, ai do të shkruajë me guxim dhe dinjitet në gazetën kombëtare “Albania”, “Rilindja demokratike”, “Republika”, “Panorama”, “Metropol”, “Standard”, etj., për t’u stacionuar denjësisht në gazetën e përditshme politike “RD”. U bënë mbi 12 vjet që punon në këtë gazetë, në opozitë dhe në pozitë, dhe kurrë nuk u ankua, kurrë nuk kërkoi privilegj apo vend të rehatshëm për kompensim.

Ka lëvruar të gjitha gjinitë e publicistikës që nga editoriali, lajmi, kronika, reportazhi, raportimi në terren, komenti, intervista etj.

Në këtë libër të ndarë në tre cikle: (monografi, refleksione dhe komente) nuk është pasqyruar as një e qindta e publicistikës së tij të shkruar. Në libër janë botuar dy fragmente nga dy librat monografikë, disa shkrime monografike, disa komente letrare, disa komente politike dhe disa shkrime që autori i ka pasur për zemër gjatë zgjedhjes rutinë të materialit kaq të madh e të vështirë për t’u zgjedhur.

Por edhe me këtë zgjedhje të thjeshtë dhe pa pretendime del në pah aftësia e autorit si publicist, si analist, si reporter, si njeri i letrave.

Veçanërisht janë vlerësuar nga shtypi, nga rrethet letrare dhe publicistike, monografia kushtuar mendjendriturit popullor Dine Hoxha, monografia kushtuar kompozitorit Muharrem Xhediku, muzikantit që vuri bazat e muzikës së lehtë shqiptare, shkrimet monografike kushtuar Isa Ndreut, Mark Shllakut, Kristo Dakos, Fuat Shtyllës, Rasim Sinës, Kujtim Frangut etj.; kritikën letrare kushtuar romanit “Bibollasi”, fitues i çmimit “Petro Marko” të Ramiz Gjinit, analiza letrare e poezisë së Adriatike Lamit, si dhe ajo e romanit “Vetëvrastja e shpirtit” të Naim Berishës, analiza e frymës popullore dhe kritike të alegorisë dibrane, recensionet e librave shkencore të Dr.Jorgo Dhramit që si një ndër personalitetet më në zë të jurisprudencës shqiptare, me botimet e tij jep një kontribut real në pasurimin e shkencave juridike, si dhe të Prof.Dr.Bardhyl Çipi si një nga antropologët e shquar shqiptarë, etj. Po ashtu në ciklin e dytë “Marshi i çmëndur” gjejmë librin e zi të komunizmit shqiptar në të cilin, Agim Musta rrëfen krimet më monstruoze dhe po në të njejtën linjë edhe analizën ideoartistike të poezisë së Fadil Islam Hoxhës e cila trajton një subjekt serioz, atë të antiskëterës komuniste me mendime liriko-filozofike, me koncentrim të ngjeshur të figurës letraro-artistike, që shpesh të pushton e të magjeps për frymëzimin e mesazhin e saj. Po ashtu H.Rama i kushton një vëmendje të posaçme librit “Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit islam”.

Në ciklin e tretë, “Dialog nën pushtetin e dhunës” bien në sy edhe komentet politike të një reporteri që e ndjek në terren politikën dhe jo vetëm në podium, komente që flasin me shifra dhe fakte dhe që kanë përfundime të vlefshme.

Duke lexuar këtë libër publicistik, nuk mërzhitesh dhe nuk shfleton apo përzgjedh më të mirat, sepse të gjitha duhen lexuar, sepse të gjitha janë cilësore.

Unë jam i bindur se edhe tregimet dhe skicat e shkruara ndër vite do ta pasojnë këtë libër dhe se repertori letrar dhe publicistik i Halil Ramës do të rritet. Kjo është rruga e suksesshme e një gazetari të palodhur.

SAKIP CAMI
poet, publicist

Poeti Iliaz Bobaj publikon librin e tij të dhjetë

“Zogjtë e ballkonit tim”, një libër i bukur për fëmijë

Me poetin dimensional, Iliaz Bobaj, u njoha në Patra të Greqisë vitin e kaluar, por për 30 vite me radhë, jam magjepsur nga krijimtaria e tij letrare, publikuar në revistat dhe gazetën më të mira të kohës në Shqipëri dhe në diasporë. Ka publikuar 10 libra të gjinive të ndryshme, qindra cikle poetike dhe artikuj, si dhe ka përkthyer në greqisht, poetin legjendar Ali Podrimja. Ka fituar shumë çmime letrare në poezi dhe prozë dhe është përkthyer në disa gjuhë të rëndësishme të botës. Vëllimi

poetik i tij “Zogjtë e ballkonit tim”, publikuar këto ditë, i ngjan me një trëndafilishteje me ngjyra të shumëllojshme, ku çdo fëmijë ka se çfarë të këpusë nga ky peisazh aromëndjellës dhe çudibërës. Ky është një libër për fëmijë, ndaj dhe poeti me gjuhën e bukur të fëmijëve, por të ngjyrosur në pigmentin e figurshmërisë letrare dhe kompozicionin e pasur, u flet atyre artistikisht, në mënyrë që ata të ndjehen në trëndafilishten e tijnga poeti sa më mirë dhe sa më komod. Libri kush-



ton 300 lekë. Me këtë libër dhe me librat e tjerë të publikuar, autori ka shfaqur tërë fuqinë e krijimtarisë së tij letrare duke u përshirë bindshëm në fondin e artë të letërsisë bashkëkohore shqiptare. **M.H**

Faktori shqiptar dhe siguria rajonale

Nga: **Prof. Dr. Lisen BASHKURTI**
Ambasador

Dalja e këtij libri të ri prej penës së ambasadorit, profesorit dhe studiuesit të diplomacisë e marrëdhënieve ndërkombëtare, Bashkim Rama është vërtete ngjarje për letrat shqipe. E them këtë për shumë arsye. Së pari, është me shumë rëndësi sepse në letrat shqipe kemi një zbrazëti shumë të madhe në fushën e studimeve mbi diplomacinë e marrëdhëniet ndërkombëtare. Së dyti, sepse pjesa dërmuese e diplomatëve tanë, pavarësisht nga karriera, kualiteti e talenti nuk kanë kontribuar sa duhet në krijimin e një trashëgimie teorike, qoftë edhe në formën e kujtimeve apo të rrëfimeve personale. Së treti, për shkaqe trashëgimie, diplomatët shqiptarë më së shumti nuk kanë ardhur në karrierë me bazamentin e plotë multidisiplinor dhe kështu me kalimin e viteve janë shndërruar në tekno burokratë pa kurrfarë mendimi të pavarur shkencor, qoftë edhe empirik. Së katërti, mund të thuhet, madje, se edhe në kohët tona, kur gjithçka po shkon drejt një diplomacie më të hapur publike, rrallë herë sheh e lexon gjëra të shkruara nga diplomatët.

Një gjendje e tillë e botimeve studimore mbi diplomacinë e marrëdhëniet ndërkombëtare është shqetësim mjaft i madh për konsolidimin, zhvillimin e modernizimin e diplomacisë shqiptare. Si çdo fushë e veprimtarisë njerëzore, diplomacia është njëherazi edhe shkencë edhe profesion. Si shkencë diplomacia studiohet ashtu si gjithë shkencat e tjera, bazuar në dijet e përvojat kombëtare e ndërkombëtare, historike e bashkëkohore, teorike bazike dhe të specializuara. Si profesion, diplomacia ka edhe aspektet e saj specifike, aplikues, praktik, teknik e teknoburokratik. Një diplomaci solide, efiçente dhe vizionare ngrihet mbi këto dy kolona: mbi bazamentin teoriko shkencor dhe mbi aftësimin praktik profesional. Tek diplomacia shqiptare e kohës, mendoj se këto dy komponentë nuk ecin paralelisht, por vijnë njëanshmërisht.

Pasojat e një situatë të tillë sot kanë kosto shumë afatgjate për mbrojtjen e interesave tona kombëtare. Duke marrë në konsideratë se Shqipëria po bëhet gjithnjë e më shumë mëndje hapur, shoqëri e hapur, treg i hapur, njëkohësisht i integruar dhe i ndërvarur nga dinamikat globale bashkëkohore vendi e roli i diplomacisë rritet dhe njëkohësisht vështirësohet jashtëzakonisht shumë. Rritet sepse jemi pjesë e një botë të hapur dhe konkurrence të drejtpërdrejtë. Vështirësohet sepse tërë aktorët dhe faktorët ndërkombëtarë luajnë me mjetë e mekanizma përherë e më të kualifikuar dhe të sofistikuar njëkohësisht. Gjithashtu, për vetë specifikat e demokratizimit të sistemeve politike shtetërore dhe të mbarë sistemit ndërkombëtar është rritur shumë numri i operatorëve ndërkombëtarë, të cilët po sfidojnë në mjaft



raste diplomacinë shtetërore e formale tradicionale. Ndaj është moment për të tërhequr vëmendjen seriozisht për konsolidimin dhe modernizimin e diplomacisë shqiptare mbi kolona shkencore e profesionale përherë e më të larta. Libri që na dhuron ambasadori Bashkim Rama është kontribut në këtë rrjedhë.

Bashkim Rama është kryesisht profil i një diplomati me karrierë të gjatë, të larmishme dhe në nivele të larta. Ai e nisi punën në Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke u përgatitur në gjitha fushat respektive. Por, më së shumti u kualifikua për dy hapësira gjeopolitike: për hapësirën gjeopolitike të Evropës Lindore, me qendër Rusinë e vendet sllavo folëse dhe vijoi me Evropën Qendrore, kryesisht Gjermaninë.

Karrierën jashtë shteti, Bashkim Rama e nisi në Gjermaninë Lindore. Në atë periudhë Bashkim Rama punoi paralelisht edhe si diplomat, por edhe si vëzhgues e studiues i vëmendshëm i botës Gjermane. Në Berlin, ai u njoh me pikën më nevralgjike të Luftës së Ftohtë. Rama pati fatin e përgjegjësinë të punonte atje ku u vendos Perdja e Hekurt, ku ndaheshin e ballafaqoheshin dy polet e Luftës së Ftohtë, ku plekseshin interesat më problematike për afro katër dekada, ku trysnia e faktorëve ndërkombëtar Perëndimorë si ShBA, Britani, Francë ngrihej çdo ditë dhe ku depresioni i Bashkimit Sovjetik kundërmonte gjithnjë e më shumë, atje ku rrihte zemra patriotike e pop-

ullit të madh Gjerman për idealin e bashkimit kombëtar. Berlini dhe bota Gjermane, ndonëse e ndarë dhe pse jo edhe e deformuar ideologjikisht nga vendi e roli i Moskës ishte një shkollë dhe shans i madh për diplomatin Bashkim Rama.

Mirëpo, koha ka treguar e çdo ditë dëshmon se jo çdo diplomat e shndërron vendin ku shërben në shkollë për të mësuar dhe në shans për të kontribuar. Rama është nga diplomatët që nuk e lejoi veten të pasivizohej e të burokratizohej, por u tregua aktiv, vital, studiues e krijues. Kultura dhe përvoja e Gjermanisë Lindore, në një prej periudhave më të rëndësishme të historisë modern të njerëzimit ka lënë gjurmë të konsiderueshme në formimin shkencor e profesional të Bashkim Ramës, duke u bërë ndër të paktët diplomat shqiptar me njohje të thellë të dy botëve të mëdha të Kontinentit tonë: Gjermanisë dhe Rusisë.

Duke njohur në themel këto dy hapësira, në fakt Rama depërtoi në gjithë hapësirat e dinamikat gjeopolitike Kontinentale e ndërkombëtare. Është kjo arsyeja që Ai e ka shumë për zemër gjeopolitikën dhe i ka kushtuar asaj doktoraturën, shumë artikuj e studime, sikundër edhe një pjesë të konsiderueshme të këtij libri.

Gjeopolitika është një prej fushave më të vështira për tu studiuar dhe analizuar. Sikundër e parasheh vetë definicioni i togfjalëshit "gjeo" dhe "politikë" vërehet se në këtë fushë

Dalja e këtij libri të ri prej penës së ambasadorit, profesorit dhe studiuesit të diplomacisë e marrëdhënieve ndërkombëtare, Bashkim Rama është vërtete ngjarje për letrat shqipe. E them këtë për shumë arsye. Së pari, është me shumë rëndësi sepse në letrat shqipe kemi një zbrazëti shumë të madhe në fushën e studimeve mbi diplomacinë e marrëdhëniet ndërkombëtare. Së dyti, sepse pjesa dërmuese e diplomatëve tanë, pavarësisht nga karriera, kualiteti e talenti nuk kanë kontribuar sa duhet në krijimin e një trashëgimie teorike, qoftë edhe në formën e kujtimeve apo të rrëfimeve personale. Së treti, për shkaqe trashëgimie, diplomatët shqiptarë më së shumti nuk kanë ardhur në karrierë me bazamentin e plotë multidisiplinor dhe kështu me kalimin e viteve janë shndërruar në tekno burokratë pa kurrfarë mendimi të pavarur shkencor, qoftë edhe empirik. Së katërti, mund të thuhet, madje, se edhe në kohët tona, kur gjithçka po shkon drejt një diplomacie më të hapur publike, rrallë herë sheh e lexon gjëra të shkruara nga diplomatët.

kemi një pleksje të faktorëve më objektivë natyrorë me faktorët më subjektivë njerëzor. Kjo pleksje e mban gjeopolitikën midis shkencave natyrore dhe atyre politike. Suksesi i njohjes, studimit dhe analizës në gjeopolitikë kushtëzohet, pra, nga shkalla e njohjes së faktorëve objektivë si natyra, toka, popullsia, ekonomia, lëndët e para pasuritë, ujërat, pozicioni gjeo-ekonomik e tregtar dhe gjeostrategjik dhe i faktorëve që i vënë në efiçencë ose jo këto faktorë siç janë subjektet e marrëdhënieve ndërkombëtare, shtetet, organizatat ndërkombëtare, subjektet ekonomike ndërkombëtare e gjithnjë e më shumë edhe faktori njeri me liritë e të drejtat e tij universal.

Vështirimi i vëmendshëm i doktrinave gjeopolitike, siç vëren me të drejtë Bashkim Rama në këtë libër është ndikuar e kushtëzuar shumë nga autorët sikundër edhe nga shkollat ose më drejtpërdrejtë nga interesat nga kanë dalë e të cilave i kanë shërbyer. Është thuajse e pamundur të vesh vija ndarëse midis qëndrimeve objektive dhe subjektive në autorët, doktrinarët dhe shkollat e gjeopolitikës. Ndaj studimi i tyre lypet të bëhet në kontekste shumë të gjëra, multidimensionale, në shtrirje të gjatë kohore dhe të tejshkuara në çdo aspekt në laboratorin e interesave tona kombëtare. Në këtë aspekt, mendoj se Bashkim Rama na jep një model mjaft të kompletuar, cili është tejet i dobishëm për studiuesit shqiptar të gjeopolitikës.

Sikundër e theksova më lart, Bashkim Rama ka një formim shumë kompleks për botën sllavo folëse. Pikërisht për këtë arsye, Ai u nominua dy mandate radhazi ambasador i Shqipërisë në Bullgari. Bullgaria, në këndvështrim tjetër dhe për arsye të ndryshme ishte po kaq pikë nevralgjike për gjeopolitikën e Luftës së Ftohtë. Bullgaria ishte kufiri i skajshëm Lindor i Bllokut komunist, i Traktatit të Varshavës dhe i interesave të Bashkimit Sovjetik. E kufizuar me Federatën Jugosllave të paangazhuar dhe me Turqinë e angazhuar në NATO, Bullgaria ishte ballkoni i skajshëm i botës komuniste dhe i modelit Sovjetik të saj. Ky vend që kishte traditat e komunizmit idealist të Dimitrovit dhe të modelit konservator Sovjetik të Zhivkovit i krijoi shanse unike ambasadorit shqiptar Bashkim Rama për të parë nga afër dhe krejt së brendshmi procesin e rrokullisjes së komunizmit në kapërcyellin nga totalitarizmi drejt demokracisë liberale.

Koha kur ambasadori Bashkim Rama shërbeu ishte unike, e përsëritshme dhe shumë interesante. Për herë të dy Ai pati shans të punonte atje ku kuzhina e diplomacisë nuk pushonte nga dinamikat e mëdha të rendit botëror në tranzicion. Përvoja e botës sllavo folëse, njohuritë e thella për Bullgarinë e vendet përreth saj, periudha tranzitive e sistemit që Rama përjetoi në Sofie ishin padyshim një pasuri e çmuar, të cilin ambasadori na e jep tërthorazi me

shumë detaje, saktësi dhe elegancë në faqet e librit, sidomos në aspektin e analizës gjeopolitike e specifikisht atë Rajonale, meqenëse Bullgaria e afron atë me Ballkanin.

Zhvillimet gjeopolitike në Ballkanin e mbas rënies së Murit të Berlinit e gjejnë ambasadorin Bashkim Rama sërish në një prej nyjeve kruziale të dinamikave politike shqiptare, ballkanike, madje edhe ndërkombëtare, në Kosovë, ku emërohet i pari ambasador i Shqipërisë. Ndonëse statusi i papërcaktuar i Kosovës nuk i jepte mundësi Atij dhe gjithë përfaqësuesve të huaj në Prishtinë të akreditoreshin si ambasador, por drejtues zyrash, në fakt këto drejtues zyrash përfaqësorin diplomatët më të mirë të vendeve dhe organizatave ndërkombëtare. Ky kualitet diktohej nga problematikat e mëdha që kishte në vetvete çështja e Kosovës dhe implikimit në atë çështje e gjithë faktorëve dhe aktorëve më të rëndësishëm ndërkombëtar, politik, diplomatik, ekonomik, ushtarak, strategjik dhe juridik. Në njëfarë kuptimi njya e Kosovës ishte shtrirje e zgjatur e asaj që kishte nisur më rënien e Murit të Berlinit, të shpërbërjes se Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë dhe me përpjekjet për fillimin e një rendi të ri botëror mbi vlera e parime krejtësisht të ndryshme nga ato të periudhës së Luftës së Ftohtë. Kosova, nga 1996 deri ne vitin 2008 u shndërrua në një laborator ndërkombëtar në kuptimin më të plotë të kësaj fjale.

Në qendër të këtij laboratori me prioritet strategjik për popullin shqiptar, drejtuesi i Zyrës së Shqipërisë në Prishtinë, Bashkim Rama luajti me zhdërvjelltësi të paparë, herë duke përfaqësuar Shqipërinë tek autoritetet e përkohshme të Kosovës, herë duke përfaqësuar informalisht interesat e Kosovës tek përfaqësuesit e huaj, here duke intervenuar në Tiranë për zgjidhje brenda politikës se re e papërvojë Kosovare herë duke intervenuar në Kosovë për qëndrimet e dinamikat e politikës së jashtme dhe të diplomacisë shqiptare e së fundi duke u përpjekur në mënyrë konstante për një kohezion të Tiranës dhe Prishtinës në bashkëpunim me faktorët më të rëndësishëm ndërkombëtar si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, NATO s dhe Bashkimit Evropian. Në mënyrë konjukturale, por me një vetëdije dhe nuhatje profesionale të lartë, Bashkim Rama u shndërrua nga diplomatët më aktiv dhe ndikues në Kosovë për periudhën 2002 deri në 2006.

Unë, asokohe isha drejtor i Drejtorisë së Analizë Prognozës në Ministrinë e Punëve të Jashtme, drejtori jashtë mase e rëndësishme që e kanë shumica e Ministrive të Punëve të Jashtme në vendet demokratike të botës, por që tek ne mbas transferimit tim në krye të Drejtorisë së Organizatave Ndërkombëtare, çuditërisht mediokracia e mbylli pikërisht atëherë kur duhej zhvilluar e shndërruar në departament kryesor të shërbimin diplomatik shqiptar. Si drejtor i Analizë Prognozës, isha pikëlidhja permanente dhe qendra analitike

e parashikuese për dinamikat politike në Kosovë dhe për Kosovën në gjithë botën. Bashkim Rama ishte shtylla mbështetëse në këtë proces.

Më kujtohen edhe sot qindra informacione, raporte, analiza, prognoza, rekomandime që z. Rama më përcillte mua në Drejtorinë e Analizë Prognozës. Punonim si një tele-tajp i hapur 24 orë në ditë pa ndërprerje. Personalisht nuk u gjeta kurrë i zbuluar, pa informacione, raporte, analiza dhe parashikime që më vinin nga Prishtina prej Bashkim Ramës. Më vonë, kur të hapen Arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme, studiuesit do të shohin dhe do të arrijnë konkretisht që të kuptojnë së çfarë punë e mrekullueshme patriotike e profesionale është bërë dhe çfarë dedikimi, disipline dhe përgjegjshmërie për detyrën ka karakterizuar diplomatët kryesorë shqiptar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Në këtë grup diplomatësh, padyshim, Bashkim Rama ishte kryesori në Kosovë, prej të cilit ne merrnim gjithë atë që na nevojitej nga dinamikat në terren.

Për të kuptuar sesa energji patriotike, kulturë e profesionalitet, disiplinë e përgjegjshmëri ka dashur puna e diplomatëve të Shqipërisë për Kosovën në aksin Tiranë-Prishtinë dëshmojnë faqet e këtij libri, kur analizohet në mënyrë brilante kriza e Kosovës e vitit 2004. Lidhur me këtë krizë pati dy qasje të kundërta në kancelaritë e Tiranës dhe Prishtinës, madje edhe në shumë kancelari me rëndësi të madhe ndërkombëtare.

Sipas qasjes së parë kriza e Kosovës e vitit 2004 rëndoi situatën në Kosovë, rriti skepticizmin për pavarësimin e saj, prishi imazhin ndërkombëtar të Kosovës, popullit e politikës së saj dhe do sillte pasoja serioze lidhur me kohën e modalitetet e shpalljes së pavarësisë. Ambasadori Bashkim Rama dhe Drejtoria e Analizë Prognozës u ngarkuan që të punonin të pavarur analiza dhe parashikime për impaktet e kësaj krize. Dhe çfarë ndodhi kur u panë të dy analizat e bëra veçmas: konkluzioni ishte se raporti i Bashkim Ramës dhe ai i Drejtorisë së Analizë Prognozës në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë përputheshin së bashku në një qasje të dytë, të kundërt me atë parën që përmendëm në paragrafin më lart. Sipas kësaj qasje të dytë, në thelb kriza e Kosovës e vitit 2004 e lëvizi gjendjen e Kosovës nga stancjacioni i gjatë, vuri në dukje ezaurimin e Misionit të OKB, UNMIK dhe rriti besimin te faktorët lokalë Kosovarë, shkundi nga pasiviteti organizatat ndërkombëtare të akredituara në Kosovë, riaktivizoi agjendën e Kosovës në kancelaritë vendim marrëse ndërkombëtare dhe krijoi një opinion në rritje ndërkombëtar se duheshin hedhur hapa relevantë në rrugën për pavarësinë e Kosovës.

Koha, shumë shpejt vërtetoi se qasja e diplomatëve shqiptarë në Prishtinë e Tiranë kishte qenë më e saktë dhe më parashikuese. Asokohe, së bashku me ambasadorin Bashkim Rama, pa u njohur me materialet e njëri tjetrit kishim arritur të definonim krizën e Kosovës të vitit

2004 si “kriza që do shpejtonte rrugën drejt pavarësisë”. Koha provoi që qasja e diplomacisë shqiptare kishte qenë më e saktë. E në këtë përcaktim Bashkim Rama kishte rolin primar të të qenit diplomat në terrenin Kosovar të krizës.

Profili i Bashkim Ramës nuk mund të limitohet vetëm si diplomat. Mbas shumë vitesh karriere diplomatike, Ai i dedikoi tërë veprimtarinë e vet fushës akademike, shkencore e universitare. Duke qenë Drejtor Ekzekutiv i Akademisë Diplomatike Shqiptare për shumë vite Ai udhëhoqi punën trajnuese e kualifikuese të stafeve diplomatike të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi. Drejtoi punën e dy Zyrave Rajonale të Akademisë Diplomatike Shqiptare në Maqedoni e Kosovë dhe kontribuoi në trajnimin e kualifikimin e me shumë se 3600 kuadrove nga gjithë hapësira shqip folëse në Ballkanin Perëndimor.

Së bashku me Bashkim Ramën prej vitit 2005 kemi punuar në Universitete të ndryshme në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Preshevë e Bujanovc, duke hapur Programe Master, Universitete dhe Fakultete të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në Prishtinë, në Maqedoni në kemi qenë në pozita Rektorele e Dekanatesh duke prodhuar curricula, syllabuse, tekste e libra, duke ndërtuar partneritet akademike ndërkombëtare dhe duke vënë baza të qëndrueshme për arsimin universitar në Rajonin e banuar nga shqiptarët. Me rëndësi dhe admirim do përmendja se së bashku me Bashkim Ramën punuam pa u lodhur dhe pa u thyer nga asnjë lloj presioni për të themeluar të parin Universitet shqiptar në Presheve e Bujanovc, duke i krijuar kështu rinisë së Luginës perspektivën e universitarizmit në vendin e vet dhe në gjuhën e amtare.

Njeriu në jetë mund te këtë shumë fate. Përvoja ime dëshmon se një nga fatet më të mëdha në jetë është kur gjen një bashkëpunëtor të denjë. Puna e gjatë dhe e suksesshme me një bashkëpunëtor të denjë të bën të mendosh pas shumë vitesh, se ke lindur së bashku me të. Kështu ka ndodhur me mua e Bashkim Ramën. E nisëm punën si diplomatë, punuam së bashku në Akademinë Diplomatike Shqiptare, themeluam e drejtuaam Fakultete e Universitete në Rajon e sërish punojmë së bashku.

Do jetë shumë e vështirë për mua, por edhe për ato që do na pasojnë të gjejnë vija ndarëse në veprimtarinë tonë të përbashkët. Kjo, sepse vijat tona janë tërësisht të përputhura në dedikimin për diplomacinë, dijet, shkencën dhe arsimin universitar. Mbi të gjitha na bashkon ajo që njerëzit, të njohur e të panjohur në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Kroaci e kudo na thërrasin në mënyrë të vetvetishme dhe në koral: “ambasadorë”. Nuk ka lumturi më të madhe kur titujt e gradat i vendosin qytetarët dhe i vërteton koha. Kjo ndodh atëherë kur prapa titujve dhe gradave bëhen vepra. Libri që kemi në dorë nga Bashkim Rama është një vepër e tillë, për një ambasador të denjë shqiptar.

Maliq Bitri, Bajram Hyseni dhe Shane Muda në vargjet e poetëve

Rekuiem për poetët dibranë që u ndanë nga ne

Nga: **Mentor HOXHA**

Në katër vitet e fundit letërsia dibrane është tronditur shumë nga ikja para kohe e disa prej penave më të spikatura të saj. I pari, u shua Maliq Bitri, vjet Bajram Hyseni dhe para një muaji vdiq në Itali, Shane Mude. Që të tre këta emra ishin të talentuar në fushën e tyre letare dhe publicistike. Fuqia e krijimtarisë së tyre i kaloi kufijtë e Dibrës, për tu bërë pjesë e Shqipërisë dhe e fondit të artë të letërsisë shqipe, ndaj vdekja e parakohshme e tyre u bë dhimbja e të gjithë shqiptarëve. Ndaj ata nuk kanë vdekur sepse në memorine e kujtesës së dibranëve dhe të shqiptarëve rron vepra e tyre krijuese. Njerëz të tillë nuk mund të harrohen, sepse ndrijnë si meteor në qiellin letrar. Vargu dhe fjala që na lanë, janë muzë dhe shërim për ne, janë rreze dielli dhe shprese për këdo, ndaj brezat e sotëm dhe ata që do të vijnë do ti kujtojnë përherë, pasi poetët përkujtohen dhe lartësohen më shumë me kalimin e viteve dhe të brezave. Ata tashmë kanë filluar të gdhenden në varg nga kolegët, sepse edhe ata në vargun e tyre vunë mallin dhe dhimbjen njerëzore dhe shpirtërore të tyre dhe të kombit që i rriti. Një vit pas vdekjes të poetit brilant, Maliq Bitri, një poezi e shkruar për të nga poeti i talentuar dibran Ilir Spata, me banim në Amerikë, më pikëlloi aq shumë sa vetëm atëherë kuptova magjinë e madhe të shpirtit dhe të penës së poetëve. Sot një tjetër poezi po aq prekëse, shkruar nga i mirënjohuri, Mevlud Buci për dy shkrimtarin Bajram Hyseni dhe Shane Muda e përforcojnë më shumë profecinë dhe forcën e madhe të dhimbjes së poetëve të gjallë, për poetët e shuar para kohe.

Ku të kam Bajram Hyseni?!

Nga **MEVLUD BUCI**

30-të shënoi data e prillit
Viti dymijë e njëmbëdhjetë.
Pushoi kënga e bilbilit
Një çidhnak ndërroi jetë.

Një çidhnak ndërroi jetë
Dëgjo i Dibra e tanë vendi
Pendëartë e trim me fletë
Luftëtar Bajram Hyseni.

Luftëtar Bajram Hyseni
Për ty lotë derdhi dhe guri
Lotoi Drini dhe Erzeni
O shqiponjë në palë flamuri.

O shqiponjë në palë flamuri
Gen i Sulit të Fushë-Alisë
Zë bilbil e azgan burrë
Kryetrim, bir i Arbnisë.

Kryetrim, biri i Arbërisë
Burrë i besës për atdhe,

Shtator 2011 - 21

Major në ballë t’ushtirisë O vigan, o Promete.

O vigan, o Promete
I urti n’tok t’Kastriotit
Sa t’ketë jetë e dritë mbi dhe
Të rrojnë veprat mot pas motit.

Të rrojnë veprat mot pas motit
Ti je himn i mençurisë
Të gjithë ne i lutemi Zotit
Prehu n’parajsën e lumturisë!

Prehu n’parajsën e lumturisë
Se je soi i gjeneralëve
O Bajram, shend i lavdisë
O vigan, sokol i maleve.

O vigan, sokol i maleve,
Qan Ostushi, e qan Kubeni
Jeta jote, shkulm i dallgëve
Ku të kam Bajram Hyseni?!

Ku të kam Bajram Hyseni
Si na ndrit si yll i dritës
Të flet shpirti, të flet geni
O Balzak, kreshnik i Dibrës.

O Balzak, kreshnik i Dibrës
O petrit i tokës arbnore
Je në këngë në faqe të Dibrës
Sizifi rrit në llogore.

Sizifi rrit në llogore
Qëndrestari i shqiptarisë
Lum ç’ka rrit nëna malësore
Këtë Mandelë të fisnikërisë.

Këtë Mandelë të fisnikërisë
Më ta rrallë se rrallëkushi
Gjeneral në ballë t’ushtirisë
Se harrojnë Laçes, Ostushi.

Se harrojnë Laçes, Ostushi
Djersë e gjak i kulloi te Spaçi
Vallë kësi burrash e a njeh kushi
Lavdi paç Bajram Kovaçi!

Lavdi paç Bajram Kovaçi,
Të ndriçon shqipja te balli
Te flet Burreli dhe Spaçi
O çidhnak me zemër stralli.

O çidhnak me zemër stralli
O fisnik i Gjergj trimnisë
I ke veprat sa Korabi,
Në altar i ndrit lirisë....

Tiranë, 2011

Dritë paqëtimi *Poetes fisnike, Shane MUDA*

Nga **Mevlud Buci**

Ti poeteshë e rrallë provove zinxhirë
Ti poeteshë e thjeshtë dibrane
Ti e shumëvuajtura na ike me pahir
E urta, e ndritura, motra shane.

Në vargjet e tua, djersë e gjak përlyer,
Në vargjet e tua baladë persekutimi:
“Koha, thoshe, s’na fal shpinën e kthyer”
Shane Muda jonë, dritë persekutimi.

Nga: XHA FER MARTINI

ND RYSHE

Protagonisti i shkrimit tim kësaj radhe është një njeri i ndryshën nga ata për të cilët kam shkruar deri më tani. Është i ndryshëm në gjithçka. Flas jo vetëm për ata që e nuk e kanë njohur, por edhe për ata që e kanë njohur, mbasi nuk ishte lehtë ta njihje atë njeri. Ai ishte si deti që në cektësi ka edhe ndonjë papastërti, kurse në thellësi është i kulluar, qelibar. Cvajgu, kur shkruan për personazhet e Dikensit, thotë se “për t`u bërë hero tek Dikensi duhet të jesh arkë virtytesh, një puritan ideal”, kurse për të qenë hero tek Dostojevski duhet të jesh i madh në radhë të parë në shpirt, në vuajtje, në brendësi dhe në thellësi, mbasi “Dostojevski është skulptori i të jashtëzakonshmes, anatomisti më i madh i shpirtit të pezmatuar e të sëmurë që arti do ta ketë njohur ndonjëherë”. Edhe kaq pak sa u tha në fushën e krahasimit, lexuesi e kupton që protagonistin im kësaj radhe është një njeri i ngjashëm me personazhët e Dostojevskit. Cvajgu në shkrimin për Dostojevskin, Dikensin dhe Balzakun është mjeshtër i madh, si kudo. Ai hedh një frazë si kalimthi në tekstin e vet, një frazë monumentale: “Për njeriun nuk ka ankth më torturues sesa përpjekja për të gjetur një gjë para të cilës të përkulesh.” Në radhë të parë, këtu është fjala për njeriun. Protagonisti për të cilin po shkruaj, ka kaq shumë madhësi dhe fisnikëri sa para tij përkulem me zemër. Ky njeri ka pak kohë që ndërroi jetë. Disa thonë në Amerikë, ku jetonte me gruan dhe dy djemtë, disa thonë në Shqipëri. Mjegullnajë.

Lajmet për vdekjen e tij kanë qarkulluar disa herë. Vinin të mjegulluara, sikur i sillnin retë, erërat, shirat, forcat e natyrës. Dhe vetë ai për të cilin përhapeshin këto lajme, pa dashje të askujt, vishej me një mjegull misteri, me një “rrobë” mitike, shkurt, legjendarizohej dhe të krijohej përshtypja se gjithnjë ndaj tij do të nisej një vdekje e rreme, jo e vërtetë, duke të krijuar kështu idenë e Pavdekësisë.

Vdekja në të vërtetë atij i është afruar shumë herë, nëse kësaj dukurie i japim një karakter filozofik dhe nuk ia ngushtojmë misionin vetëm me ndërprerjen e jetës. Këtë do të përpiqem ta shpjegoj, megjithëse e kam të vështirë, se, të shkruash për, të është si të pikturosh muzgun, kur ngjyrat dhe dritat të ikin me shpejtësi.

PESHKOPIA, SI MEKA

Aty nga vitet shtatëdhjetë në qytetin e Peshkopisë u duk një çift i ri, i bukur, që ecnin dhe rrinin përherë bashkë. Burri ishte tek të tridhjetat ose pak më shumë, gruaja nuk e kishte arritur këtë moshë. Gjykojmë nga pamja e jashtme. Burri ishte syzi, vetullzi, flokëashpër, që, të krehura mënjanë, i rrinin bukur. Vështrimin e kishte të zgjuar, depërtues, por si të muzgëtuar. Vetëm kur qeshte, në fytyrën e vështrimin e tij binte dielli. Kishte trup mesatar dhe dukej mjaft serioz. Nusja ishte me tipare tërheqëse, me sy të bukur, el-

Njeriu, gjeniu dhe pavdekësia

Portret i mjegulluar dhe i papërfunduar

Lajmet për vdekjen e tij kanë qarkulluar disa herë. Vinin të mjegulluara, sikur i sillnin retë, erërat, shirat, forcat e natyrës. Dhe vetë ai për të cilin përhapeshin këto lajme, pa dashje të askujt, vishej me një mjegull misteri, me një “rrobë” mitike, shkurt, legjendarizohej dhe të krijohej përshtypja se gjithnjë ndaj tij do të nisej një vdekje e rreme, jo e vërtetë, duke të krijuar kështu idenë e Pavdekësisë.

egante, me zhvillim harmonik. Të shoqin e kapte për krahu sikur donte të tregonte me atë gjest se vetëm atë kishte dhe se do ta mbante fort. Jetonin përkohësisht në hotel “Korabi” në pritje të riemërimit. Peshkopia është qytet i vogël dhe shpejt u mor vesh se çifti të cilin e përshkruam përciptazi, ishin një mjek okulist nga më të shquarit në Shqipëri, për të mos thënë më i shquari, dhe një mjeke pediatre, e sapospecializuar. Mjeku kishte qenë pedagog në universitet, në Fakultetin e Mjekësisë. Adhurohej për gjithçka, veçanërisht për talentin në fushën e vetë. Baza e suksesit të tij ishte intuita e jashtëzakonshme, që e kanë vetëm gjenitë, por ishte edhe studimi i thellë dhe me themel nëpërmjet katër gjuhëve të huaja që i dinte si shqipen (rusisht, gjermanisht, anglisht dhe italisht). E adhuronin, por nuk e donin. U kishte zënë rrugën atyre që ishin të parët me grada dhe me pozita. E kishin inat se krijoi një kod të ri vlerash. Duhej shmangur, por si, qysh? Nuk ishte një gur i vogël që të ka zënë rrugën dhe e rrokullis me këmbë. Ishte një shkëmb i madh. Duhej kapur qysqia dhe duhej përdorur dinamiti... Prandaj prisnin...

Mediokrit, por edhe ata me zgjuarsia mesatare, e pak mbi mesataren, kanë tri cilësi që gjenialët nuk i kanë: ambicien, kurthin dhe durimin. Ç’lipi zogu, e dha vera, thotë një fjalë e urtë. Mjekut të ri iu arratis një vëlla jashtë shetit. Kaq duhej. Tashti, edhe të ishte rrap shekullor me rrënjë të thella, do ta shkullnin si qepë. E dëbuan nga Tirana dhe e sollën në Peshkopi, një qytet i vogël, provincial. Nëse duhej të linte Tiranën një mjek aq i shquar dhe i aftë si ai, atë duhej ta çonin, të paktën, më ndonjë qytet të madh dhe jo në Peshkopi. Ai në Tiranë pat krijuar familje, ishte martuar me një mjeke me të cilën kishte edhe një djalë. Ajo nuk qe e gatshme ta ndiqte burrin kudo që ta shpinin. Një dijetar ka thënë se “Pas aftësisë për të plagosur, ajo që mund të bëjë më mirë gruaja, është aftësia për të lidhur plagën.” Ajo kishte vetëm aftësinë për të plagosur. Plagën doktorit të ri ia lidhi një mjeke e re pediatre, ajo e bashkoi fatin me të edhe në fatkeqësi. Me ty jam gati të shkoj edhe në fund të ferrit, i tha, dhe u nisën bashkë për në Peshkopi. Por edhe në Peshkopi nuk i mbajtën. I dërguan mjekë të përgjithshëm në zonën më

të largët të rrethit, në Reç, vendi më i varfër dhe më pak i populluar. Ata jetuan vitet më të bukura të rinisë së tyre në këtë vend ku shikon një hektar qiell. Por nuk është puna tek qielli, është puna tek profesioni. Okulisti i shquar një herë në gjashtë muaj mund të kishte ndonjë rast me probleme që lidheshin me profesionin e tij. Por edhe atëherë nuk kishte ç’të bënte. Duart nuk bëhen bisturi. Ai u shndërrua në një mjek të përgjithshëm, që merrej edhe me gropat septike. Atë po e vrisnin nga pak e për ditë, kjo ishte vrasje shpirtërore, profesionale; po i vrisnin ëndërrat, dëshirat, shpresat, planet që kishte për t’u lartësuar në malin e madh të shkencës. Atë e rroposën në humnerë nga e cila e kishte vështirë të dilte. Kjo ishte vrasja e parë e mjekut të shquar. Nuk i shkoi vdekja e vërtetë që t’i merrte jetën, por një vdekje tjetër, morale, filozofike, profesionale, shpirtërore, që të ngujon në shkretëtirë, që ta merr jetën pak nga pak, ditë për ditë, të gërryen, të izolon, të poshtëron, të bën ta ndjesh veten të padobishëm dhe, më në fund, të bën që ta humbasësh respektin ndaj vetes...Ja, këtë qëllim kishte degdisja e mjekëve të shquar në Reç, ku qëndruan shumë vite, në kulmin e moshës, në kulmin e ngritjes, në kulmin e karrierës profesionale, në kulmin e shpresave dhe të ëndrrave...Ishin të dënuar, të dëbuar, të damkosur. Napoleoni ka formuluar akuzën e vet ndaj atyre që e degdisën në ishullin e Shën Elenës: “Ju më vratë për një kohë të gjatë, pak nga pak me paramendim... dhe unë, duke vdekur mbi këtë shkëmb të llahtarshëm, i privuar nga njerëzit e mi dhe duke më mënjanuar nga çdo gjë, ia lë turpin dhe tmerrin e vdekjes sime familjes mbretërore të Anglisë.”

Mbas disa vitesh e sollën në spitalin e Peshkopisë. Një spital i vogël, ku mungonin kushtet, tradita, gjithçka. Ngritja e tij profesionale qe ndërprerë, por shkëndijat e gjenialitetit nuk shuheshin kollaj, prandaj ai bëri mrekulli edhe në Peshkopi. Për dritën e syve, në Peshkopi vinin nga të gjitha rrethet e Shqipërisë. Ky qytet në ato vite u bë si Meka; vendi i pelegrinazhit ishte ajo salla e vogël e operacionit, ku duart e doktorit bënin mrekullira. Janë me dhjetra dhe me qindra ata që ai u ka sjellë shikimin, kur të gjitha shpresat kishin humbur; janë me dhjetra ata që ai u ka korrigjuar me shumë sukses

të metat e natyrës (strabizmin), duke u bërë një ndër pionierët në fushën e kirurgjisë estetike. Sot operacionet që ai bënte në spitalin e vogël të Peshkopisë, kushtojnë mijëra euro, kurse ai i bënte pa asnjë lekë. Sot njerëzit i luten Zotit: “O Zot, mos na lësho në dorë të mjekëve. Po pate për të na marrë shpirtin, na e merr, vetëm në dorë të tyre mos na ler.” Kështu luten njerëzit e shtresave të varfëra. Të pasurit ua shuajnë urinë e tmerrshme me para. Të pasurve mjekët u servilosën në mënyrën më të pështirë, u shërbejnë me të gjitha aftësitë dhe u krijojnë të gjitha kushtet. Të varfërit i lënë të vdesin. Kjo është një arsye më shumë për të shkruar dhe për ta kujtuar mjekun human. Ai besonte në Zotin. Nuk ka humanizëm atësi. Ai ishte i dërguari i Zotit për t’i shërbyer njerëzimit. Ai ishte misionar, me një qëllim të caktuar, me rol të përkohshëm dhe të kufizuar. Nuk ishte as Krisht, as Muhamet, por i ngjashëm me to. Nuk ishte predikues i ndonjë feje, por i humanizmit. Aty ku nuk njihet Zoti, gjithçka lejohet, thoshte dhe përmendte atë shprehjen e famshme të Volterit: “Nëse Zoti nuk do të ekzistonte, do të ishte e nevojshme ta shpiknin atë.”

Një herë një i afërt i një pacienti i kishte lënë një turrë me pare në dorë dhe kishte ikur. Ai i rend prapa që t’ia kthejë, por tjetri ia mbathi që të mos e arrinte. Mjeku doli në oborin e spitalit të Peshkopisë dhe e hodhi gjithë turrën me pare (ishin prerje 250 lekëshe), që t’i merrnin njerëzit. Kam ndodhur vetë në atë çast aty. Këtë skenë e kam parë me sytë e mi.

Nga mesi i viteve nëntëdhjetë, kur qenë shembur barrierat, kur lëvizja e njerëzve u bë e lirë, okulisti i famshëm iku në Tiranë. Por ishte vonë, shumë vonë. Ai ishte pelegrini i vonuar, shtregu i fundit që ndahet nga tufa dhe zemra i pushon në hapësirat oqeanike. E kishin dëbuar shumë vite më parë dhe ia kishin shkatërruar çerdhen. Tani ajo nuk ndërtohet më.

Esenini, në poezinë e tij brilante, i thotë nënës se do të kthehet edhe një herë në ato viset e lindjes, në shtëpinë e vjetër për të cilën e kishte marrë aq shumë malli, megjithëse kishin ndryshuar shumë gjëra dhe ato që ishin bërë nuk zhbëheshin më, madje as vetë Esenini nuk ishte ai që kishte qenë. Po Esenini kishte tetë vjet që ishte larguar, doktori kishte njëzet e tetë vjet. Po le të citojmë Eseninin për të përjetuar tragjedinë e shkuljes, të prishjes së çerdhes, të vrasjes pa ta marrë jetën:

“Do të vij kur kopshti ynë i bardhë, Anekënd të vishet me blerim. Vetëm ti, si tetë vjet më parë Mos më zgjo që heret në agim.

Mos e zgjo atë që shkruam iu bënë, Ëndrrat e moshës plot hare! Më ka vrarë jeta mjaft, o nënë,

Dua veç të çlodhem e të fle.”

Ai ishte gjallë, por jeta e kishte vrarë. Tani ish-studentët e tij ishin me tituj dhe me grada; ata edhe pse nuk e kishin talentin dhe gjenialitetin e tij, kishin përparuar. Profesori i tyre i dikurshëm tani ishte si një plaçkë e vjetër, e hedhur...atij i dridheshin duart dhe nuk i përballonte dot operacionet e vështirë...Vetvetiu e mënjanuan. Nuk i gjeti vend vetes dhe, më në fund, emigroni në Amerikë.

PERSONALITETI

Me okulistin e famshëm kam pasur fatin të jem fqinj për një kohë relativisht të gjatë, gati një dhjetëvjeçar. Pak vite para fillimit të proceseve demokratike në rrethin e Dibrës erdhi sekretar i parë Xhelil Gjoni, i cili u tregua reformator. Denoncoi varfërinë dhe prapambetjen e kësaj treve, pakësoi në maksimum luftën e klasave, u krijoi kushte më të mira strehimi dhe jete-se disa intelektualëve të shquar në fushat e veta, njëri prej të cilëve ishte okulisti i famshëm. Atij iu dha zgjerim në pallatin më të mirë që ishte bërë për kuadrot kryesore. Unë isha në një pallat me të. Takoheshim shpesh dhe bisedonim gjatë. Ai kishte disa karakteristika të veçanta që nuk i kam ndeshur tek njerëzit e tjerë. Ajo që më ka bërë përshtypje më shumë se të gjitha ka qenë kjo: ai nuk dinte të shtirej. Gjithçka që kishte në zemër, e thoshte hapur, pa hezitimin më të vogël. Nuk njihte kompromis, nuk përshtatej, nuk njihte hatërmbetje, nuk donte t’ia dinte nëse je njeri me pozitë të lartë, apo çoban dhish, ai ishte i hapur, i prerë, direkt. Nuk dinte të bënte dredha. Toleranca e tij ishte zero. “Kulmi i tolerancës, - ka shkruar Cevi, - arrihet nga ata që nuk janë të ngarkuar me bindje.” Ai kishte bindjet e veta nga të cilat nuk lëvizte kurrë. Barra e bindjeve është shumë e rëndë. Ajo të rëndon si mali mbi shpinë. Mosshtirja është karakteristikë gjeniu.

Ai ishte konfliktual. Nuk përtonte të hynte në polemikë, të zihej dhe të kacafytej, jo në kuptimin fizik, me çdo njeri për të mbrojtur pikëpamjet dhe mendimet e veta. Ai aspironte për të drejtën dhe të vërtetën dhe drejt tyre e çonte, si të thuash, karakteri i vet, por edhe forca argumentuese, logjika e fortë, që nuk kishte fushë të jetës ku nuk depërtonte. Me të mund të flisje për filozofi, histori, art, kulturë, gjuhësi, letërsi. Nuk e quante gjë të madhe horizontin e tij kulturor dhe nuk merrte poza diturake. Ishte njeri i thjeshtë, i natyreshëm. Konfliktualiteti është karakteristikë për gjenium.

Ai ishte radikal në mendime. Radikalizmi ishte shprehje e natyrës së tij, mungesës së kompromisit, papajtueshmërisë absolute me të keqen, të ultën dhe të pamoralshmen, por edhe vuajtjeve që kishte kaluar. Në ngjarjet që ndodhën pas

Ai nuk dinte të shtirej. Gjithçka që kishte në zemër, e thosh-te hapur, pa hezitimin më të vogël. Nuk njihte kompromis, nuk përshtatej, nuk njihte hatërmetje, nuk donte t'ia dinte nëse je njeri me pozitë të lartë, apo çoban dhish, ai ishte i hapur, i prerë, direkt. Nuk dinte të bënte dredha. Toleranca e tij ishte zero. “Kulmi i tolerancës, - ka shkruar Cevi, - arrihet nga ata që nuk janë të ngarkuar me bindje.” Ai kishte bindjet e veta nga të cilat nuk lëvizte kurrë. Barra e bindjeve është shumë e rëndë. Ajo të rëndon si mali mbi shpinë. Mosshtirja është karakteristikë gjeniu.

vitit 1990, u përfshi në politikë, por jo si politikan tipik, me rezerva shpirtërore, me hapa të matur dhe me kujdes që ta arrish objektivin me sa më pak dhimbje dhe me sa më pak shpenzime shpirtërore, fizike etj. Të arrish atë që duhet, duke mos kursyer askënd dhe asgjë, kjo ishte motoja e tij. Ai dhe e shoqja u bënë kandidatë për deputetë respektivisht për PD dhe PR. Bënë fushatë të mirë, të kulturuar, por pa mëshirë për të kaluarën. Ata nuk e amnistionin atë në asgjë. Ata harronin se e kaluara ishte pjesë e atyre njerëzve me të cilin rrinin çdo ditë, pjesë e tyre. Ajo nuk mund të zhdukej. Falangat e errësirës i vunë në shënjestër. U vunë flakën edhe në derën e shtëpisë, por lumturisht zjarri nuk u përhap dhe nuk u bë asnjë dëm. Ky lajm u dha edhe nga “Zëri i Amerikës”. Simpatia për mjekët e shquar, sidomos për okulistin e madh, rritej, megjithatë ata nuk fituan për t' u bërë deputetë. Bëhet fjalë për zgjedhjet më të para pluraliste, kur PPSH fitoi më shumë se dy të tretat në parlament. Ata demokratë që vunë kandidaturën në zgjedhjet e 22 Marsit, fituan të gjithë, mbasi populli votoi në mënyrë plebishitare. Doktorit dhe e shoqja nuk ishin kandidatë në këto zgjedhje. Kur fitorja ishte e sigurt, nuk i afruan. Ata u zhgënjyen. Ata ende nuk e dinin se “Demokracia është një festival mediokriteti”. Doktorit i famshëm nuk ishte llogaritar, nuk ishte njeri praktik që të mendojë edhe për të nesërmen. Ai ishte njeri që i harxhon të gjitha rezervat shpirtërore, dhe, në fund, dështon. Edhe kjo është karakteristikë gjeniu.

Ai ishte radikal në ide, por jo në planin praktik. Ai nuk i mbante mëri atij që i kishte bërë keq. Ai, në këtë drejtim, ishte si Krishti.

NË OBORRIN E PAVDEKËSISË

Ky shkrim është fragmentar, diçka e papërfunduar, e pakryer. Koha e pakryer në gjuhësi tregon një veprim që nuk ka përfunduar. Mua nuk më besohet ende se doktorit ka vdekur, më duket se është një nga ato lajmet e gënjeshtre që i sillnin vazhdimisht agjensitë e mjegullave. Kjo ide nuk më është ngulur kot në mendje. Unë doktorin e kërkoj në oborrin e Pavdekësisë. Ai bëhet gati për të hyrë në këtë tempull. Është vështirë të hysh aty. Ky tempull nuk i nxë të gjithë pretendentët. Pavdekësia ka burokracinë e saj, që i zvarris punët, i vonon. Nganjëherë, kur do të pranojë një të ardhur rishtazi, si protagonist i im, duhet të heqë një tjetër për të liru vend. Pavdekësia bën seleksionim të vazhdueshëm. Ajo më shumë nxjerr njerëz sesa fut

në tempullin e vet. Në oborrin e saj, në pritje për një vend, ka vite që rrinë në radhë nobelsitë, njerëz të famshëm nga e gjithë bota ku jetojmë ne. Në pritje rrinë edhe diktatorët më të egër, që duken si qingja. Plotësojnë me durim dokumentet dhe presin e presin....Burokracia e Pavdekësisë është e tmerrshme. Ajo përbëhet nga nëpunës të sprovuar, që nuk duan t'ia dinë çfarë ke qenë në këtë botën tonë. Atje maten dhe vlerësohen ndryshe gjerat.

Kandidatët për Pavdekësinë çuditen me njeri-tjetrin. Edhe ti pret për të hyrë në tempullin e Pavdekësisë? - pyet njëri prej tyre shokun që ka pranë, i cili jep e merr me letrat që don t'i plotësojë. Po, përderisa pret ti, pse të mos presë unë? - përgjigjet tjetri. Dhe kështu pyetjet e përgjigjet, hamendjet dhe shpresat mund ta vazhdojnë në shekuj.

Një herë në njëqind vjet del një nëpunës serioz dhe u mban një fjalim të shkurtër ayre që presin. Ata që kanë mbushur njëqind vjet dhe nuk janë pranuar, të mos presin më, komunikoni ai. Të përjashtuarit nga Pavdekësia protestojnë, bërtasin, tregojnë meritat e tyre, tundin titujt dhe gradat, medaljet, çmimet, tregojnë karrocet me librat që kanë botuar, por titullari nuk impresionohet. Papritur hapet porta e madhe e Pavdekësisë dhe një tufë e madhe njerëzish dalin që andej, më mirë është të thuash që po i përzënë. Shikoni, u thotë nëpunësi atyre që protestojnë, ne po nxjerrim këta që kanë qenë këtu dhe jo të pranojmë të tjerë, prandaj ikni sa nuk është vonë. Na kanë ardhur të tjerë me më shumë merita.

Vetëm njëri pati një protestë krejt ndryshe nga protestat e të tjerëve, prandaj bëri përshtypje të madhe jo vetëm nga ata që prisnin të hynin, por edhe nga ata që u dëbuan.

– Unë nuk pyes për Pavdekësi, - tha ai që i çuditi të gjithë. - Ja në Pavdekësi, ja rash e vdiqa! Unë e kam merak radhën, nuk pres asnjë minutë. Po e pata vendin këtu, mirë, ndryshe iki.

– Kush foli kështu? - pyti nëpunësi që ua preu shpresën atyre që kishin mbushur qindvjetshin dhe nuk ishin pranuar.

– Unë, - tha një burrë që në të parë nuk ta mbushte syrin, se nuk kishte as grada, as dekorata, as çmimin Nobel, as Oscar dhe as karrocë me libra.

– Ti je ai mjeku i një vendi të humbur? - pyeti burrin nëpunësi që dukej një burokrat i stazhionuar.

– Po, unë jam.

– Burokracinë e kemi shpikur për këta që nuk duam t'i pranojmë. Ata që këmbëngulin, nuk hyjnë kurrë në këtë tempull. Eja, se e ke vendin gati. Ky ishte Basri Neziri.

Skënder Dema, një emër që do të jetojë gjatë në zemrat e dibranëve

Më datë 28/08/2011 pushoi së rrahuri zemra e njerit prej figurave të njohura shqiptare. U nda nga gjiri i familjes së tij, nga shokët dhe miqtë shkodoranë e dibranë dhe nga të gjithë ata që e njohën, punuan dhe jetuan me të Skënder Dema. Ai lindi në qytetin e Shkodrës më 28/03/1935 në një familje të mesme shkodorane, u rrit dhe edukua nën kujdesin e nënës dhe të babait si dhe fisit të madh sojnik të Demajve. Skënderi u shqua që në fillimet e jetës së tij si fëmijë e nxënës me të gjitha dhuntitë që i fali natyra, ishte një nxënës shembullor që nga shkolla fillore, tetëvjeçare dhe të mesme që studioj e i përfundoi në qytetin e lindjes në Shkodër. Pas mbarimit të shkollës së mesme Skënderit iu dha e drejta e studimit për agronomi në Universitetin Bujqësor Tiranë, ku mbaroi me rezultate të shkëlqyera studimet e larta dhe ndërkohë u specializua po në këtë fakultet për vitikulturë. Pra këtu ai i rriti më tej shkallët e dijeve dhe të shkencës në fushën e bujqësisë ndërkohë ai fitoi shumë dhe tregoi aftësi progresiste, organizative në radhët e studentëve më të përparuar. Pas mbarimit të studimeve të larta dhe specializimeve shkencore fillimisht ai u emërua agronom e më vonë kryeagronom në NB “Perlat Rexhepi” Shkodër. Për rezultate të shkëlqyera në punën e tij u bë drejtor i kësaj ekonomie të madhe që i dha stimul të gjithë ekonomive të tjera në shkallë rrethi si dhe në shkallë vendi. Rezultatet dhe metodat e punës së tij, organizimi shkencor i punës në ekonomi, sjellja dhe puna njerëzore me kuadrot dhe punonjësit e tjerë e rritën shumë personalitetin e tij si kuadër drejtues. Në këto rrethana Skënder Dema i rriti shkallët e hierarkisë së tij duke e emëruar nomenklatura e kohës zëvendëskryetar të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Shkodër, periudhë në të cilën ai mbuloi problemet e bujqësisë në shkallë rrethi. Puna e tij gjithnjë ishte rezultative, suksesi dhe arritjet në të gjitha ekonomitë e rrethit Shkodër ia rritën figurën dhe personalitetin e tij prej njeriu shkencar progresist. Në këtë kohë rrethet e kategorisë së parë kërkonin kuadro të zot, organizator dhe personalitete shkencore, njerëz me integritet. Në këto personalitete ishte i listuar edhe Skënder Dema. Rrethi i Dibrës si rreth i kategorisë së parë dhe kryesisht rreth bujqësor por dhe industrial ku kërkohej për të bërë përparime të mëtejshme në të gjitha fushat veçanërisht në bujqësi. Për rrjedhim nga nomenklatura e lartë shtetërore e kohës u përzgjedh dhe u emërua kryetar i Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Dibër Skënder Dema, detyrë të cilën e mori përsipër në vitin 1972 dhe qëndroi deri në vitin 1984(për 12 vjet), detyrë të cilën e kreu me nder e faqe të bardhë. Rezultatet dhe efektiviteti i punës së tij u ndje kudo nga qenda në bazë gjatë karrierës së tij në Dibër si kryetar i ekzekutivit për 12 vjet, ai ishte një vektor i vërtetë. Në qëndrimet e tij Skënder Dema si person me integritet, i dashur brenda kuadrit njerëzor, i sinkertë dhe i besueshëm(por jo symbyllur) duke gëzuar simpatinë e të gjithëve. E vërteta në lidhje me integritetin e tij qëndronte në faktin se ai ishte i matur e i kujdeshëm, nuk nxitohej, kryesorja është se ai nuk dilte jashtë realitetit të kohës. Asnjëherë ai nuk i krijoi privilegje vetes dhe familjes së tij nëpërmjet postit zyrtar. Është kjo ndër arsytet që ai qëndroi për 12 vjet në Dibër duke kaluar nga suksesi në sukses pa bujë për vite të tëra. Nuk mund të lihen pa përmendur edhe disa qëndrime e veprime të tij që e bënë shumë popullor, si pjesëmarrja e tij e rregullt në dallim nga të tjerët në veprimtaritë artistike kulturore e sportive, në gëzimet dhe hidhërimet e sidomos në fatkeqësitë e njerëzve. Të gjitha këto e të tjera e bënë Skënder Demën një personalitet me integritet të pakontestuar. Është meritë e qëndrimit të tij prej burri të shtetit që për 12 vjet qëndroi dhe dirigjoi postin e kryetarit të ekzekutivit të rrethit Dibër. E vërteta është se asnjë kuadër tjetër qoftë dibran (apo jabanxhi) nuk ka qëndruar në postin e kryetarit të ekzekutivit për 12 vjet rresht përveç Skënder Demës. Ky qëndrim ia rriti më



shumë personalitetin si njerëzor dhe si kuadër kryesor. Kur erdhi çështja e transferimit të Skënderit nga Dibra nomenklatura e lartë e kishte pyetur:

-Ku dëshiron të të transferojmë? Skënder Dema i ishte përgjigjur:

-Skënderbeu ka lindur në Dibër, ka luftuar në Krujë dhe ka vdekur në Lezhë. Edhe Skënder Dema ka lindur në Shkodër, ka punuar dhe punon në Dibër dhe do të vdes në Shkodër. Dhe kështu siç u shpreh vetë Skënderi u vendos. Ai u emërua zëvendëskryetar i ekzekutivit dhe pas gjashtë muajsh u bë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të rrethit Shkodër. Ndërkohë ndryshimet demokratike bënë punën e vet. Skënderi u transferua drejtor i NB Shkodër. Aty ai mbylli karrierën e tij të lavdishme si kuadër. Aty doli dhe në pension. Edhe pas daljes në pension Skënderi ka mbajtur qëndrim burrëror duke mos iu detyruar askujt, kokën e ka mbajtur gjithnjë lart dhe për këtë ai është respektuar dhe nderuar nga e gjithë Shkodra dhe shkodoranët. Po kështu edhe nga Dibra dhe dibranët. Vitin e kaluar shefi i shefave siç e thërriste Skënderi(është fjala për ish shefin e arsimit dhe kulturës Dibër Shemsi Manjani) organizoi me disa shokë në Shkodër një drekë me rastin e 75 vjetorit të lindjes së Skënder Demës, ku së bashku me këtë kishin kaluar çaste shumë të gëzuara për disa orë dhe kishin shkëmbyer batuta e bejte shkodorane e dibrane. Shokët duke ngritur dolli për Skënderin e duke i uruar jetë të gjatë, ai ishte shprehur me shkodoranët dhe dibranët do jetoj edhe një shekull tjetër. Në rreth të papritura por nga sëmundja e gjatë e mushkërive dhe e zemrës pa iu nënshtruar atyre për shumë kohë, erdhi momenti i fundit që në orën 6 të mëngjesit të datës 28/08/2011 pushoi së rrahuri zemra e Skënder Demës, personalitetit të shquar shkodoran. Më 29/08/2011 nga shtëpia e tij u bë përcjellja për në banesën e fundit. Kortezi i përmortshëm u shoqërua nga familja, bashkëshortja Fife Dema, djali Sokol Dema, vajza Mira Dema, dhëndëri Astrit Agolli, dy nipërit e vegjël, motrat e Skënderit, miq e shokë shkodoranë e dibranë(shokë të punës e miq të ngushtë të tij) të cilët i dhanë lamtumirën e fundit. Skënder Dema vdiq si burrë me integritet por familjes, të afërmëve, shoqërisë, miqësisë dhe të njohurve u ka lënë pas një thesar me vlera të pakontestuar(të gjitha vyrtet njerëzore që karakterizojnë një burrë shteti si Skënder Dema) të cilin do ta kujtojnë me respekt e me dashuri përgjithmonë. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

Nga shokët që punuan dhe jetuan për 12 vjet rresht në rrethin e Dibrës:

Rakip Dançe, Ali Kaza, Xhemal Gazidede, Musa Rama, Ndue Kola, Kujtim Brovina, Pashk Jushi, Halil Uka, Shemsi Manjani, Nikollë Kola, Naim Kaçorri, Sali Ajazi, Kujtim Sula, Avni Fida, Beqir Shehu, Idriz Kukeli.

Biblioteka e autorëve dibranë*



Këto dhe shumë botime të tjera të autorëve dibranë mund t'i gjeni pranë librarisë "M&B"

Adresa: Rruga "Zenel Baboci", Pall. Ferar, Tiranë (Pranë Selvisë)

Tel. 00355 4 22 33 283.

Cel. 069 20 68 603

e-mail: mbbotime@gmail.com

-20%

* Janë reklamuar vetëm botimet që mund ti gjeni pranë librarisë "M&B"